



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE
Asambleja

Raport i Kryesisë

Pjesa I

Për veprimtarinë e Akademisë së Shkencave gjatë vitit 2022

Tiranë, janar 2023

I. Prioritete të veprimtarisë vjetore të ASHSH

Viti 2022 mund të cilësohet si:

⇒ *Viti i Akademizmit Shqiptar*

Më së pari i 50-vjetorit të themelimit të Akademisë së Shkencave, një moment historik për vlerësim retrospektiv të fazave të zhvillimit institucional të saj, për reflektim mbi të shkuarën, të sotmen dhe të ardhmen. Për këtë u përfshinë me kontribute në veprimtaritë e parashikuara studiuës shqiptarë nga gjithë hapësira jonë historike, nga arbëreshët e arvanitët dhe nga albanologët e huaj.

Për herë të parë ASHSH erdhi në vëmendjen vlerësuese të ALLEA-s, e cila, përmes Antonio Loprieno, President i saj, u shpreh qartësisht për arritjet dhe perspektivën e saj (shih shtojcën *Vlerësime të institucioneve* bashkëlidhur me këtë raport). Në veprimtaritë kushtuar 50-vjetorit të ASHSH morën pjesë kryetarë të akademive të vendeve të rajonit: ASHAK, Akademia e Shkencave dhe Arteve e Maqedonisë së Veriut, Akademia e Shkencave e Bullgarisë; Akademia e Shkencave e Malit të Zi; si dhe përfaqësues të Akademisë Gjermane *Leopoldina* e të Akademisë Çeke të Shkencave.

⇒ *Viti i shqipes së njësuar.*

50-vjetori i Kongresit të Drejtshkrimit shërbeu si një rast i shkëlqyer për përballjen me qendrimet joshkencore ndaj procesit të njësimin të shqipes letrare, me pjesëmarrjen e gjuhëtarëve dhe të përdoruesve më cilësorë të shqipes nga gjithë areali i përhapjes së saj. Dy konferencat e zhvilluara në Tiranë dhe në Prishtinë, *Java e Drejtshkrimit* e organizuar në bashkëpunim me Kryeministrinë; konferenca të tjera në Maqedoninë e Veriut dhe në Mal të Zi; si dhe angazhimi zyrtar-shtetëror në gjithë këtë areal, bënë që veprimtaritë në këtë kuadër të kenë karakterin e një rikonfirmimi të arritjeve më të mëdha të shqipes së përbashkët.

⇒ *Viti i tre projekteve të mëdha në albanologji: Fjalor i madh i gjuhës shqipe, Histori e shqiptarëve dhe Enciklopedi shqiptare.*

Këto tre projekteve shkencore madhore miratuar prej tre vjetësh dhe përfshirë në marrëveshje bashkëpunimi me ASHAK-un dhe shumicën e institucioneve të trashëgimisë në Kosovë e Maqedoninë e Veriut faktikisht kanë bashkuar rreth ASHSH potencialet shkencore më cilësore të studimeve shqiptare në institute, qendra kërkimore e në universitete. Studiuesit shqiptarë, pavarësisht ku gjenden, po e zhvillojnë jetën shkencore pranë ASHSH.

Vëmendjen më të rëndësishme këtë vit e ka fituar projekti *Enciklopedia shqiptare*, e cila përfundimisht fitoi mbështetje jo vetëm shkencore, por edhe buxhetore, nga Qeveria e Shqipërisë dhe ajo e Kosovës (në Shqipëri mbështetja ndërqeveritare u ratifikua edhe në Kuvend). ASHSH përgatiti projektin e marrëveshjes ndërqeveritare, miratuar në Prishtinë më 20 qershor; rregulloren e përbashkët për ngritjen dhe funksionimin e redaksive të të tre niveleve, nënshkruar me ASHAK-un më 28 tetor; protokollin për modalitetet e përdorimit të buxhetit; rregulloren teknike të redaksisë qendrore. Dy akademitë kanë ngritur bashkërisht redaksinë qendrore dhe dy redaksitë vendore në vendet gjegjëse. ASHSH ka fituar një mbështetje specifike qysh me buxhetin e këtij viti për *Enciklopedinë shqiptare*.

Në vijim një paraqitje statistikore analitike për tre projektet e mëdha:

⇒ Përbërja e redaksisë qendrore dhe e redaksive të periudhave për projektin e *Historisë së shqiptarëve*, sipas kualifikimit shkencor:


Nr.	Titulli akademik	
1.	Autorë në tërësi	30
2.	Me titull <i>akademik</i>	7
3.	Me titull shkencor <i>prof. / prof. asoc.</i>	22
4.	Me gradën <i>doktor shkencash</i>	1

Me propozim të drejtuesve të grupeve të punës dhe bashkëdrejtuesve të projektit, në grupin e punës u shtuan edhe pesë bashkautorë:

1. Akad. asoc. Gëzim Hoxha (periudha e antikitetit);
2. Prof. dr. Zana Frashëri (periudha e Rilindjes Kombëtare);
3. Prof. asoc. dr. Ermal Bazo (periudha e Mesjetës);
4. Prof. asoc. dr. Agron Islami (periudha osmane);

5. Dr. Zef Preçi (historia e ekonomisë 1945-1990).

Gjatë këtij viti nga autorët e gjithë projektet janë përgatitur dhe dorëzuar pranë QBAE-së 1150 faqe tipografike, të cilat do t'u nënshtrohen fazave të tjera të punës, diskutimeve brenda nëngrupit dhe redaksisë, deri në përfundimin e plotë të veprës. Është parashikuar që vëllimi i parë të dalë nga shtypi gjatë vitit 2023. Autorë kontribuues ndarë sipas periudhave pas plotësimeve në projektin *Histori e shqiptarëve* janë:



Sa i takon projektit të dytë, *Fjalor i madh i gjuhës shqipe*, përmendim:

⇒ U nënshkrua *Shtojca* e marrëveshjes mes ASHSH dhe Akademisë së Studimeve Albanologjike, çka solli një bashkëpunim më të mirë institucional dhe rregulloi frymën e bashkëpunimit.

⇒ Gjatë vitit 2022 u ngrit *Kartoteka e posaçme për hartimin e korpusit të Fjalësisë* (tërësia e fjalëve pa shpjegime e ilustrime që janë futur në këtë kartotekë), si dhe përzgjedhja nga ky korpus i *Fjalësisë* që do të përfshihet në *Fjalor* (rreth 90.000 fjalë).

⇒ Korpusi fjalësor deri tani ka arritur rreth 200.000 njësi (170.000 fjalë + 33.000 njësi frazeologjike).

⇒ Është punuar dhe pothuajse është përfunduar puna për frazeologjinë që do të zërë vend në *Fjalor*. U ndërta dhe u hartua *Korpusi frazeologjik* (më tej *KF*) sipas kërkesave të *Projektit* të ASHSH për hartimin e *fjalorit të madh të*

gjuhës shqipe (më tej *FMGjSh*) me rreth 90.000 fjalë dhe me rreth 10.000 njësi frazeologjike (më tej *njf*).

⇒ *KF* u mbështet së pari te *Fjalori frazeologjik i gjuhës shqipe* (2010), i hartuar nga Jani Thomai (me rreth 9.000 *njf*) dhe u plotësua më tej nga prof. dr. Ali Jashari, duke përzgjedhur mbi 2.000 *njf* të tjera nga kartoteka *ad hoc* e frazeologjisë, e cila përmban rreth 35.000 *njf*, në mbi 75.000 skeda elektronike shembullzimi, të vjela nga fjalorët shpjegues të përgjithshëm, krahinorë e frazeologjike (njëgjuhësh e dygjuhësh), nga botimet me lëndë frazeologjike në periodikë të ndryshëm, nga publicistika, nga krijimtaria gojore popullore, nga vepra të shkrimtarëve më të njohur shqiptarë e nga përkthime etj.

⇒ *Kf*, nga ana leksikografike, u hartua sipas kriterëve të dhëna në *Udhëzuesin për frazeologjinë në FMGjSh*, i përgatitur nga akad. Jani Thomai (maj 2021). Autorët e *KF* mëtojnë që lënda frazeologjike e përzgjedhur nga fondi idiomatik i gjuhës shqipe dhe i trajtuar frazeografikisht për *FMGjSh* të jetë sa më përfaqësuese për një vepër të tillë madhore, që hartohet për herë të parë për leksikon dhe frazeologjinë e gjuhës shqipe.

⇒ Pas miratimit në redaksinë e *FMGjSh*, *KF* do t'u jepet në formë elektronike redaktorëve dhe hartuesve në grupet e hartimit, sipas shkronjave që do të hartojnë, të cilët mund të bëjnë vërejtje për plotësime, heqje a ndryshime, çka i përcillet grupit të autorëve për frazeologjinë. Për këtë arsye, *KF* përmban më shumë *njf* nga sa janë paraparë në *Projektin* e AShSH-së për *FMGjSh*.

⇒ *KF* u dorëzua pranë QBAE-së në fund të vitit 2022 dhe ruhet si *material i rezervuar* deri në përfundimin e publikimin e *FMGjSh*.

Për përgatitjen e *Fjalësit* kanë punuar 6 grupe. Fjalësi pa këto shkronja ka arritur shifrën 143.483 fjalë (pas shkronjat H dhe K). Për shkronjat A, L, Ll, O, Th, për të cilat po punon grupi i hartuesve në IAP, Kosovë, kemi një lëndë të papërpunuar që shkon te 32.000 njësi (në duar kemi 31.923 njësi) që mund të reduktohet në 15.000 njësi. Lënda shumë mund të shkojë mbi 170.000 njësi.

⇒ Procesi i pasurimit të *korpusit* është i hapur. Janë për t'u futur si fjalë të tjera njësitë që do të përzgjidhen:

1. Nga vepra e I. Kadaresë (është e lematizuar);
2. Nga vepra e M. Camaj (është e lematizuar);
3. Nga ditari i R. Qoses (është bërë përzgjedhja);
4. Nga autorë të tjerë (ka përgatitur një fjalës prof. Shefkije Islamaj);
5. Nga leksiku politiko-shoqëror (ka përgatitur material prof. M. Samara);
6. Nga fjalorët dygjuhësh (prof. V. Memisha ka dorëzuar 11.000 njësi) etj.

Gjatë vitit 2022 u bë ndarja e shkronjave sipas formimit të autorëve dhe u bë riorganizimi përfundimtar për përshtatjen midis shkronjave e hartuesve. U propozuan dhe u miratuan hartues të rinj, duke i plotësuar kërkesat e çastit por dhe të perspektivës së realizmit të veprës.

Numri i hartuesve tashmë është gjithsej 27 vetë (duke qenë këtu të përfshirë dhe anëtarët e redaksisë së *Fjalorit*).

Studiuesit që marrin pjesë në hartimin e veprës dhe ndarja e punës:

Nr	Drejtuesit & grupet	Emër, mbiemër, pozicioni	shkronjat	(2006, bruto)
1.	Drejtues projekti	1. Akad. Jani Thomai 2. Prof. dr. Valter Memisha, sekretar shkencor		
2.	Kryeredaktor	Akad. Jani Thomai		
3.	Zëvendëskryeredaktorë	1. Prof. dr. Valter Memisha 2. Prof. dr. Shezai Rrokaj		
4.	Grupi I	1. Akad. J. Thomai, redaktor / (hartues) 2. Prof. dr. Ali Jashari (hartues)	Frazeologji B,D	11.000 njësi 98 f.
5.	Grupi II	1. Prof. dr. Miço Samara, redaktor / (hartues) 2. Prof. dr. Artur Lamaj (hartues) 3. Prof. dr. Tomorr Planganica (hartues) 4. Prof. as. dr. Juliana Kume (hartues) 5. Prof. as. dr. Teuta Toska (hartues)	K C E, Ë H Ç,DH	70 f. 14 f. 18 f. 22 f. 25 f.
6.	Grupi III	1. Prof. dr. Valter Memisha, redaktor / (hartues) 2. Dr. Manjola Zaçellari (hartues) 3. Ma. Engjellushe Karaj (hartues) 4. Prof. dr. Qemal Murati (hartues)	P I,X, Y, XH,O N,NJ Lek. dialektor	110 f. 29 f. 45 f. 6. 300 njësi
7.	Grupi IV	1. Akad. Gjovalin Shkurtaç, redaktor / (hartues) 2. Prof. as. dr. Idriz Metani (hartues) 3. Prof. dr. Mimoza Prikaj (hartues) 4. Prof. as. dr. Rezarta Draçini (hartues) 5. Ma. Petrit Zenelaj (hartues)	J Z,ZH SH S V	8 f. 31 f. 55 f. 42 f. 42 f.
8.	Grupi V	1. Prof. dr. Shefkije Islamaj, redaktore / (hartues)e 2. Prof. as. dr. Naim Berisha (hartues) 3. Dr. Viktor Bakillari (hartues) 4. Prof. as. dr. Abdurrahim Maxhuni (hartues) 5. Dr. Sejdi Gashi (hartues)	A L T TH LL, O	33 f. 46 f. 38 f. 11 f. 14 f.
9.	Grupi VI	1. Prof. dr. Shezai Rrokaj, redaktor / (hartues) 2. Prof. dr. Anila Omari (hartues) 3. Prof. as. dr. Anila Kananaj (hartues) 4. Prof. as. Dr. Rozana Rushiti (hartues) 5. Dr. Behar Hoxha (hartues) 6. Dr. Resul Telhaj (hartues)	F R M, Q,GJ RR G,U	40 f. 20 f. 51 f. 41 f. 23 f. 43 f.

Pasqyrë e ndarjes së punës midis autorëve dhe e përpjesëtimit midis shkronjave në *Fjalorin* e vitit 2006 (Botim i ASHSH)

Të dhëna mbi buxhetin në mbështetje të tre projekteve madhore në albanologji

REALIZIMI I PROJEKTEVE ALBANOLOGJIKEPER VITIN 2022

Nr	ZERAT E SHPENZIMEVE	Buxheti fillestar	Pakesimi sipas kerkeses nr date	Buxheti I ndryshuar 2022	Realizimi Janar-dhjetor	Parashikimi per pagesa autoresh sipas volumit sipas VKA 31, date 15.04.2021	Tatime te derdhura paradhenie	Totali Vjetor 2022
I	Projektet albanologjike	30,000,000	4,250,000	25,750,000	10,928,040	13,225,625	1,596,335	25,750,000
	Nga te cilat:							-
a	Projekti I Historise	8,410,535		8,410,535	2,444,200	5,170,000	796,335	8,410,535
b	Projekti I Fjalori I Gjuhes Shqipe	15,270,925	4,250,000	11,020,925	2,165,300	8,055,625	800,000	11,020,925
c	Projekti Enciklopedia	871,200		871,200	871,200	-		871,200
e	Pagesat e Stafit	5,447,340		5,447,340	5,447,340			5,447,340
	Totali	30,000,000	4,250,000	25,750,000	10,928,040	13,225,625	1,596,335	25,750,000

Pasqyrimi financiar i realizimit të projekteve 2021-2022 dhe pritshmëria për vitin 2023:

Nr	ZERAT E SHPENZIMEVE	Vlera e Projektit	Totali Vjetor 2021	Totali Vjetor 2022	Totali 2021-2022	E pritshme 2023
I	Projektet albanologjike		6,622,887	24,227,349	30,850,236	55,000,000
	Nga te cilat: sektori ndihmës		618,987	5,526,649	6,145,636	7,000,000
a	Projekti I Historise	41,000,000	3,691,500	7,614,200	11,305,700	10,000,000
b	Projekti I Fjalori I Gjuhes Shqipe	38,261,000	2,094,600	10,215,300	12,309,900	18,000,000
c	Projekti Enciklopedia	447,225,000	217,800	871,200	1,089,000	20,000,000
II	Investimet Paisjet		3,766,900	-	3,766,900	-
	Totali	526,486,000	10,389,787	24,227,349	34,617,136	55,000,000

⇒ *Viti i nanoshkencës, nanoteknologjisë dhe bioteknologjisë.*

Njësia *NanoAlb* zgjeroi grupet e interesit dhe të pjesëmarrjes, organizoi *Kongresin e dytë Ndërkombëtar NanoBallkan* dhe ka ambicien për një kongres europian këtë vit. Kongresi Botëror i Nanoteknologjisë (*Trends in Nanotechnology International Conference, TNT2022 NanoBalkan*) u realizua më 4-8 tetor 2022. Ky kongres mbledhi në Tiranë studiues nga e gjithë bota dhe veçanërisht nga Ballkani duke hedhur hapin e parë për realizimin e një konference *NanoBalkan* në vitin 2023. Krahas seancave plenare, programi i konferencës përmbante dhe veprimtari të tjera si:

- a). *Nanobiosensors school / Shkolla e nanobiosensorëve;*
- b). *3rd Workshop - Cooperation event between Albania, Japan and Spain (workshop-i i 3-të i bashkëpunimit ndërmjet Shqipërisë, Spanjës e Japonisë);*
- c). *SUSNANO kick-off meeting* (takimi prezantues i projektit *Twining SUSNANO*);
- d). *Training workshop: Practical advice on how to write Horizon Europe grant proposals* (wokshop trajnues: *Këshilla praktike se si të shkruhen propozimet për grante të Horizon Europe*);

⇒ *Viti i bioteknologjisë dhe gjenetikës.*

Me krijimin e *qendrës së bioteknologjisë dhe gjenetikës* u fuqizua poli i shkencave të jetës dhe përgjithësisht i shkencave natyrore e teknike në kuadër të veprimtarisë shkencore të institucionit. Disa nga prioritetet dhe veprimtaritë më të rëndësishme të kësaj qendre kanë qenë:

- a). *Përzgjedhja e materialit bimor të kumbullës, të kontrolluar nga viruset sipas protokollit, për krijimin e impiantit pilot nëpërmjet shëndetësisimit dhe mikroshumimit, në funksion të fillimit të certifikimit të materialit mbjellës, koordinuar nga akad Efigjeni Kongjika.*
- b). *Studimi seroepidemiologjik i gjendjes imunitare ndaj virusit SARS-CoV-2 në popullatën shqiptare, koordinatorë akad. Genc Sulcebe e prof. asoc. Alban Ylli.*

Konferenca dhe seminare nga kjo qendër:

- c). *Forumi shkencor Kërkime në gjenetikën e popullatës shqiptare (7.06.2022).* Ky forum u zhvillua në kuadrin e veprimtarive të organizuara nga komisioni i biologjisë, bujqësisë dhe veterinarisë në bashkëpunim me komisionin e mjekësisë për të mbështetur veprimtaritë kërkuese të Qendrës kërkimore të bioteknologjisë dhe gjenetikës.
- d). *Konferenca e 4-të ndërkombëtare për bioteknologjinë e aplikuar – ICAB-2022 (20-21 tetor 2022), u zhvillua në ambientet e Universitetit të Janinës,*

Greqi. Konferenca u organizua nga departamenti i bioteknologjisë i Fakultetit të Shkencave të Natyrës të Universitetit të Tiranës, Akademia e Shkencave, në bashkëpunim me Universitetin e Janinës dhe EBTNA-*Shoqata Europiane e Rrjetit Tematik të Bioteknologjisë*;

e). 2 nd EuroBiotech Training School (17-19 tetor 2022) në bashkëpunim me FSHN, UT, dhe EBTNA- European Biotechnology Network Association. Kjo veprimtari u zhvillua gjithashtu në kuadër të Javës së bioteknologjisë.

Puna kryesore e qendrës ka qenë e përqendruar në ngritjen dhe pajisjen e strukturave laboratorike.

⇒ Viti i Kongresit Botëror të Studiuesve të Baladave.

Kongresi Ndërkombëtar i Studiuesve të Baladave u organizua për herë të parë në Shqipëri (pas 50 edicionesh të mëparshme zhvilluar nëpër Botë).

Për këtë u themelua pranë ASHSH komisioni kombëtar i studiuesve të baladave, që përfaqëson vendin tonë tashmë në *International Ballad Commission*.

Përgatitjet për këtë ngjarje të madhe u bënë përgjatë dy vjetëve, në bashkëpunim me organizata dhe qendra ndërkombëtare të kësaj fushe.

Morën pjesë 66 studiues, nga 30 vende, të cilët referuan gjatë 4 ditëve (një ditë turistike), nga të cilët gjysma studiues shqiptarë nga vendi, Kosova, Maqedonia e Veriut dhe ngulimet historike.

Presidentja e *International Ballad Commission* Marjetka Golež-Kaučič (Akademia e Shkencave e Sllovenisë) përgëzoi Akademinë e Shkencave të Shqipërisë dhe kryetarin e saj akad. Skënder Gjinushin për mundësimin e mbajtjes së konferencës në institucionin më të lartë shkencor në Shqipëri, për cilësinë e organizimit të veprimtarisë, që u përshëndet e përgëzua edhe nga *Shoqata Amerikane e Folkloristëve*.

⇒ Viti i panairit të parë mbarëkombëtar të botimeve akademike e shkencore, veprimtari e përbashkët me ASHAK-un provoi se kjo nismë është në shërbim të lehtësimit të rrugës së vështirë të librit akademik dhe shkencor për të mbërritur tek lexuesi. Në panair morën pjesë 33 institucione dhe ente botuese; u mbajtën mbi 50 përurime dhe u ekspozuan mbi 2000 tituj për lexuesit e interesuar. Nga këto promovime 10 tituj ishin prej tyre janë botime te Akademisë së Shkencave. Ky panair pati si qëllim të bëjë të njohura arritjet më cilësore në botimet akademike, shkencore dhe universitare në të gjithë hapësirën shqiptare, duke synuar një prani përfaqësuese sa më të

gjerë, duke bërë bashkë autorët, botimet, institucionet e kërkimit që merren me botimet dhe studimet dhe mbi të gjitha është një mundësi për publikun e gjerë që së bashku të çmojmë rëndësinë që kanë studiuesit, autorët, shkenca për një shoqëri moderne. Panairi pati një karakter promovues e manifestues, me pjesëmarrje të hapur, pasi mundësoi pranëvendosjen në sasi dhe cilësi të botimeve shkencore dhe të autorëve të tyre nga gjithë hapësira shqiptare, duke synuar që në një të ardhme të jenë të pranishme edhe botimet nga qendrat albanologjike në botë, ku do të kenë vendin e tyre të merituar edhe botimet cilësore nga ente jopublike.

⇒ Viti i konkursit të çmimeve të mëdha kombëtare, i ndërprerë që nga viti 2018 për shkak të pandemisë, vijim i konkursit për çmimin ndërkombëtar Trinia e albanologjisë akodruar vitin e kaluar dhe konkursit të çmimit të karrierës, rregulluar me akte të njësuara tashmë dhe zhvilluar më vete vitin e kaluar, me këto të dhëna:

- a). Morën pjesë 27 studiues, pjesa më e madhe nga radhët e profesoratit;**
- b). U bë përzgjedhja e parë dhe më pas nonimini për 9 vepra;**
- c). U shpallën tre fituesit e çmimeve; për herë të parë u akordua edhe çmimi Aleks Buda (për studiuesit e rinj).**
- d). U rregullua me akt njësuës dhënia e mirënjohjes *Nderi i Akademisë*.**

II. Projekte të realizuara në fusha të tjera gjatë vitit 2023

1. Projekte shkencore gjithsej:	15
2. Projekte ndërkombëtare dhe të ASHSH	10
3. Bashkëfinancime të AKKSHI-t dhe ASHSH	5

1. Projekte ndërkombëtare dhe të ASHSH, paraqitje analitike

Titulli i projektit (COD)	Drejtues	Ecuria
VITROCERT	Efigjeni Kongjika	<p><i>Përzgjedhja e materialit bimor të kumbullës, të kontrolluar nga viruset sipas protokollit, për krijimin e impiantit pilot nëpërmjet shëndetësimit dhe mikroshumimit, në funksion të fillimit të certifikimit të materialit mbjellës</i></p> <p>Janë kryer ekspedita, izolimi i eksplanteve nga drurët e etiketuar dhe është përgatitur raporti me përshkrimin e ekosistemeve dhe drurëve të etiketuar nga janë marrë eksplantet në pranverë në konsultim dhe me fermerët e zonave; është bërë përzgjedhja e CVS të kumbullës me konsultim të pomologëve, biotekno-logëve, biologëve molekulare, biznesit privat dhe realizimi i disa ekspeditave në vendet e</p>

		<p>originës të <i>cv. tropojane</i> (Pukë dhe Kukës); testim gjenetik i sythave nga bimët mëma; testim fitosanitar i sythave të izoluar; stabilizimi i protokolleve; janë marrë materialet në dorëzim.</p> <p>Projekti do të vijojë në vitin 2023-2024.</p>
<p>Përgjigjja imunitare (seroprevalenca) e popullsisë shqiptare ndaj pandemisë së infeksionit nga Covid-19</p>	<p>Genc Sulçebe</p>	<p>Testim laboratorik për fazën e 4-t të projektit iniciuar në prill 2020, studim i ecurisë së pandemisë Covid-19 ku situata kalon nga gjendja epidemike në atë endemike.</p> <p>Nga puna në laborator dhe qendra shëndetësore janë marrë dhe përpunuar mostrat, me të cilat është procesuar regjistrimi, centrifugimi, ndarja e serumeve, ruajtja në frigorifer etj; janë matur çdo ditë antitruapat IgG anti-nukleokapsid dhe anti-S1-SARS-CoV-2 për të gjithë individët e Q.Sh e përfshira në fazën e 4-t; intervista me individë që kanë kryer dozën e tretë të vaksinës. Është kryer përpunimi statistikor i rezultateve, si dhe diskutimi i punës së kryer të ndarë në grupmosha. Rezultatet e aktivitetit kërkimor të grupit të punës mbi COVID-19 u paraqiten në forumin e 4-t mbi pandeminë Covid-19. Në vazhdimësi do të përfundojë studimi mbi gjendjen dinamike të përgjigjes imunitare ndaj infeksionit COVID-19 (nga fillimi deri në fund).</p>
<p>Banka gjenetike</p>	<p>Ilia Mikerezi</p>	<p>Janë marrë materialet e punës dhe është proceduar sipas planit.</p>
<p>2. Pesë projekte që i përkasin qendrës NanoAlb - Ignite Projects miratuar me vendimin nr. 31 datë 27.05.2022</p>		

PvaNANOMat	Partizan Malkaj	Janë marrë materialet e punës dhe është proceduar sipas planit.
HMF-Sens	Liridon Berisha	<i>Zhvillimi i një sensori të ri elektrokimik për kontrollin e cilësisë së mjalit:</i> Janë kryer aktivitet: eksperimentim në gjetjen e modifikuesit dhe mënyrës së modifikimit;
NANOBIOTOX	Ledia Vasjari	<i>Studimi i bashkëveprimit nanobionanopjesëzave dhe nanomaterialeve të modifikuara me organizmat e gjallë dhe qelizat e tyre duke përdorur eksperimente in-vivo dhe modelet kompjuterike</i> Janë kryer eksperimente mbështetëse, janë kryer përgatitjet për shkëmbimit shkencor te partneri Universiteti i Teramo-s, Itali.
CERTWINE	Kledi Xhaxhiu	Në 3-mujorin e parë të punës është përmbushur me sukses objektivi i parë - grumbullimi dhe skedimi i literaturës shqiptare dhe të huaj mbi studime të mëparshme të kryera lidhur me praninë e antioksidantëve në verëra etj., efekti që ato kanë në cilësinë e pijeve të ndryshme, metodat më të përdorshme për përcaktimin e tyre etj. Po kështu grupi i punës është fokusuar gjatë kësaj periudhe edhe në mbledhjen e varieteteve të mostrave të verërave në Shqipëri. Është marrë në dorëzim nga firma fituese pjesa kryesore e materialeve të punës. Mbeten ende pa lëvruar 4 zëra nga lista e kërkuar për këtë vit, të cilët pritet të lëvrohen deri në fundin e vitit.

		Projekte për njësinë <i>Arkeo-Bylis</i> dhe për njësinë për arbëreshët, miratuar nga Kryesia
BIOSENSTOXIC	A. Bacu	Janë marrë materialet e punës dhe është proceduar sipas planit.
<i>ArkeoBylis - gërmime</i>	Neritan Ceka	Projekti është realizuar në muajin nëntor 2022 dhe ka përfunduar tashmë duke dorëzuar Raportin mbi kërkimet gjeofizike dhe topografike në tre sektorë të qytetit antik të Bylisit që shërbyen për identifikimin e strukturave nëntokësore arkeologjike si dhe për rezultatet e rilevimit topografik me dron për realizimin e modelit 3D të terrenit tëqytetit antik tëBylisit.
Njësia për arbëreshët <i>Barleti i rigjetur - botimit italisht i dorëshkrimit të panjohur të Barletit</i>	Matteo Mandalà	Miratuar nga Kryesia

3. Projekte të bashkëfinancuara nga Akademia dhe Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI):

Projekti	Drejtues	Përshkrim
Vlerësimi zonal dhe kohor i paramet-	Rrapo	Grupi i punës ka dalë në terren për ekspeditë, janë kryer përcaktimi

<p>rave fizike, fiziko-kimikë dhe sizmikë të rrjedhjes së nxehtësisë dhe modelimi i energjisë gjeoter-male në zonën e Elbasanit</p>	<p>Ormëni</p>	<p>gjeohapsinor i zonës së studimit në terren, matja e temperaturës së burimeve për të përcaktuar kapacitetin energjetik gjeotermik, si dhe marrja e mostrave për analizat fiziko-kimike.</p>
<p>QTTB Vlore - Përdorimi i metodave bioteknologjike in vitro dhe të biologjisë molekulare në përpjekje për të fituar material mbjelles të kategorise baze të kultivareve autokton të kumbulles</p>	<p>Efigjeni Kongjika</p>	<p>Është bërë hartimi i raporteve të përshkrimit të ekosistemeve dhe drurëve të zgjedhur dhe të etiketuar për marrje eksplantesh / mostrash nga sythe të fjetur të dy kultivarëve të kumbullës në pranverën e hershme.</p> <p>Paraqitja e literaturës së shfrytëzuar për hartimin e protokolleve të procedurave të kërkimit (shëndetësim, mikroshumim, testim fitosanitar dhe gjenetik, prodhim bimëzash in vitro e ambientim, prodhim fidanësh e shërbim në sera).</p> <p>Raporte për protokollet e përdorura për marrjen e mostrave, shëndetësimin e termoterapinë, testimin fitosanitar dhe gjenetik, mikroshumimin e ambientimin, shërbimeve të fidanëve.</p>
<p>Karakterizimi i variabilitetit gjenetik në popullatat njerezore shqiptare sipas markereve gjenetike të ADN-se</p>	<p>Ilia Mikerezi</p>	<p>Është hartuar plani i zonave të kampionimit të materialit biologjik; janë marrë masat e nevojshme që do të shërbejnë për ruajtjen e kampioneve biologjike; janë marrë disa kampione biologjike; në pritje për shpenzime operative.</p> <p>Në vazhdim veprimtaritë për mbledhjen e kampioneve biologjike.</p>
<p>Zhvillimi i metodave alternative, inovative dhe ekonomike për</p>	<p>Majlinda Vasjari</p>	<p>Është kryer eksperimentim në laborator i sensorëve të modifikuar (është studiuar analiti i cili është objekt studimi (hydroxymethylfurfural, HMF - vetitë e</p>

<p>kontrollin e cilësisë se produkteve ushqimore</p>		<p>HMF si një përbërje organike e formuar nga dehidratimi i sheqernave reduktuese; ndikimet e HMF-së dhe derivateve në shëndetin e njeriut; janë evidentuar metodat ekzistuese për përcaktimin e HMF-së; ka nisur puna eksperimentale në lidhje me përgatitjen e modifikuesit të oksidit të grafitit; si dhe është kryer një vizitë në Universitetin e Pardubicës – partner në projekt.</p> <p>Ky projekt është i bashkëfinancuar edhe nga projektet NanoAlb 2022-2023 <i>Zhvillimi i një sensori të ri elektrokimik për kontrollin e cilësisë së mjaltit</i>, me fond prej 2.000.000 lekë për dy vite (2022-2023)</p> <p>Është organizuar workshopi mbi projektet fituese “NanoAlbIgniteProjects” në datat 14-15 Dhjetor 2022.</p>
<p>Modifikimi i sensorëve të printuar me nanomateriale për përcaktimin e antibiotikeve në ujëra</p>	<p>Majlinda Vasjari</p>	<p>Projekt bilateral me TUBITAK në Turqi – i miratuar</p> <p>Në pritje të dërgimit të kontratës nga AKKSHI</p>

III. Plotësime në struktura (njësi, qendra)

Brenda hapësirave ligjore ekzistuese u pranuan anëtarë të rinj në komisionet e përhershme, u rregullua me standard statusi i bashkëpunëtorit në to, u fuqizua autoriteti i strukturave të reja të themeluara mbi bazën e situatës së re ligjore:

⇒ Krijimi i njësive të reja kërkimore të përkohshme si:

1. Instituti Kombëtar i Matematikës (IKM);
2. Zgjatja e afatit për njësinë ekzistuese NanoAlb dhe ngritja në shkallën e një qendre kërkimore afatgjatë;

3. Qendra kërkimore e bioteknologji-gjenetikës ka nënshkruar një marrëveshje me Drejtorinë e Policisë së Shtetit;
4. Njësia e inteligjencës artificiale ka bërë një studim për gjendjen e kësaj disipline në departamentet universitare, dhe ka planifikuar zhvillimin e veprimtarive në 2023;
5. Njësia e energjetikës bashkëpunon ngushtë me grupin e energjetikës pranë ASHAK për studimin e burimeve alternative dhe të ripërtëritëshme të energjisë.

⇒ Themelimi i Institutit të Matematikës:

Krijimi i Institutit Kombëtar të Matematikës (IKM) ishte një nismë që u ndërmor nga një grup matematikanësh brenda dhe jashtë Shqipërisë. Instituti Kombëtar i Matematikës është njësi bashkëpunimi dhe koordinimi shkencor në fushat e matematikës me institutet, universitetet, akademitë dhe me institucione të tjera të mirëfillta shkencore, kombëtare e ndërkombëtare. Anëtarët e IKM-s vijnë nga komuniteti shqiptar i matematikanëve të angazhuar në sferën akademike, në ekonomi, në mësimdhënie, përfshirë edhe studentët doktorantë. IKM është strukturë që funksionon brenda Akademisë së Shkencave.

⇒ Ngritja e një njësie në fushën e gjeoshkencave dhe gjeoinxhinierisë:

Një grup kërkuesish nga institucione të ndryshme të vendit së bashku me akad. asoc. Rrapo Ormeni hodhën një projekt ide për ngritjen e një njësie afatshkurtër kërkimore në fushat e shkencave të tokës. Ideja u paraqit në komisionin e Inxhinierisë dhe pas shqyrtimit të projektidesë dhe diskutimeve u ngrit një grup që do të rishikonte emërtimin e kësaj njësie.

Veprimtaria shkencore e ASHSH gjatë vitit 2022

Të dhëna të përgjithshme:

Veprimtari të nivelit të Akademisë			
Nga SSHSHA:	46	Nga SSHNT:	3
Veprimtari të nivelit të seksioneve			
Nga SSHSHA:	41	Nga SSHNT:	11
Veprimtari të njërive			
Nga SSHSHA:	14	Nga SSHNT:	10
Veprimtari të komisioneve			
Nga SSHSHA:	33	Nga SSHNT:	10
Gjithsej: 134 + 34 =			168

Kongrese/konferenca ndërkombëtare

Të organizuara nga Akademia			
Përkatësisht nga SSHSHA:	4	Përkatësisht nga SSHNT:	2
Të organizuara prej seksioneve			
Nga SSHSHA:	9	Nga SSHNT:	1
Të organizuara prej njërive			

Nga SSHSHA:	4	Nga SSHNT:	2
Të organizuara prej komisioneve			
Nga SSHSHA:	8	Nga SSHNT:	1
Gjithsej: 23 + 6 =			31

Kongrese/konferenca kombëtare

Të organizuara nga Akademia			
Përkatësisht nga SSHSHA:	11	Përkatësisht nga SSHNT:	1
Të organizuara prej seksioneve			
Nga SSHSHA:	11	Nga SSHNT:	2
Të organizuara prej njësave			
Nga SSHSHA:	3	Nga SSHNT:	3
Të organizuara prej komisioneve			
Nga SSHSHA:	8	Nga SSHNT:	1
Gjithsej: 33+7 =			40

Simpoziume, seminare, forume, workshope, përrurime:

Të organizuara nga Akademia			
Përkatësisht nga SSHSHA:	31	Përkatësisht nga SSHNT:	-
Të organizuara prej seksioneve			

Nga SSHSHA:	21	Nga SSHNT:	8
Të organizuara prej njësive			
Nga SSHSHA:	7	Nga SSHNT:	5
Të organizuara prej komisioneve			
Nga SSHSHA:	17	Nga SSHNT:	8
Gjithsej: 76 +21 =			97

I/1 Veprimtaria e SSHSHA gjatë vitit 2022

SSHSHA ka ruajtur gjatë gjithë vitit një ritëm shumë të lartë të organizimit të aktiviteteve shkencore, promovuese, botuese e jubilarë. Kanë qenë intensive bashkëpunimet me institucione kërkimore-shkencore apo shtetërore: universitete, organizata joqeveritare apo individë të shquar në fushën e shkencës.

Veprimtaritë kryesore të SSHSHA shprehur në statistika:

I. Konferenca shkencore e jubilarë, mbarëkombëtare e ndërkombëtare:

- 50-vjetori i themelimit të ASHSH;
- 50-vjetori i mbajtjes së Kongresit të Drejtshkrimit;
- Studimet dhe kritika letrare sot (bashkëpunim me ASHAK-un);
- Java e Drejtshkrimit (bashkëpunim me Kryeministrinë);
- Konferenca shkencore kombëtare *Gjuha dhe norma letrare sot*, organizuar në Prishtinë, bashkëpunim me ASHAK-un;
- 110-vjetori i Pavarësisë (bashkëpunim me ASHAK-un);
- 100-vjetori i vendosjes së marrëdhënieve shqiptaro-amerikane;

- Kongresi i 50-të Ndërkombëtar i Studiuesve të Baladës (bashkëpunim me *International Balad Commission*);

Disa veprimtari për t'u veçuar:

1. Panairi i parë i librit shkencor e akademik;
2. Kontribut për zgjerimin e radhëve të *anëtarësisë së nderit* me personalitete nga bota akademike dhe me kontribut për shqiptarët: pranimi i kryetarit të ALLEA-s A. Loprieno dhe organizimi i ceremonisë për albanologun Joseph Brian;
3. Rregullimi juridik i statusit të fituesit të mirënjohjes *Nderi i Akademisë*; krijimi i regjistrit të mirënjohjeve; evidentimi i figurave me kontribut akademik të suksesshëm që kanë mbetur jashtë radhëve të trupës akademike për arsye procedurale; përzgjedhja dhe propozimi i kandidatave për nderim gjatë vitit të kaluar në rastet jubilarë të përmendura, posaçërisht për merita në zhvillimin dhe stabilizimin e gjuhës së njësuar letrare shqipe; përgatitja e dokumentacionit dhe argumentimi i propozimeve për 19 personalitete të shkencës dhe kulturës për dhënien e kësaj mirënjohjeje (Shtojca në vijim).
4. Zhvillimi i procedurave të parashikuara në Ligjin 53/2029 e në Statutin e Akademisë për shqyrtimin e 8 kandidatave të regjistruara për fushat e hapura të hapura për konkurrim me vendim të Asamblesë (nga të cilat 5 kandidatura të kualifikuara për kriteret teknike);
5. Organizimi i konkursit kombëtar për çmimet e mëdha që jepen nga Akademia e Shkencave (konkursi për çmimet *Çabej* dhe *Buda*), përmes pjesëmarrjes në juri, ekspertimeve, oponentëve, recensioneve, hartimit të motivacioneve gjatë tri fazave: vlerësim teknik, nominim dhe shpallje e fituesve. Nga 27 tituj të regjistruar në konkurs mbi 80 për qind ishin nga shkencat shoqërore dhe albanologjike. U organizua paraqitja e referimeve nga konkurruesit, diskutimi shkencor dhe ceremonia e fituesve.
6. Pjesëmarrje e anëtarëve të SSHSHA dhe e bashkëpunëtorëve të tij në konferenca shkencore ndërkombëtare (Paris, Budapest, Romë, Napoli, Ljublanë, Sofje, Shkup, Prishtinë, Tetovë, Ulqin).

Paraqitje analitike e veprimtarive më të rëndësishme sipas kronologjisë

1. Konferenca jubilarë 50-vjet Akademia e Shkencave e Shqipërisë (1972-2022).

Kjo konferencë ishte veprimtaria më e rëndësishme në kuadër të një vargu ligjëratash akademike, forumesh, tryezash debati, të zhvilluara në linjë dhe me pjesëmarrje fizike në kuadër të *Vitit të Akademizmit Shqiptar*. Festimet jubilarë të 50-vjetorit të themelimit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë u zhvilluan nga data 9 deri më 11 tetor, me seancën plenare të zhvilluar në ambientet e Kuvendit të Shqipërisë. Në këtë aktivitet morën pjesë autoritetet më të larta të shtetit shqiptar dhe personaliteteve shkencore nga akademitë simotra ballkanike dhe europiane (7 delegacione), nga institucionet shkencore dhe arsimore të Shqipërisë, personalitete të shquara të shkencave shoqërore e albanologjike, të shkencave natyrore e teknike, të botës së artit, drejtues të arsimit të lartë në vend, por edhe familjarë të akademikëve, që themeluan institucionin e Akademisë së Shkencave, përfshirë edhe të atyre firmëtarë, të ndarë nga jeta. Në këtë kuadër u akordua titulli akademik *anëtar nderi* Presidentit të ALLEA-s (*All European Academies*) Antonio Loprieno. Po në këtë kuadër u vlerësuan me mirënjohjen *Nderi i Akademisë* këto personalitete të fushave të mbuluara nga SSHSHA: Dhimitër Anagnosti, Sali Shijaku (pas vdekjes), Shpresa Gjongecaj, Neritan Ceka dhe Seit Mansaku (Tiranë, 10 tetor 2022).

Për vlerësimet që u bënë punës së Akademisë së Shkencave në këtë ngjarje shkencore shih shtojcën *Vlerësime të institucioneve*.

2. Konferencë shkencore-jubilarë në 50-vjetorin e mbajtjes së Kongresit të Drejtshkrimit (ASHSH dhe ASHAK).

Në këtë aktivitet morën pjesë gjithashtu autoritetet më të larta të shtetit shqiptar, nga Kosova, Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut; firmëtarë të Kongresit të Drejtshkrimit (1972), personalitete shkencore të gjuhësisë nga të gjitha trevat shqipfolëse dhe nga diaspora, si dhe familjarë të ftuar të firmëtarëve të *Kongresit të Drejtshkrimit*.

U rikonfirmua solemnisht se *Kongresi i Drejtshkrimit* mbetet një prej ngjarjeve shkencore vendimmarrëse shumë të rëndësishme, në të cilën aspekti shkencor dhe kombëtar ishin parësorë ndaj atij ideologjik. Ky kongres hapi rrugën e një zhvillimi të rëndësishëm për rrugëtimin e gjuhës shqipe moderne dhe unifikimin e saj zyrtar në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni e Veriut, Mal të Zi dhe diasporë. Në këtë ditë u bë edhe nderimi me mirënjohjen *Nderi i Akademisë* i 87 delegatëve të Kongresit të Drejtshkrimit, si dhe vlerësimi po me këtë mirënjohje i personaliteteve me kontribut në zhvillimin, pasurimin dhe mbrojtjen e njësisë së gjuhës: Emil Lafe, Enver

Hysa, Zija Çela, Gaqo Bushaka, Koço Kosta, Kolë Ashta, Remzi Përnaska, Anastas Dodi, Musine Kokalari, Lasgush Poradeci, imzot Simon Filipaj (pas vdekjes). Në kuadër të këtij jubileu, në Prishtinë u organizua konferenca shkencore *Shqipja standarde sot*, ku u paraqitën rreth 40 referime, në të cilat u theksua rëndësia shkencore e kombëtare e njësimin të gjuhës letrare si faktor parësor për forcimin e identitetit të përbashkët gjuhësor e kombëtar; si dhe u bënë propozime për përbashkjen e njësisë gjuhësore me sfidat që lidhen me progresin teknologjik dhe me funksionimin e saj në shoqëri të hapur.

3. Në bashkëpunim me Kryeministrinë u organizua *Java e Drejtshkkrimit*, me pjesëmarrje të studiuesve më të njohur nga e gjithë hapësira shqiptare, ku u referuan 24 trajtesa.

4. Në Kongresin e 50-të Ndërkombëtar të Studiuesve të Baladës, që zgjati 5 ditë, organizuar nga Akademia e Shkencave dhe *International Ballad Commission*, për të cilin u punua gjatë dy vjetëve, morën pjesë mbi 70 studiues nga 35 vende dhe u referua nga mbi 30 studiues shqiptar. *International Ballad Commission* e vlerësoi përgatitjen shkencore dhe organizuese nga pala mikpritëse të shkëlqyer.

Veprimtari shkencore ndërkombëtare e kombëtare të SSHSHA

I. Konferenca ndërkombëtare

⇒ *Shqiptarët dhe hebrenjtë para dhe gjatë Luftës së Dytë Botërore - empati në kohë rreziku*, veprimtari në *Ditën e Kujtesës* (Tiranë, 27 janar 2022);

⇒ Konferencë shkencore në përkujtim të 210-vjetorit të lindjes së albanologut të shquar *Johann Georg von Hahn* (Tiranë, 31 mars 2022);

⇒ *Akademia e Re e Voskopojës* - përrurim i botimit të akteve të konferencës shkencore ndërkombëtare kushtuar 250-vjetorit të qytetërimit të Voskopojës dhe shekullit të iluminizmit në Ballkan, me rastin e 50-vjetorit të themelimit të Akademisë së Shkencave (Tiranë, 15 prill 2022);

⇒ Konferencë shkencore *Shteti i së drejtës në këndvështrimin e studiuesve të drejtësisë në diasporë*, me pjesëmarrjen e studiuesve të shquar të së drejtës në diasporë dhe me bashkëpunimin e akademikëve dhe profesorit të universiteteve në Shqipëri (Tiranë, 19-20 maj 2022);

⇒ *Historia e akademizmit shqiptar - Primo seminario (periudha e parë) kolegjet, seminarët, katedrat e para të shqipes në Itali dhe në mjediset arbëreshe me ligjëratat e studiuesve: Marcos Foscolo, Pietro di Marco; Marco Moroni; Ardian Ndreca; Gëzim Gurga; Francesco Altimari; Matteo Mandalà; Stefano Parenti (Tiranë, 27 maj 2022);*

⇒ *Kritika dhe studimet letrare shqipe në shekullin XXI, organizim i përbashkët i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës dhe i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Në këtë konferencë njëditore u paraqitën afro dyzet kumtesa nga studiues të kësaj fushe nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi, në të cilat u trajtuan zhvillimet kryesore në këtë fushë në dy dhjetvjeçarët e parë të shekullit XXI (Prishtinë, 10 qershor 2022);*

⇒ *Baladat dhe audienca në kohë dhe në hapësirë, me pjesëmarrjen e mbi 60 studiuesve të kësaj fushe nga e gjithë bota: studiues nga Shqipëria, studiues arbëreshë të Italisë, studiues nga Kosova e Maqedonia e Veriut, studiues shqiptarë që jetojnë jashtë vendit dhe punojnë në universitete e në qendra kërkimore (Tiranë-Gjirokastrë, 1-5 shtator 2022).*

⇒ *Rol organizues e pjesëmarrje me disa kumtesa në Takimin XVII Ndërkombëtar të Institutit “Alb-Shkenca”, me temën bosht Bashkëveprimi shkencor në trojet shqipfolëse (Tiranë, 30 shtator – 2 tetor 2022).*

⇒ *Pjesëmarrje në konferencën e organizuar nga katedra e albanologjisë në Universitetin e Beogradit, në 100-vjetorin e themelimit, me dy studiues (Beograd, 29 tetor 2022);*

⇒ *Veprimtari jubilarë shkencore Një komb – një gjuhë letrare, në nderim të 50-vjetorit të Kongresit të Drejtshkrimit të gjuhës shqipe, bashkëpunim i Akademisë së Shkencave dhe i Shoqatës së Artistëve dhe Intelektualëve ART Club - pjesëmarrje me tre referime (Ulqin, 3 dhjetor 2022).*

Konferenca kombëtare

⇒ *Fan Noli poliedrik, konferencë në kuadër të 140-vjetorit të lindjes së Fan Nolit, si dhe të 100-vjetorit të vendosjes së marrëdhënieve diplomatike me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në bashkëpunim me Muzeun Historik Kombëtar (Tiranë, 3 shkurt 2022);*

⇒ *Konferencë shkencore-jubilarë Në 100-vjetorin e nënprefekturës së Matit (në bashkëpunim me bashkinë e Burrelit, 7 maj 2022);*

⇒ *F. S. Noli, personalitet i gjithanshëm*, konferencë shkencore me rastin e 140-vjetorit të lindjes së F. S. Nolit (në bashkëpunim me Universitetin e Korçës, 17 qershor 2022);

⇒ Tryeza shkencore *Martin Camaj në sistemin letrar shqiptar*, në 30-vjetorin e ndarjes nga jeta (Tiranë, 28 qershor 2022);

⇒ Konferenca shkencore *Mitrush Kuteli, shkrimtari, studiuesi, përkthyesi*, në 115-vjetorin e lindjes, bashkëpunim me Universitetin e Korçës dhe me bashkinë e Pogradecit. Në këtë konferencë, e para e organizuar nga Akademia e Shkencave, u hodh dritë për personalitetin e tij si shkrimtar e përkthyes, por dhe si një nga intelektualët më të përveçëm të kohës; duke përfshirë nderimin me titullin *Nderi i Akademisë* (Tiranë, 8 korrik 2022);

⇒ *100 vjet marrëdhënie shqiptaro-amerikane 1922-2022*, bashkëpunim me Universitetin Mesdhetar të Shqipërisë, me pjesëmarrjen e studiuesve të dy institucioneve, që paraqitën punimet e tyre shkencore në lidhje me historinë dhe dinamikën e një shekulli marrëdhëniesh shqiptaro-amerikane (15 korrik 2022);

⇒ Konferenca shkencore me temë *Arsimi në gjuhën shqipe në Maqedoninë e Veriut në vitet 1941-1944* (31 tetor 2022);

⇒ Konferencë shkencore në 110-vjetorin e Pavarësisë *Rrugëtimi shqiptar për Pavarësinë*, bashkëpunim me ASHAK-un (Tiranë, 23 nëntor 2022);

⇒ *Java e Drejtshkrimit*, veprimtari 5-ditore, bashkëpunim i Akademisë së Shkencave me COD-in (*Qendra për Hapje dhe Dialog*) pranë Këshillit të Ministrave: organizim dhe referime. Ky aktivitet pati ligjërata me tematika të larmishme nga studiues të spikatur gjuhës shqipe, nga Shqipëria, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe arbëreshët. Kjo veprimtari u organizua në vazhden e veprimtarive në kuadër të 50-vjetorit të mbajtjes së Kongresit të Drejtshkrimit. U mbajtën 17 ligjërata, përkatësisht nga 12 studiues nga Shqipëria, akademikë, profesorë të Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë, studiues të Fakultetit të Histori-Filologjisë të UT dhe Universitetit të Shkodrës. Dy ligjërata u mbajtën nga studiuesit arbëreshë të Italisë, dy ligjërata të tjera nga studiues të Maqedoninë së Veriut dhe një ligjëratë nga Kosova (Tiranë, 21-25 nëntor 2022).

Tryeza shkencore

- ⇒ *Ismail Kadare, një disidencë letrare, me pjesëmarrjen e studiuesit francez Jean-Paul Champseix, autor i librit *Ismail Kadaré - une dissidence littéraire* (nominuar për çmimin Trinia e Albanologjisë: Meyer-Pedersen-Jokli), shqipëruar nga Irena Rambis e Bashkim Shehu (Tiranë, 28 janar 2022);*
- ⇒ *Elbasani dhe Korça në dokumentet osmane të Arkivit të Stambollit, përgatitur nga Ermal Nurja, tryezë e rrumbullakët rreth këtyre botimeve dhe përrurim (18 maj 2022);*
- ⇒ *Pjesëmarrje me komtime e specialistëve të arsimit, anëtarë të SSHSHA dhe komisioneve të përhershme pranë tij në Kongresin për arsimin, sfidat e arsimit cilësor dhe gjithëpërfshirës (12 shtator 2022);*
- ⇒ *Albanologu i arvanitëve: atje ku kam u shpirtin tim, kushtim për 80-vjetorin e lindjes të anëtarit të nderit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë Titos Jochalas (Tiranë, 18 tetor 2022)*
- ⇒ *Tryezë e rrumbullakët për problemet e krijimtarisë, studimit, edukimit dhe interpretimit të muzikës shqiptare (komisioni Art-trashëgimi, 28 tetor 2022);*
- ⇒ *Tryezë e rrumbullakët për problemet e krijimtarisë, studimit, edukimit dhe interpretimit të muzikës shqiptare, veprimtaria e njësisë kërkimore e muzikës dhe interpretimit *Academia Albanica* (Tiranë, 28 tetor 2022);*
- ⇒ *Ligjëratë akademike *Jeta ime me gjuhën shqipe dhe me gjuhësinë shqiptare: rëndësia e shqipes për mua dhe për studiuesit e huaj*, nga albanologu i mirënjohur amerikan prof. Brian D. Joseph, Universiteti i Ohajos; dorëzimi i certifikatës së anëtarit të nderit të Akademisë” (4 nëntor 2022);*
- ⇒ *Qasje shkencore mbi veprën e Etëhem Haxhiademit: ftesë e shtysë për një rilexim të dramatikës së tij, në 120-vjetorin e lindjes, bashkëpunim me departamentin e letërsisë të IGJL (27 prill 2022).*
- ⇒ *Organizimi i tryezës shkencore në 225-vjetorin e Naum Veqilharxhit, bashkëpunim i Akademisë së Shkencave me Universitetin e Korçës dhe shoqatën kulturore *Naum Veqilharxhi* (Korçë, 12 dhjetor 2022).*

Veprimtari përruruese dhe përrkujtimore

- ⇒ *Shqiptarët në Luftën e Dytë Botërore - të pathënat dhe enigmat, vëll. II, me autor prof. dr. Paskal Milon, botim i ASHSH (18 shkurt 2022);*

⇒ Promovimi i botimit *Muhamet Kuçuku - Çami, vepra letrare dhe studime*, përzgjedhur dhe përgatitur për botim nga Bashkim Kuçuku, botim i Akademisë së Shkencave e Shqipërisë (Tiranë, 25 qershor 2022);

⇒ Veprimtari përruese kushtuar periodikut *Thesar kombëtar*, vëll. I-XI, tribunë kombëtare e kulturore e shoqatës *Papa Klementi XI* në Suedi, shoqatë e cila, përmes kësaj tribune, jo vetëm bashkon shkrimtarë, artistë, krijues, dijetarë dhe albanologë të atjeshëm, gjurma e të cilëve është në koleksionin që u promovua, periodik tashmë i afirmuar, i njohur jo vetëm prej intelektualëve shqiptarë në Suedi: shkrimtarë, studiues, intelektualë, veprimtarë të shoqatave atdhetare; një zëdhënës i jetës së shqiptarëve mërgimtarë në këtë vend të largët, që kanë krijuar tashmë bashkësinë e tyre të qëndrueshme dhe jetojnë me gjuhën shqipe dhe identitetin shqiptar (Tiranë, 18 korrik 2022);

⇒ *Çesk Zadeja në muzikën shqiptare (jeta dhe vepra)* - në 95 vjetorin e lindjes dhe 25-vjetorin e ndarjes nga jeta: promovim i botimit të akad. Vasil S. Tole, bot. i ASHAK-ut dhe nderimi me mirënjohjen *Nderi i Akademisë* (pas vdekjes) - (8 qershor 2022);

⇒ Përgatitje për botimin e manualit jubilar të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë *50 vjet Akademi e Shkencave e Shqipërisë (1972-2022)*, në kuadër të 50-vjetorit të krijimit të saj (qershor-tetor 2022);

⇒ Promovimi i botimeve të veprës në dy vëllime të botuar nga Akademia e Shkencave *Vjersha (këngë) popullore grarishte mbledhur në Pogradec dhe në fshatin Dardhë, Korçë* (Mbledhur prej gojës së popullit) - *Vjersha (këngë) popullore grarishte krahinash të ndryshme* (mbledhur prej gojës së popullit), nga Lasgush Poradeci; vlerësimi me mirënjohjen *Nderi i Akademisë* i autorit dhe i personaliteteve të gjuhës dhe të letrave shqipe: Kolë Ashta, Remzi Përnaska, Anastas Dodi, Musine Kokalari, Lasgush Poradeci, Mons. Simon Filipaj (Tiranë, 11 nëntor 2022);

Veprimtari vlerësuese dhe mirënjohjeje

⇒ Titull akademik *anëtar nderi* i ASHSH akorduar prof. Antonio Loprieno, President i ALLEA-s (*All European Academies*).

⇒ *Nderi i Akademisë* 87 firmëtarët e *Kongresit të Drejtshkimit* dhe 19 personaliteteve të shkencës dhe kulturës;

⇒ *Nderi i Akademisë* për kompozitorin Çesk Zadeja - në 95 vjetorin e lindjes dhe 25-vjetorin e ndarjes nga jeta;

⇒ *Nderi i Akademisë* për shkrimtarin, studiuesin dhe përkthyesin Mitrush Kuteli, në 115-vjetorin e lindjes;

⇒ *Nderi i Akademisë* për personalitetet si vijon: Dhimitër Anagnosti, Sali Shijaku (pas vdekjes), Shpresa Gjongecaj, Neritan Ceka, Seit Mansaku, Nelson Çabej (Tiranë, 10 tetor 2022);

⇒ *Nderi i Akademisë* në kuadër të *Kongresit të Drejtshkrimit* personaliteteve të gjuhës dhe të letrave shqipe: Emil Lafe, Enver Hysa, Zija Çela, Gaqo Bushaka, Koço Kosta (Tiranë, 25 nëntor 2022);

⇒ *Nderi i Akademisë* në kuadër të *Kongresit të Drejtshkrimit* personaliteteve të gjuhës e të letrave: Kolë Ashta, Remzi Përnaska, Anastas Dodi, Musine Kokalari, Lasgush Poradeci, dom Simon Filipaj (Tiranë, 11 nëntor 2022);

Studia Albanica:

⇒ Suksesi më i rëndësishëm i periodikut të SSHSHA është kalimi në *Listën A (lista primare)* e botimeve shkencore akademike të rekomanduara si literaturë shkencore-universitare, vendim i agjencisë ndërkombëtare për vlerësimin e periodikëve shkencorë me qendër në Itali ANVUR;

⇒ Dhënia e lejes për ripublikim nga agjencia *Albanica* (pas paraqitjes në linjë në faqen e Akademisë) për katër numra (kushtuar Gjergj Kastriotit Skënderbeut) mundësoi pajisjen me DOI (*digital object identifier*), një hap drejt indeksimit në *Scopus*.

Nr. 1/2022

⇒ Histori-arkeologji	8 artikuj (nga konferenca për Skënderbeun);
⇒ Gjuhësi-letërsi	2 artikuj (nga gjuhësia);
⇒ Materiale-dokumente	1 artikull;
⇒ Recensione	3 (N. Ceka, F. Hoxha, M. Kasmi);
⇒ Kronika	5 veprimtari nga gjashtëmujori i parë 2022;
⇒ In memoriam	1 (Peter Bartl).

Nr. 2/2022

- ⇒ Antropologji: 7 artikuj (kongresi i baladave);**
- ⇒ Histori 2 artikuj;**
- ⇒ Kronikë 5 kronika nga gjashtë mujori i dytë 2022.**

I/2. Veprimtaria vjetore e SSHNT

I. Drejtimit kryesore

Seksioni i Shkencave Natyrore dhe Teknike (SSHNT), si një nga dy Seksionet e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë (ASHSH), ku zhvillohen veprimtaritë për kërkim e zhvillim në fushat e shkencave natyrore e teknike e të shkencave të jetës, inxhinierike, teknologjike, bujqësore mjedisore, mjekësore, në përmbushje të misionit të saj, në vazhdimësi gjatë vitit 2022 ka synuar realizimin e veprimtarive në drejtimit kryesore të parashikuara.

Kalendari i veprimtarive ishte shumë i ngjeshur, megjithatë SSHNT arriti të realizojë detyrat kryesore në përputhje me kushtet konkrete:

⇒ Kontribut në plotësimin e bazës ligjore për Akademinë e Shkencave me aktet nënligjore;

⇒ Kryerja e procedurave përgatitore për pranime në fusha të reja;

⇒ Organizimi i punës së SSHNT dhe të komisioneve të përhershme sipas fushave; shfrytëzimi i plotë i mundësive teknike të komunikimit për diskutimet dhe vendimmarrjet.

⇒ Krijimi i njësive të reja kërkimore të përkohshme si:

6. Instituti Kombëtar i Matematikës (IKM);
7. Zgjatja e afatit për njësinë ekzistuese NanoAlb dhe ngritja në shkallën e një qendre kërkimore afatgjatë;
8. Qendra kërkimore e bioteknologji-gjenetikës ka nënshkruar një marrëveshje me Drejtorinë e Policisë së Shtetit;
9. Njësia e Inteligjencës Artificiale ka bërë një studim për gjendjen e kësaj disipline në departamentet universitare, dhe ka planifikuar zhvillimin e veprimtarive në 2023;
10. Njësia e energjetikës bashkëpunon ngushtë me grupin e energjetikës pranë ASHAK për studimin e burimeve alternative dhe të ripërtëritëshme të energjisë.

⇒ Vazhdimi i projektit studimor për përhapjen e SARS-COV-2 në Tiranë, si dhe janë në proces pesë projekte të njësisë *NanoAlb* lidhur me përdorimin e nanoteknologjive.

⇒ Vazhdimi i diskutimit për pandemisë e shkaktuar nga Covid-19 në linjë, me pjesëmarrjen e anëtarëve të komisioneve.

⇒ Organizimi i forumeve shkencore për pandeminë e shkaktuar nga Covid-19, bioteknologjitë, nanoteknologjitë, energjitikën, mjedisin etj.

⇒ Shqyrtimi i gjendjes së kurrikulave në universitete për degë të caktuara si shkencat informatike dhe në arsimin parauniversitar për shkencat e matematikës dhe fizikës; duke përfshirë ngritjen e dy komisioneve të posaçme për studimin e nivelit të mësimdhënies së lëndëve të matematikë-fizikës, të programeve dhe teksteve, në arsimin parauniversitar). Rezultatet pritet të publikohen gjatë 2023;

⇒ Mbajtja e kontakteve me kërkuesit në institucionet e arsimit të lartë, për këshillimin dhe ekspertizën e nevojshme për institucionet politikëbërëse dhe vendim-marrëse në fushat e kërkimit dhe zhvillimit;

⇒ Mbajtja e kontakteve me organizmat ndërkombëtarë shkencorë SAPEA dhe IAP, kontributi në mbledhjen e të dhënave dhe hartimin e dokumentacioneve shkencore-politike, si dhe nominime për ekspertë të disa prej kërkuesve vendës;

⇒ Mbajtja e kontakteve me ASHAK-un për realizimin e protokollit të bashkëpunimit, dhe për pjesëmarrjen në veprimtaritë e ndryshme;

⇒ Ndjekja e thirrjeve për projekte nga Komisioni European dhe pjesëmarrjen në 5 aksione COST në fusha të ndryshme të shkencës gjithashtu ka edhe një propozim të ri COST;

⇒ Ka vazhduar puna e redaksisë të revistës JNTS, janë përfunduar tre numra për vitin 2022: numri 1 përmban 15 artikuj shkencorë si dhe informacione të tjera; numri 2 i është dedikuar konferencës ndërkombëtare të bioteknologjisë dhe gjenetikës *Biotechnology & Genetics Developments and Future Challenges*, BGIC dhe numri 3 përmban artikuj të paraqitura në konferencën shkencore të organizuar nga Instituti i Gjeoshkencave në kuadër të 70-vjetorit të themelimit të Universitetit Politeknik të Tiranës. Po mblidhen artikujt për numrin e parë të vitit 2023;

⇒ Me përparësi në veprimtaritë e SSHNT ka qenë edhe inkurajimi i bashkëpunimit ndërmjet shkencëtarëve të diasporës, shkencëtarëve të rinj nga institucionet brenda dhe jashtë vendit, me anë të përfshirjes nëpërmjet veprimtarive të ndryshme, si: seminare, forume shkencore, projekte etj.

Gjithashtu, akademikët e SSHNT-së kanë drejtuar dhe marrë pjesë në realizimin e disa projekteve ndërkombëtare.

II/1. Pasqyrë përmbledhëse e veprimtarisë së akademikëve anëtarë të SSHNT sipas nismave dhe projekteve:

1. Në nisma të Akademisë	3
2. Në konferenca madhore	3
3. Në projekte të Akademisë	7
4. Në projekte kombëtare të finanacuara nga AKKSHI	5
5. Në projekte në bashkëpunim me ASHAK	2
6. Veprimtari shkencore të SSHNT-së (+ njësitë dhe komisionet)	31
7. Pjesëmarrje individuale në projekte	36
8. Projekt propozime individuale	6
9. Pjesëmarrje individuale në konferenca jashtë vendit	72
10. Pjesëmarrje individuale në konferenca brenda vendit	28
11. Monografi dhe tekste individuale	6
12. Artikuj dhe tekste individuale jashtë vendit	54
13. Artikuj dhe tekste individuale brenda vendit	2
14. Artikuj dhe intervista shkencore në media	10
15. Pjesëmarrje individuale të ndryshme	11
16. Akademikë në mësimdhënie	12
17. Udhëheqje doktrate dhe masteri	28

II/2. Disa të dhëna të tjera të rëndësishme

Njësi të reja ose të avancuara kërkimore-shkencore	5
Kongrese dhe konferenca ndërkombëtare të nivelit të ASHSH	3
Projekte ndërkombëtare dhe kombëtare	20
Veprimtari të nivelit të SSHNT	17
Veprimtari të <i>NanoAlb</i>	7
Veprimtari të qendrës <i>Biotech</i>	5
Veprimtaritë kryesore të komisioneve: komisioni i biologjisë	8

II. Pasqyrë analitike e veprimtarisë së SSHNT:

II/1. Nisma

⇒ **Themelimi i Institutit të Matematikës:**

Krijimi i Institutit Kombëtar të Matematikës (IKM) ishte një nismë që u ndërmor nga një grup matematikanësh brenda dhe jashtë Shqipërisë. Instituti Kombëtar i Matematikës është njësi bashkëpunimi dhe koordinimi shkencor në fushat e matematikës me institutet, universitetet, akademitë dhe me institucione të tjera të mirëfillta shkencore, kombëtare e ndërkombëtare. Anëtarët e IKM-s vijnë nga komuniteti shqiptar i matematikanëve të angazhuar në sferën akademike, në ekonomi, në mësimdhënie, përfshirë edhe studentët doktorantë. IKM është strukturë që funksionon brenda Akademisë së Shkencave.

⇒ **Ngritja e një njësie në fushën e gjeoshkencave dhe gjeoinxhinierisë:**

Një grup kërkuesish nga institucione të ndryshme të vendit së bashku me akad. asoc. Rrapo Ormeni hodhën një projekt ide për ngritjen e një njësie

afatshkurtër kërkimore në fushat e shkencave të tokës. Ideja u paraqit në komisionin e Inxhinierisë dhe pas shqyrtimit të projektidesë dhe diskutimeve u ngrit një grup që do të rishikonte emërtimin e kësaj njësie. Projekt-ideja e rishikuar së bashku me analizat e bëra do t'i përcillen Kryesisë për të marrë vendimin.

⇒ Hapja e vendit për titullin akademik në shkencat zooteknike:

U diskutua nevoja për të pasur në radhët e akademikëve një përfaqësues të shkencave zooteknike kështuqë u propozua që në përputhje me kushtet dhe aktet ligjore vendi të hapej për titullin akademik në shkencat zooteknike. Kandidatura e paraqitur u shqyrtua në mbledhjen e Seksionit dhe me votim të fshehtë u vendos që t'i paraqitet Asamblesë për votim.

II/2. Kongrese, kuvende dhe konferenca madhore

⇒ Konferenca e parë e Institutit Kombëtar të Fizikës u realizua në datat 10 - 11 shkurt 2022. Me anë të kësaj konference, IKF synon promovimin e dijeve më bashkëkohore dhe ekselencës në fushën e fizikës, në të gjithë hapësirën ku punojnë fizikanët shqiptarë, brenda dhe jashtë trojeve tona.

⇒ Kongresi Botëror i Nanoteknologjisë (Trends in Nanotechnology International Conference, TNT2022 *NanoBalkan*) u realizua më 4-8 tetor 2022. Ky kongres mblodhi në Tiranë studiues nga e gjithë bota dhe veçanërisht nga Ballkani duke hedhur hapin e parë për realizimin e një konference *NanoBalkan* në vitin 2023. Krahas seancave plenare, programi i konferencës përmbante dhe veprimtari të tjera si:

- a. *Nanobiosensors school / Shkolla e Nanobiosensorëve*
- b. *3rd Workshop - Cooperation event between Albania, Japan and Spain* (Workshop-i i 3-të i bashkëpunimit ndërmjet Shqipërisë, Spanjës dhe Japonisë)
- c. SUSNANO kick-off meeting (Takimi prezantues i projektit Twinning SUSNANO)
- d. Training Workshop: Practical advice on how to write Horizon Europe grant proposals (Wokshop trajnues: Këshilla praktike se si të shkruhen propozimet për grante të Horizon Europe).

⇒ Konferenca ndërkombëtare *Pakti i Gjellbër i BE-së dhe ndikimi i tij në administrimin e burimeve tokësore në Shqipëri*, bashkëpunim midis Akademisë së Shkencave, Universitetit Bujqësor të Tiranës, Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Institutit CIHEAM të Barit në Itali dhe institucionit Agroscope në Zvicër, u realizua më 5 dhjetor 2022 (Dita ndërkombëtare të tokës).

II/3. Projektet më të rëndësishme të Akademisë së Shkencave

Në shkencat natyrore dhe teknike Akademia e Shkencave e Shqipërisë ka qenë dhe është pjesë e disa projekteve. Koordinatorë të këtyre projekteve janë akademikë ose anëtarë të strukturave të ngritura pranë Akademisë së Shkencave (njësitë kërkimore afatshkurtra). Lista e projekteve më të rëndësishme si më poshtë:

⇒ Katër projekte të fituara në kuadër të PKKZH-së dhe 1 projekt në kuadër të bashkëpunimeve bilaterale të financuara nga AKKSHI.

- a) Vlerësimi zonal dhe kohor i parametrave fizike, fiziko-kimike dhe sizmike të rrjedhjes së nxehtësisë dhe modeli i energjisë gjeotermale në zonën e Elbasanit; koordinatorë akad. Rrapo Ormeni dhe dr. Albana Hasimi;
- b) Përdorimi i metodave bioteknologjike in vitro dhe të biologjisë molekulare në përpjekje për të fituar material mbjellës të kategorisë “bazë” të kultivarëve autoktonë të kumbullës. Koordinatorë akad. Efigjeni Kongjika e prof. asoc. Valbona Sota;
- c) Karakterizimi i variabilitetit gjenetik në popullatat njerëzore shqiptare sipas markerëve gjenetikë të ADN-së. Koordinator akad. Ilia Mikerezi;
- d) Zhvillimi i metodave alternative, inovative dhe ekonomike për kontrollin e cilësisë së produkteve ushqimore. Koordinatorë prof. dr. Majlinda Vasjari;
- e) Modifikimi i sensorëve të printuar me nanomateriale për percaktimin e antibiotikëve në ujëra (Bilateral TUBITAK-AKKSHI). Koordinatorë prof. dr. Majlinda Vasjari;

⇒ 7 projekte të financuara nga buxheti i Akademisë:

⇒ 5 projekte të reja nga Qendra kërkimore e Nanoteknologjive

⇒ 2 projekte në vazhdim nga Qendra e Bioteknologjisë dhe Gjenetikës
⇒ 2 projekte të financuara në kuadër të protokollit të bashkëpunimit me Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës:

- Studimi i mjedisit me imazhe satelitore
- *Platformë e përbashkët e sektorit të energjisë për Kosovën dhe Shqipërinë*

II/3. Veprimtaria në kuadër të SSHNT

Konferenca, simpoziume, seminare, forume shkencore

⇒ *Gratë dhe vajzat, ambasadoret më të mira për shkencën* u zhvillua në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të grave dhe vajzave në shkencë teknologji inxhinieri dhe matematikë (STEM). Është viti i tretë që Akademia organizon veprimtari në këtë Ditë duke mbështetur nismën e Akademisë së të Rinjve. Me mbështetjen edhe të Ambasadës Greke dhe personalisht të Sh. S. Znj. Sophia Philippidou veprimtaria u fokusua në figura të grave që i përkasin shkencave natyrore dhe teknike. Veprimtaria u zhvillua në sallën Silvano Pedrollo tek Korpusi qendror i UPT-së më datë 11 shkurt 2022.

⇒ Akademia e Shkencave e Shqipërisë nëpërmjet Akademisë së të Rinjve organizoi Festivalin i shkencës *Shkenca nga të rinjtë tek fëmijët*. Kjo veprimtari kish si synim të sjellë shkencën, sa më thjeshtë tek fëmijët, për të nxitur kështu tek ata dëshirën dhe pasionin që të bëhen pjesë e saj. Veprimtaria ishte konceptuar si një festival një javor (9-14 maj 2022) dhe u zhvillua në bashkëpunim me Universitetin Politeknik të Tiranës, Universitetin e Tiranës, Universitetin Aleksandër Mojsiu të Durrësit dhe Universitetin Epoka. Realizimi i kësaj veprimtarie u bë i mundur edhe nga bashkëpunimi i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

⇒ Veprimtaria shkencore *Ngritja e kapaciteteve dhe vëzhgimi i tokës në rajonin e Ballkanit: rasti i nismës GEO-CRADLE* ishte një bashkëpunim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Observatorit Kombëtar të Athinës dhe u mbështet fuqimisht nga Ambasada e Greqisë në Shqipëri. Kjo veprimtari e zhvilluar në Ditën e Europës 9 maj 2022 mori dhe karakter simbolik.

⇒ Më datat 14-17 qershor 2022 erdhi në Tiranë dhe u prit në Akademi, delegacioni i Akademisë së Shkencave Bujqësore dhe Pyjore të Rumanisë, i cili përbëhej nga Presidenti i saj prof. dr. Valeriu Tabara, zv. Presidenti prof. dr. Ioan Jelev si dhe nga Sekretari i Përgjithshëm prof. as. dr. Marian Bogoescu. Kjo vizitë u realizua në kuadër të bashkëpunimit të vendosur midis dy Akademive me nënshkrimin e Marrëveshjes (). Gjatë ditëve të qëndrimit delegacioni vizitoi edhe Universitetin Bujqësor të Tiranës ku u prit nga rektori i tij akad. asoc. Fatbardh Sallaku. Gjithashtu gjatë ditëve të kësaj vizite më datë 15 qershor 2022 në sallën “Aleks Buda”, u organizua nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë një sesion shkencor me temë *Bujqësia dhe e ardhmja e saj në rajon*.

⇒ Shkolla ndërkombëtare verore e matematikës (18-29 korrik 2022) u organizua nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Fakulteti i Shkencave të Natyrës i Universitetit të Tiranës dhe Qendra Ndërkombëtare e Matematikës së Pastër dhe të Aplikuar (Centre International de Mathématiques Pures et Appliquées CIMPA (www.cimpa.info)). Shkolla është një iniciativë e prof. Fioralba Cakoni (Universiteti Rutgers), dr. Aida Maraj (Universiteti i Miçiganit) dhe dr. Mirjeta Pasha (Universiteti Tufts). Veprimtaritë e shkollës u kryen në mjediset e fakultetit të Shkencave të Natyrës.

⇒ Konferenca ndërkombëtare *Sistemi COBISS dhe digjitalizimi i informacionit akademik* (6 shtator 2022) u organizua nga Akademia e Shkencave në bashkëpunim me Institutin e Shkencave të Informacionit - IZUM, Slloveni. U mbajt sot në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë.

⇒ Takimi i 17-të vjetor ndërkombëtar i Institutit *Alb-shkenca* (30 shtator 2022). bashkoi studiues shqiptarë nga e gjithë bota për të referuar rreth problematikës së temës-kuadër *Bashkëveprimi shkencor në trojet shqipfolëse*. Organizues të takimit ishin Akademia e Shkencave, Universiteti i Tiranës dhe vetë Instituti *Alb-Shkenca*.

⇒ Promovim i librit *Kërkimi shkencor dhe këshillimi bujqësor shqiptar ndër vite* (autor Tatjana Dishnica) u organizua në bashkëpunim me Universitetin Bujqësor të Tiranës (26 tetor 2022). Botimi është memoria historike e një periudhe të gjatë ndryshimesh dhe tranzicioni, një referencë me vlerë, për të sotmen dhe për të ardhmen.

⇒ Veprimtaria *Vepra tani për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm SDGs në Edukimin STEM* (7 nëntor 2022) u organizua nga EduACT Albania me mbështetjen e Akademisë së Shkencave në kuadër të projekteve të financuara nga BE, që EduAct Albania ka ndërrmarrë për rritjen e profesionalizmit të mësuesve dhe maivizimit të shkencës.

⇒ Konferenca Kombëtare e Shoqatës Shqiptare të Gjenetikës Molekulare Humane *Gjenetika humane - kërkimi dhe inovacioni* u zhvillua më 8 dhjetor. Kjo konferencë u organizua nga simotra e Shoqatës Europiane të Gjenetikës Humane, në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, Universitetin e Mjekësisë dhe Universitetin e Tiranës.

II/4. Veprimtaria në kuadër të njësive kërkimore

I. Qendra Kërkimore e Nanoteknologjisë.

Njësia e nanoshkencave dhe nanoteknologjisë në përfundim të afatit të punës së saj dyvjeçare emërtohet Qendër kërkimore e nanoteknologjive dhe funksionon edhe për një periudhë tjetër dyvjeçare.

Në kuadër të NanoAlb IGNITE 2022-23, duke pasur parasysh punën e suksesshme të zhvilluar në projektet e financuara gjatë 2020-2021, Akademia e Shkencave vendosi financimin e 5 projekteve të reja për Qendrën kërkimore të nanoteknologjive.

⇒ Drejt krijimit të Njësisë së Biosensorëve pranë Grupit të Bioteknologjive Molekulare, NanoAlb - përdorimi i biosensorëve me qeliza të plota dhe elektro-kimikë për të matur toksicitetin e ujit dhe tokës në bregdetin shqiptar.

⇒ Nanosensorë për certifikimin e verërave vendase dhe të importuara bazuar në antioksidantët e tyre total.

⇒ Zhvillimi i një sensori të ri elektrokimik për përcaktimin e hidroksi metil furfuralit për kontrollin e cilësisë së mjaltit.

⇒ *Mendo për gjëra të mëdha - eksploro gjëra të vogla*: studimi i ndërveprimeve *Nano-Bio* duke përdorur qasje toksikologjike e llogaritëse.

⇒ Përgatitja dhe karakterizimi i elektrofibrave nanofibra të pastër PVA dhe matricës PVA/MMT për të kapsuluar një vaj esencial nga bimë mjekësore shqiptare për aplikime bio-mjekësore.

Përveç organizimit të TNT2022 NanoBalkan, NanoALB organizoi edhe një sërë veprimtarish të tjera.

⇒ Seminari *NANOALB dhe UP-ja takon Industrinë - Mundësitë e bashkëpunimit ndërmjet nanoteknologjisë dhe industrisë*, Prishtinë 24 qershor 2022;

⇒ Seminari vjetor i NanoALB u mbajt në datat 14-15 dhjetor 2022, në mjediset e Akademisë së Shkencave

Gjatë vitit 2022 NanoAlb zhvilloi 7 webinare (takime shkencore online) me profesorë dhe kërkues shkencorë nga universitete dhe qendra kërkimore të ndryshme, nga hapësira mbarë shqiptare dhe përtej saj. Gjithashtu u zgjerua më tej me një grup të ri kërkimor-shkencor nga Universiteti i Tetovës, Maqedonia e Veriut dhe me dy grupe kërkimore-shkencorë të asociuar nga Universiteti Aldo Moro i Barit, Itali dhe Universiteti Ben-Gurion i Negev, Israel.

III. Njësia kërkimore e inteligjencës artificiale

Është krijuar një bazë të dhënash me personat që aktivizohen në kuadër të njësisë IA, brenda dhe jashtë vendit. Është punuar për hartimin e një Programi Master në Data Science. Projekti finalizohet brenda shkurtit 2023. Është punuar gjithashtu edhe për hartimin e një Programi Master në Inteligjencë Artificiale. Projekti finalizohet brenda majit 2023.

IV. Instituti Kombëtar i Fizikës

Gjatë vitit 2022 IKF organizoi Konferencën e tij të parë si dhe një sërë veprimtarish të tjera ndër të cilat 4 webinare dhe edicioni i 4rt i shkollës verore *Shkenca e të dhënave, fizika e grimcave dhe astrogrimcave në Tiranë 2022*, në bashkëpunim me Universitetin e Tiranës, Ambasadën Italiane, CERN, Universitetin Politeknik të Barit dhe Institutin Kombëtar të Fizikës Bërthamore (INFN) Bari. Gjithashtu janë zhvilluar edhe dy mbledhje të bordit të Institutit. Në fund të vitit 2022 Instituti Kombëtar i Fizikës numëron në rradhët e tij 35 anëtarë.

V. Njësia kërkimore e energjive të rinovueshme, sistemit elektroenergjetik dhe eficiencës së energjisë (projekte)

⇒ *Platformë e përbashkët e sektorit të energjisë për Kosovën dhe Shqipërinë*

Konferenca dhe seminare

⇒ Simpoziumi shkencor *Energjia e pastër dhe zhvillimi i qëndrueshëm*, 14 tetor 2022, Prishtinë. Anëtarët e njësisë morën pjesë aktive në punimet e këtij

simpoziumi me paraqitjen e kumtesave shkencore dhe duke drejtuar një rën nga seancat e tij.

II/5. Veprimtaria në kuadër të komisioneve të përhershme

Komisionet e përhershme pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë kanë zhvilluar punën e tyre rregullisht me mbledhje fizike dhe online. Ka patur anëtarësime të reja në disa nga komisionet.

Komisioni i biologjisë bujqësisë dhe veterinarisë u shtua me një anëtare të re prof. Magdalena Cara (VKA 32 dt 27.05.2022) dhe pati edhe një dorëheqje për arsye të moshës nga prof. Sulejman Sulçe.

Komisioni i mjekësisë u shtua me një anëtare të re dr. Erda Qorri dhe me një bashkëpunëtor të jashtëm dr. Bashkim Kadriu (VKA 51 dt 30.09.2022)

Gjithashtu anëtarët e komisioneve kanë qenë ideatorë dhe organizatorë të veprimtarive të ndryshme si konferenca njëditore, simpoziume, seminare e forume në të cilat kanë marrë pjesë edhe kërkues shkencorë vendas dhe të huaj nga institucione shkencore Brenda dhe jashtë vendit.

⇒ Forumi shkencor *Speciet invazive në ekosistemet ujore dhe efektet e ndryshimeve të klimës* (Invasive Alien Species in Aquatic Ecosystems and Climate Change Effects), 12 korrik 2022.

⇒ Konferenca shkencore *Roli i mjekësisë veterinarë në përfaqsimin "Një shëndet"*, 27 maj 2022.

⇒ Forumi shkencor *Bujqësia organike - sfida dhe mbështetje e rëndësishme për agroturizmin dhe zhvillimin rural në Shqipëri*, 16 qershor 2022.

⇒ Ligjëratë - *Zbulimi i barnave neuropsikiatrike me veprim të shpejtë tek sëmundja e depresionit rezistente në trajtim: mësimet e nxjerra nga modulimi i neurotransmitereve esenciale në tru*, nga dr. B. Kadriu, 20 korrik 2022.

⇒ *Dita e Informimit me temë: Bioteknologjia në shërbim të përdorimit të burimeve gjenetike bimore autoktone*, 9 shtator 2022.

⇒ Konferenca ndërkombëtare me temë *Mekanizmat e pershtatjes ekofiziologjike te bimeve*, 21-22 Shtator 2022.

⇒ Seminari shkencor *Zhdukja e gjashtë masive e biodiversitetit: Çfarë po ndodh me biodiversitetin në Shqipëri?*, 14 tetor 2022.

⇒ Forumi IV shkencor *Pandemia COVID-19 dhe pasojat e saj në shëndet dhe shoqëri*, 1 nëntor 2022.

⇒ Webinari me temë *Vaksinat, vaksinimi dhe roli i tyre në kontrollin e sëmundjeve infektive: imuniteti kolektiv (imuniteti i tufës) dhe pragu epidemik; pandemitë/panzootitë, imuniteti kolektiv dhe roli i tij në shuarjen e tyre. Programet e vaksinimit dhe arsyet pse këto programe mund të mos jenë të suksesshëm*, 24 nëntor 2022.

⇒ *Eurokodet dhe siguria strukturore e veprave ndërtimore – Eurocodes and the Structural Safety of Construction Works*, 19 dhjetor 2022.

⇒ AJNTS 2022 / Albanian Journal of Natural and Technical Sciences 2022

Ky numër reviste është numër i zakonshëm dhe përmban artikuj shkencor nga fusha e mjekësisë, gjeologjisë, por dhe të konferencave si TNT dhe BGIC. Ky numër ka mbaruar procesin e shtypjes.

Gjithashtu përmban një raport përmbledhës mbi aktivitetet e organizuara nga UPT mbi 70 vjetorin e themelimit të tij, nekrologji për prof. Artan Boriçin dhe prof. Petraq Petron.

Gjithsej numri ka 15 artikuj shkencorë dhe dy informacione shkencore dhe dy nekrologji të shkruar në bashkëautorsi. Numri i autorëve është 52, nga ku 37 janë kërkuese shkencore dhe 15 kërkues shkencorë, pjesë e stafit pedagogjik të Universitetit të Tiranës, Universitetit Politeknik të Tiranës, Universitetit Bujqësor të Tiranës, Universiteti i Neë York, Tirana, Qendra Kërkimore Egjipt, Kolegji Qirjazi, Universiteti Aldent, Universiteti i Sporteve, Universiteti Zonja e Këshillit të Mirë, Universiteti i Milanit, Universiteti i Mjekësisë, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë. 48 kërkues shkencorë janë vendas dhe 4 kërkues shkencorë janë të huaj. 5 nga 52 autorë janë akademikë dhe “Akademik nderi”.

⇒ Albanian Journal of Natural and Technical Sciences 2022 (2)

⇒ Ky numër i dedikohet Konferencës “BGIC” dhe përmban 10 artikuj shkencorë dhe 1 informacion shkencor, shkruar nga kërkues shkencorë nga Shqipëria e Kosova, por edhe të huaj. Numri total i autorëve është 31 nga ku 24 janë kërkuese shkencore dhe 7 janë kërkues shkencorë, nga Universiteti i Tiranës, UBT, Kolegji Ndërkombëtar i Biznesit, Mitrovicë, Kosovë, Muzeu i Historisë së Shqipërisë të Natyrës, Vienë, Austri, Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, Tiranë, Universiteti i Elbasanit. 5 autorë janë të huaj dhe 26 janë vendas.

Ky numër aktualisht është në proces shtypjeje.

⇒ Albanian Journal of Natural and Technical Sciences 2022 (3)

Ky numër reviste përmban artikujt e paraqitura në konferencën e organizuar nga IGJEO në kuadër të 70 vjetorit të themelimit të UPT. Artikujt janë grumbulluar nga prof. Ylber Muçeku, drejtor i IGJEO-s dhe anëtar i redaksisë. Ky numër përmban 3 informacione shkencore dhe 8 artikuj shkencor shkruar nga 28 autorë nga ku 7 janë kërkuese shkencore dhe 21 kërkues shkencor nga vendi, pjesë e stafit pedagogjik të UPT dhe kërkues shkencor të IGJEO, Holanda dhe Norvegjia. Tre autore nga 28 janë të huaj. Aktualisht ky numër është në proces shtypjeje.

Artikujt në të tre numrat janë recenzuar nga specialistë vendas e të huaj. Pasqyra e lëndës ndërtohet sipas Klasifikimit Dhjetor Universal (KDU)

Në 2022, gjithashtu nisi puna për numrat e revistës të parashikuara për vitin 2023. Numri i parë i revistës përmban artikuj të konferencës *The 1st International Conference on Information Technologies and Educational Engineering (ICITEE21)*, organizuar nga Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit, UPT në kuadër të 70vjetorit të UPT. Në këtë numër bie në sy bashkëpunimi i inxhinierëve të informatikës të UPT me ata italianë. Numri i dytë i revistës përmban artikuj nga konferenca e fizikës organizuar nga UT. Numri i tretë është numër i zakonshëm e përmban artikuj në fushën e mjeksisë, shkencave të tokës e bioteknologjisë.

Botime të vitit 2022
sipas vendimit të këshillit të botimeve

Nr.	Autori	Titulli
1	Çesk Zadeja	<i>Partitura e simfonisë së parë shqiptare të kompozitorit Çesk Zadeja</i>
2	Shaban Sinani	<i>Personalitete në albanologji</i>
3	Gjovalin Shkurtaç	<i>Kënga si mjet për ruajtjen e shqipes në shekuj</i>
4	Vasil S. Tole	<i>ÇeskZadeja në muzikën shqiptare: jeta dhe vepra</i>
5	Bardhyl Demiraj Anila Omari Enkelejda Kopia	<i>Doktrina e krishterë (pjesë e projektit të botimit anastatik të opusit trivëllimësh të PjetërBudit)</i>
6	Xhevahir Spahiu	<i>Zgjimi i thellësive (vëllim i ndaluar më 1979)</i>
7	Lasgush Poradeci	<i>Vjersha popullore, mbledhur nga Lasgush Poradeci, Vëllimi I</i>
8	Lasgush Poradeci	<i>Vjersha popullore, mbledhur nga Lasgush Poradeci, Vëllimi II</i>
9	Dhori K. Qirjazi (përg.)	<i>Panajot Kupitori - Fjalori i përkundërt arvanitisht/shqip-greqisht</i>
10	Kujtim Onuzi Friedrich Koller	<i>Southeastern Albanian ophiolites</i>
11	Eris Rusi	<i>Fantastikja në letërsinë shqipe të shekullit XX</i>
12	Idriz Metani	<i>Fjalori i emërtimeve të njerëzve sipas tipareve fizike e morale në gjuhën shqipe</i>
13	Përgatitës: Enver Hysa	<i>Studime gjuhësore të akad. Mahir Domit, vëllimi V</i>
14	Rigers Bakiu Edmond Hala Elvis Kamberi	<i>Llojet aloktone në ekosistemet ujore të Shqipërisë</i>

15	Ali Xhiku	<i>Letërsia shqipe 1945-1961</i>
16	Lida Miraj	<i>Albania from the travel eyes: from the Age of Humanism to the end of the World War II.</i>
17	Marenglen Verli	<i>Dokumente austro-hungareze, viti 1913</i>
18	Josif Papagjoni	<i>Dhimitër Anagnosti: artisti, bota, imazhi</i>
19	Mehmet Gëzhilli	<i>Enciklopedia e Naimit: Gjuha e Naimit</i> <i>Vëllimi I</i>
20	Abdulla Hamiti Abdulla Rexhepi	<i>Poezia shqipe me alfabet oriental</i>
21	Irakli Koçollari	<i>Korrespondencë dhe dorëshkrime të Ali pashë Tepelenës, vëllimi IV</i>
22	Grup autorësh	<i>Kuvendi Ndërkombëtar i Studimeve Albanologjike, Vëllimi I</i>
23	Grup autorësh	<i>Kuvendi Ndërkombëtar i Studimeve Albanologjike, Vëllimi II</i>
24	<i>Studia Albanica, nr. 1, 2022</i>	
25	<i>Studia Albanica, nr. 2, 2022</i>	
26	<i>AJNTS (numër special, akte të kongresit të TNT)</i>	
27	<i>AJNTS, nr. 1, 2022</i>	
28	<i>AJNTS nr. 2, 2022</i>	

Marrëdhëniet me jashtë

Përgatitje dhe nënshkrim marrëveshesh ndërakademike dhe ndëruniversitare:

⇒ U arrit pëlqimi i dyanshëm me Akademinë e Shkencave të Austrisë për finalizim të marrëveshjes së bashkëpunimit;

⇒ U hartua dhe u propozua projekt marrëveshja e bashkëpunimit shkencor mes ASHSH dhe Akademisë së Shkencave të Ukrainës;

⇒ U organizua takim me përfaqësues nga Ambasada e Hungarisë, me qëllim diskutimin mbi zhvillimin e një konference të përbashkët në kuadër të 30-vjetorit të marrëdhënieve diplomatike Shqipëri-Hungari dhe ndërlidhjen e dy akademive në kuadër të nënshkrimit të një marrëveshjeje të bashkëpunimit shkencor. Në takimin e sekretarit shkencor me zëvendëskryetarin e ASHH në Bruksel gjatë punimeve të Asamblesë së ALLEA-s u ra dakord për nënshkrim marrëveshjeje. Janë shkëmbyer tekstet dhe janë bërë redaktimet nga të dyja palët;

⇒ U dërgua projekt marrëveshja me Akademinë e Shkencave të Çekisë, e cila është në fazë shqyrtimi nga pala çeke;

⇒ Gjatë vizitës së sekretarit shkencor të ASHSH në Sofje ASHB iu dorëzua projekt marrëveshja e re. Gjatë vizitës në Tiranë të kryetarit Revalski u ra dakord që marrëveshja të nënshkruhet në Sofje;

⇒ U nënshkrua marrëveshja e bashkëpunimit shkencor mes ASHSH dhe ASH të Rumanisë. Do punohet edhe për protokollin dypalësh;

⇒ U hartua dhe u dakordësua teksti i marrëveshjes së bashkëpunimit mes ASHSH dhe Universitetit *L'Orientale* të Napolit; punohet për marrëveshje bashkëpunimi mes ASHSH dhe Universitetit të Palermos;

⇒ Është shkëmbyer teksti dhe dakordësuar marrëveshja e bashkëpunimit me Moldavinë. Pala moldave ka shprehur interesin për realizimin e një vizite pune në Tiranë;

⇒ U nënshkruan marrëveshjet e bashkëpunimit me:

a) Universitetin e Gjilanit;

- b) Universitetin e Tetovës;
- c) Universitetin *Nënë Tereza* të Shkupit;

⇒ U nënshkruan marrëveshje (ose shtojca) me Akademinë e Studimeve Albanologjike dhe me Drejtorinë e Policisë së Shtetit;

Bashkëpunime për veprimtari

⇒ U organizua aktivitet në kuadër të 100-vjetorit të marrëdhënieve diplomatike Shqipëri-Britani e Madhe, me pjesëmarrjen e ambasadorit të Britanisë dhe përfaqësues të Universitetit *Warwick* në Britani;

⇒ Pjesëmarrja e akad. Merkoçit në mbledhjen e grupit të punës së ERA-s në Stockholm, në datën 6 prill 2022; aktualisht në bashkëbisedime me ALLEA-n për të organizuar mbledhjen e radhës së ERA WG (maj 2023), në Tiranë, propozuar nga ana jonë;

⇒ U bashkorganizua me Ambasadës së Sllovenisë në Tiranë, në kuadër të 30-vjetorit të vendosjes së marrëdhënieve diplomatike mes dy vendene, dhe në përkujtim të kompozitorit slloven Bojan Adamić.

⇒ Pjesëmarrja e sekretarit shkencor dhe specialistit të marrëdhënieve me jashtë të ASH-së në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të ALLEA-s, në Bruksel. Organizimi dhe kryerja e takimeve me përfaqësues të akademive të ndryshme, me qëllim diskutimin mbi vendosjen e marrëdhënieve të bashkëpunimit shkencor.

⇒ U ndoq dhe u përfundua procedura financiare për pagesat e anëtarësimit të ASH-së tek ALLEA, ISC, UAI.

⇒ U punua mbi pritjen e organizimin e vizitës së delegacionit rumun, përfaqësues të Akademisë së Shkencave Bujqësore e Pyjore në ASH.

⇒ U organizua dhe u zhvillua një vizitë e delegacionit të ASH-së në Akademinë e Shkencave Bujqësore dhe Pyjore të Rumanisë.

⇒ U ndoqën procedurat e aplikimit në thirrjet për kandidatura dhe propozuan akad. Rexhep Mejdani për çmimin e ALLEA-s *Madame de Stael Prize*; prof. Elton Prifti për bordin e ALLEA-s; prof. Nazim Gruda për çmimin *Luigi Tartufari* (në shkencat biologjike). Për pjesëmarrje në komisione të IAP u përzgjedhën prof. Frashëri dhe prof. Barjaba;

⇒ U ripropozua kandidatura e I. Kadaresë për çmimin Nobel në letërsi;

⇒ U koordinua dhe organizua takimi i punës i sekretarit shkencor në Akademinë e Shkencave të Bullgarisë dhe me Universitetin e Sofjes. U realizua dhurimi i librave nga ASH për BK të Bullgarisë, sipas kërkesës së Ambasadës sonë në Sofje (350 tituj, në dy kopje);

⇒ U aplikua për pjesëmarrje në shkollën verore, organizuar nga Akademia e Shkencave e Turqisë, një kandidaturë e përzgjedhur nga Akademia mori pjesë në shkollën verore në fund të shtatorit;

⇒ U asistua pjesëmarrja e akad. Grudës në Asamblenë e UAEE.

Pjesa II
Program paraparak i ASHSH për vitin 2023

I. Probleme të thellimit të reformës në fazën e dytë të saj

Prej dy vjetësh Akademia e Shkencave e Shqipërisë (më tej: ASHSH) ka përcaktuar qartazi objektivat e fazës së dytë të reformimit të saj, e lidhur kjo ngushtë me reformimin e gjithë sistemit të kërkimit shkencor në Shqipëri, realizimi i të cilët kërkon mbështetjen e Këshillit të Ministrave, nëpërmjet pranimit në parim të saj dhe ndërmarrjes së hapave konkretë, duke zhbllokuar kërkesat me shkrim të institucionit tonë për miratimin e disa propozimeve të saj për këtë çështje.

Realizimi gradual i kësaj faze të dytë të reformës institucionale është i mundshëm dhe bëhet krejt i domosdoshëm pasi:

① Përvoja e deritanishme ka treguar përparësitë e forcimit të misionit të Akademisë së Shkencave si institucion parësor i politikës për kërkimin shkencor, duke u kthyer në një qendër kryesore të nxitjes, organizimit e koordinimit të kërkimit shkencor, në përmbushje të rolit e funksioneve të saj të parashikuara në nenin 4 të Ligjit nr. 53/2019 e posaçërisht në pikat 2-6 e 14-18 të tij, nëpërmjet ngritjes e funksionimit pranë saj të njësive të kërkim-studimit, të përkohshme e të përhershme, bazuar në këtë ligj.

Projektet madhore në albanologji, të ndërmarra nga Akademia e Shkencave; si dhe njësitë e kërkim-studimit të ngritura tashmë në zbatim të Ligjit nr. 53/2019: në nanoteknologji, biogjenetikë, inteligjencë artificiale etj., kanë treguar avantazhet dhe efikasitetin e ideimit, përpilimit dhe organizimit të kërkimit shkencor në fushat kryesore të dijes, shoqërore a natyrore-teknike qofshin, nëpërmjet ASHSH si institucion. Ky lloj organizimi ka institucionalizuar e forcuar bashkëpunimin midis vetë kërkuesve e studiuesve, pavarësisht se ku janë të punësuar; midis njësive përkatëse: instituteve, departamenteve e laboratorëve të kërkimit shkencor në universitete e gjetkë, si dhe të vet ASHSH me institucionet e arsimit të lartë (IAL) e institutet e specializuara, së pari publike, për të përcaktuar e realizuar së bashku politikat për shkencën, projekte dhe studime me karakter përparësor kombëtar.

② Është duke u përgatitur ligji i ri për kërkimin shkencor në Shqipëri, bashkëpunim i ASHSH me MAS, i cili u jep vendin e peshën e duhur institucioneve që ngrihen e merren posaçërisht me kërkimin shkencor (institute, qendra, njësi), brenda e jashtë IAL-ve, çka krijon hapësirën e nevojshme *për krijimin e një poli të kërkimit shkencor në vend*, veçmas e krahas veprimtarisë që zhvillohet në kuadër të institucioneve të arsimit të lartë (IAL). Sikurse dihet, ligji në fuqi për arsimin e lartë ka për objekt e qëllim vetëm institutet kërkimore pjesë të IAL-ve, dhe kjo është pozitive, për të forcuar bindjen se *shkollat e larta nuk janë vetëm institucione mësimdhënëse*; por, ndërkohë, kjo ka krijuar gjithashtu idenë dhe realitetin që *kërkimi shkencor është vetëm atribut i tyre*, duke zbalancuar raportin arsim-shkencë.

③ Ka filluar puna për hartimin e strategjisë kombëtare për kërkimin shkencor për periudhën 2023-2030. Kjo strategji duhet të përcaktojë objektivat themelore për zhvillimin e kërkimit shkencor në vendin tonë, me synim *shpejtimin e përafrimit me standardet europiane*, çka kërkon *zgjerimin e rrjetit ekzistues të instituteve kërkimore-shkencore me njësi të reja; forcimin e atyre ekzistuese*; si dhe *vendosjen e një marrëdhënieje bashkëpunimi të bazuar në ligje e akte nënligjore midis Akademisë së Shkencave, IAL-ve publike e një rrjeti institutesh me impakt kombëtar*. Në këtë aspekt, sistemi kërkimor-shkencor në Shqipëri është ende larg jo vetëm standardeve europiane, por edhe nivelit të arritur në vendet e rajonit, si Bullgaria, Sllovenia e Kroacia.

④ Krijimi pranë Akademisë së Shkencave, i njësive të përkohshme a të përhershme në disipinat kryesore të dijes, ku janë e do të jenë të përfshirë kërkuesit e studiuesit më të mirë të institucioneve arsimore-shkencore të vendit, si pjesëtarë apo bashkëpunëtorë, me borde të përbashkëta shkencore, do të plotësonte një boshllëk që ka sistemi ynë kërkimor-shkencor, duke e zgjeruar e forcuar vetë këtë sistem.

Pa shtjelluar më tej argumente të tjera në favor të domosdoshmërisë së kryerjes së mëtejshme të reformës së Akademisë së Shkencave, fazës së dytë të saj dhe të vetë sistemit kërkimor-shkencor në shkallë kombëtare, po pasqyrojmë bashkëngjitur përmbledhtas kërkesat e propozimet tona konkrete drejtuar Këshillit të Ministrave.

Për vijimin e reformës gjatë vitit 2023 Kryesia e ASHSH i ka paraqitur Këshillit të Ministrave një parashtrësë, me anë të së cilës kërkohet:

I. Kërkohet dakordësimi në parim me propozimin që pranë Akademisë së Shkencave të funksionojë një rrjet njësisish të kërkim-studimit, të përhershme a të përkohshme, bazuar në Ligjin nr. 53/2019, që do të përbëhej nga tri komponente kryesore:

⇒ Qendra e instituteve të studimeve albanologjike dhe Qendra e Botimeve Albanologjike dhe Enciklopedike (QBAE);

⇒ Njësitë e reja në fushat prioritare të atyre që konsiderohen shkencë të së ardhmes, si nanoshkencë, bioteknologjia, inteligjenca artificiale dhe energjitë e ripërtëritshme;

⇒ Institutet ekzistuese që kanë nevojë të rikonstruktohen e fuqizohen në fusha me impakt kombëtar, si sizmologjia, mjedisi, ndërtimi, fizika bërthamore.

II. Kërkohet miratimi i propozimeve të ASHSH pranë Këshillit të Ministrave:

⇒ Miratimi i vendimit të Asamblesë së Akademisë së Shkencave propozuar Këshillit të Ministrave *Për krijimin e instituteve albanologjike pranë këtij institucioni nëpërmjet kalimit të rrjetit ekzistues të instituteve të Akademisë së Studimeve Albanologjike (ASA)*, dërguar me shkresën nr. 511 prot. datë 26.07.2021;

⇒ Miratimi i vendimit të Asamblesë së Akademisë së Shkencave *Për ngritjen e njësisë ekzistuese të biogjenetikës në nivelin e një qendre të kërkim-studimit*, dërguar me shkresën tonë nr. 680 prot., datë 02.11.2021;

⇒ Ngritjen e QBAE-së në nivelin e një qendre të përhershme me vendim të Këshillit të Ministrave, *e konceptuar me dy sektorë të specializuar: një për leksikologjinë dhe një për enciklopedinë* (projekti është në përgatitje);

⇒ Ngritja e një komisioni *për përpilimin dhe ndjekjen e programit për krijimin e një qendre kombëtare e rajonale të nanoteknologjisë*, duke përcaktuar hapat e shkallëshkallshëm dhe fazat kryesore të ngritjes e zgjerimit të saj, si dhe përgjegjësitë e institucioneve pjesëmarrëse.

III. Disa kërkesa të tjera mbështetëse për funksionimin e Akademisë së Shkencave janë:

⇒ Miratimi i projektvendimit që synon *disiplinimin e njësimin e pagave për akademikët dhe punonjësit e njësisë të përhershme*. Me këtë rast, meqenëse vitin e kaluar është ndërmarrë një rritje pagash në shkollat e larta e meqenëse pagesat për akademikët dhe punonjësit e administratës së saj nuk kanë ndryshuar që prej 15 vjetësh dhe janë sa një e katërta e atyre të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, kërkohet të bëhet një rritje e tyre.

⇒ Përcaktimi i masave *për zgjerimin me mjedise pune për veprimtaritë e Akademisë së Shkencave*, të vetë selisë qendrore, të njësisë kërkimore e të bibliotekës shkencore të saj.

II. Pasqyrë përmbledhëse për veprimtaritë e parashikuara për vitin 2023

Njësia / komisioni	Projekte	Veprimtari	Gjithsej
SSHSHA vetë	-	15	15
Komisioni i gjuhësisë dhe letërsisë	-	11	11
Komisioni i arkeologjisë dhe historisë	-	11	11
Komisioni i ekonomisë, çështjeve sociale dhe juridike	-	7	7
Komisioni për art e trashëgimi	-	8	8
Njësia <i>NanoAlb</i>	5	7	12
Njësia <i>Biotech</i>	4	11	15
Instituti Kombëtar i Fizikës	1	3	4
Instituti Kombëtar i Matematikës	2	2	4
Komisioni i inxhinierisë	-	3	3
Komisioni i mjekësisë	-	3	3
Njësia e inteligjencës	–	2	2

artificiale			
Njësia për energjitë e pastra	-	1	1
Propozime individuale nga anëtarë të SSHSHA	-	19	19
Propozime individuale nga anëtarë të SSHNT	-	37	37
Gjithsej	12	138	160

II/1. Veprimtari në nivelin e Akademisë propozuar nga SSHSHA

⇒ Paneli ndërakademik i vendeve të Ballkanit Perëndimor, pjesë e nismës së Procesit të Berlinit, propozuar e miratuar në samitin e Sarajevës, bashkëpunim me Akademinë *Leopoldina* të Gjermanisë;

⇒ *Shqiptarët dhe hebrenjtë në Luftën e Dytë Botërore*, konferencë shkencore ndërkombëtare, në javën kulturore të Izraelit në Shqipëri *Kurrë më*, bashkëpunim me *Israeli House in Albania* (25 janar);

⇒ *Studimet albanologjike në Britaninë e Madhe dhe në vendet nordike*, konferencë shkencore ndërkombëtare, bashkëpunim me ASHAK-un;

⇒ Veprimtari shkencore në *110-vjetorin e Konferencës së Ambasadorëve në Londër*, bashkëpunim me ASHAK-un;

⇒ Konferencë shkencore kushtuar *gjendjes dhe sfidave të albanologjisë sot*, bashkëpunim me Universitetin e Shkodrës;

- ⇒ Konferencë kushtuar *100-vjetorit të pavarësisë myslimane shqiptare*, bashkëpunim me BUSH;
- ⇒ *Arbëri në shekujt e humanizmit europian*, konferencë në bashkëpunim me disa institucione publike dhe joqeveritare;
- ⇒ *Sfida dhe perspektiva e bashkëpunimit ekonomik Shqipëri-Kosovë*, konferencë në bashkëpunim me ASHAK;
- ⇒ *Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë 25 vjet pas miratimit*, konferencë;
- ⇒ *Jakov Xoxa, shkrimtari i vetëveçuar*, në 100-vjetorin e lindjes.

II/2. Veprimtari në nivelin e Seksionit Akademisë propozuar nga SSHSHA

- ⇒ *Veçori të luftës antifashiste në krahinën e Skraparit*, konferencë (20 janar);
- ⇒ *Konferencë kushtuar Asdrenit në 150-vjetorin e lindjes* (bashkëpunim me Universitetin e Korçës);
- ⇒ *Arkeologjia midis së shkuarës, së tashmes dhe së ardhmes*, konferencë me bashkëpunimin e institucioneve gjegjëse në Kosovë;
- ⇒ *Gërmimet arkeologjike në Apolloni dhe inaugurimi i Muzeut Arkeologjik-Etnografik në Tiranë*, në 75-vjetorin e themelimit të shërbimit;
- ⇒ *Konferenca shkencore Studimet etimologjike dhe historia e shqipes*, në 115-vjetorin e lindjes së akademikut E. Çabej (1908-1980);
- ⇒ *Vendbanimet e Shqipërisë - gjendja dhe e ardhmja*, përrurim i librit të kumtesave (botim i numerizuar);
- ⇒ *Xhubleta në fokusin e dizajnëve të rinj*, tryezë shkencore dhe ekspozim;

II/3. Veprimtari në nivelin e komisioneve propozuar nga SSHSHA:

1. Komisioni i gjuhësisë dhe letërsisë

- ⇒ *Peter Bartl, njëvjetori i ndarjes nga jeta (B. Demiraj);*
- ⇒ *Ndërlidhjet shqiptaro-arumune në gjuhë kulturë dhe histori (B. Demiraj);*
- ⇒ *115-vjetori i prof. Eqrem Çabejt;*
- ⇒ *115-vjetori i Kongresit të Manastirit, bashkëpunim midis ASHSH e ASHAK;*
- ⇒ *Letërsia shqipe në sistemin universitar (bashkëpunim me FHF);*
- ⇒ *Organizmi i konferencave ad honorem në bashkëpunim me univesitete e qendra të kërkimit shkencor për personalitete si: Anastas Dodi (1933-2008); Angelo Leotti (1884-1963); Fatmir Agalliu (1933-1998); Franz Miklosiç (1813-1891); Gjergj Pekmezi (1872-1938); Holger Pedersen (1867-1953); Jup Kastrati (2024-2003); Kolec Topalli (1938-2018); Remzi Nesini (1933-2018); Xhevat Lloshi (1938-); Wilfried Fidler (1933-2018);*
- ⇒ *Ribotimi i Fjalorit sinonimik të gjuhës shqipe (2004);*
- ⇒ *Ribotim dhe aplikim pranë MAS-it për pajisjen e bibliotekave shkollore të Fjalorit të vogël të gjuhës shqipe (2020);*
- ⇒ *Botim i Fjalorit të gjuhës shqipe me ilustrime dhe i Fjalorit të gjuhës shqipe.*

2. Komisioni i historisë dhe arkeologjisë

- ⇒ *Leksion dr. A. Rëmbeci, Metodologjitë bashkëkohore në fushën e historisë - një vështrim kritik mbi të shkuarën dhe të tashmen;*
- ⇒ *Prezantim i librit të akad. Apollon Baçe Illyrian World;*

- ⇒ Leksion nga prof. S. Muçaj, *Arbëri arkeologjik: rezultate të kërkimeve në rrethin e Tiranës dhe Krujës*;
- ⇒ Leksion nga akad. B. Meta, *Ideologjia e shqiptarizmit dhe "diktatura e ndritur" në vitet politike 1930*;
- ⇒ Leksion nga akad. M. Verli, *Kosova në balancat e politikës shqiptare: paralele dhe veçanti midis viteve 1920-1960*;
- ⇒ 75-vjetori i fillimit të arkologjisë shqiptare;
- ⇒ 80-vjetori i akademikut Apollon Baçe.

3. Njësia Arkeo-Bylis

- ⇒ Kërkimet gjeofizike dhe fotogrametrike në Bylis: ekspeditë e vitit 2022;
- ⇒ Ekspeditë arkologjike në Bylis (në vijim).

4. Komisioni i ekonomisë dhe shkencave sociale e juridike

- ⇒ *Gjendja e mendimit dhe shkencave ekonomike në Shqipëri dhe Kosovë*;
- ⇒ *Sfida dhe perspektiva e bashkëpunimit ekonomik Shqipëri-Kosovë, bashkëpunim i ASHSH dhe ASHAK*;
- ⇒ *Aktivitet shkencor me të rinjtë e të gjitha fushave për çështje të Kushtetutës (konkurs me thirrje mbarëkombëtare për punimin më të mirë për Kushtetutën në gjuhën shqipe)*;
- ⇒ *Konferencë kombëtare në bashkëpunim me Universitetin Polis, Çështje të strehimit, planifikimit dhe zhvillimit resilent të territorit*;
- ⇒ *Tryezë shkencore: Digjitalizimi i ekonomisë shqiptare dhe zhvillimi i qëndrueshëm*;
- ⇒ *Veprimtari shkencore me temë Për zhvillimin e turizmit.*

5. Komisioni për art e trashëgimi kulturore

- ⇒ Promovimi nëpërmjet një koncerti live të CD-së më të fundit të violinistit shqiptar me banim në Itali Piro Gjikonci;
- ⇒ Veprimtari kushtuar 15 artistëve të parë të arteve figurative, që shënojnë fillesat e artit laik në Shqipëri: ekspozitë me një vepër përfaqësuese për secilin prej tyre (në bashkëpunim me Muzeun Kombëtar të Arteve të Bukura dhe Ministrinë e Kulturës dhe simpozium);
- ⇒ Veprimtari (ekspozitë dhe simpozium) kushtuar katër artistëve shqiptarë që e kanë kryer veprimtarinë e tyre jashtë Shqipërisë;
- ⇒ Promovim i botimit me partitura *Antologji e kompozitorëve kosovarë*;
- ⇒ Krijimtaria e kompozitorit Thoma Simaku - në 65-vjetorin e lindjes;
- ⇒ Leksion i piktorit dhe studiuesit të arteve pamore Adrian Paci;
- ⇒ Veprimtari kushtuar *anëtarit të jashtëm të Akademisë - kryetarit të njësisë së muzikës dhe interpretimit Eno Koço, dirigjenti dhe muzikologu ynë në 80-vjetorin e lindjes* (përshëndetje muzikore nga *Academia Albanica*).

III. Veprimtari të propozuara nga SSHNT

III/1. Pasqyrë përmbledhëse e projekteve dhe aktiviteteve të propozuara nga njësitë dhe komisionet

Njësia / komisioni	Projekte	Veprimtari	Gjithsej
NanoAlb	5	7	12
Biotech	4	11	15
IKF	1	3	4
IKM	2	2	4
Komisioni i inxhinierisë	-	3	3
Komisioni i mjekësisë	-	3	3
Njësia e IA	–	2	2
Njësia Energ.	–	1	1
Gjithsej	12	32	44

**III/2. Pasqyrë analitike e projekteve dhe aktiviteteve të
propozuara nga njësitë dhe komisionet**

NanoAlb	Titulli i veprimtarisë
Projekt	<i>1. Towards the establishment of Biosensors Unit at Group of Molecular Biotechnologies, NanoAlb - Use of whole-cell and electro-chemical biosensors to measure water and soil toxicity in Albanian coastline</i>
	<i>2. Development of a new electrochemical sensor for the determination of hydroxy methyl furfural for honey quality control</i>
	<i>3. Preparation and characterization of PVA pure electrofiber nanofibers and PVA / MMT matrix to encapsulate an essential oil of Albanian medicinal plant for biomedical applications</i>
	<i>4. Think big-explore small: studying Nano-Bio interactions using toxicological and computational approaches</i>
	<i>5. Nanosensor for certification of domestic and imported wines based on their total antioxidants</i>
Aktivitet	1. Seminar: Roli i gruas në nanoteknologji
	2. Shkolla e Nano-biosensorëve
	3. Takim i NanoAlb-it për prezantimin e ecurisë së projekteve NanoAlb
	4. Forumi QUARTZ-1
	5. Konferenca 23-të Ndërkombëtare TNT 2023 NanoBallkan
	6. NanoAlb annual workshop
	7. Forumi QUARTZ-2

Q+K.Bio	
Projekt	1. Ngritja e Kriobankës, e para në Shqipëri për konservimin e materialit gjenetik të specieve drufrutore autoktone në laboratorin e ri në Qendrën “Bioteknologji & gjenetikë” në ASHSH (2023 e në vazhdim) CRYOFRUIT – Efigjeni Kongjika
	2. Përzgjedhja e materialit bimor të kumbullës, të kontrolluar nga viruset sipas protokollit, për krijimin e impiantit pilot nëpërmjet shëndetësimin dhe mikroshumimit, në funksion të fillimit të certifikimit të materialit mbjellës (projekt pilot në Rrjet - VITROCERT 2 - 2023) Efigjeni Kongjika
	3. Ngritja e një banke kombëtare të AND-së në popullatën shqiptare për studime gjenetike në këtë popullatë dhe organizimi i një regjistri kombëtar dhuruesish të qelizave staminale për nevojat e transplantit të këtyre qelizave në Shqipëri (ADN-CELLSTAM);
	4. Vlerësimi i shkallës së ndotjes së Hg në gjirin e Vlorës në midhje, alga, peshq dhe sediment
Aktivitete	1. Forum: Karakterizimi dhe konservimi i resurseve gjenetike të ruminantëve të vegjël, situata dhe perspektiva
	2. Forum: Përvijimi morfogjenetik i koranit salmo letnica si specie endemike e liqenit të Ohrit me vlera shkencore e ekonomike
	3. Wsh. (FF) Roli i biosigurisë në parandalimin e sëmundjeve endemike emergjente me rëndësi për kafshët dhe shëndetin public
	4. Workshop (FF) Roli i mjekësisë veterinarë në shëndetin publik dhe sigurinë ushqimore.
	5. Konf. ndërkombëtare Problematikat e sigurisë ushqimore të prodhimeve nga tregu vendës dhe importi: gjendja dhe ardhmëria
	6. Workshop: Gjendja aktuale dhe sfidat e integritetit në BE për certifikimin e fidaneve të drufrutorëve në Shqipëri
	7. Konf. 2-të Për mbrojtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të mjediseve ujore
	8. Webinar (FF) Performanca e testeve laboratorike në

	<i>diagnostikimin dhe kontrollin e sëmundjeve infektive</i>
	9. Forumi Përshatja ndaj ndryshimeve klimatike në sigurinë ushqimore dhe menaxhimin e burimeve natyrore në Shqipëri
	10. Forum ndërkombëtar Sustainable agriculture in Albania and Lithuania
	11. Forum Teknika të gjenetikës humane

IKF	
Projekt	1. Konkurs me video nga të rinjtë
Aktivitet	1. Forum për mësimdhënien e fizikës
	2. Konferenca II e Institutit Kombëtar të Fizikës
	3. Shkolla verore e Institutit Kombëtar të Fizikës

IKM	
Projekt	1. Studim mbi formimin matematik e informatik të parauniversitarëve për të përballuar sfidat e kohës në arsimin e lartë
	2. Krijimi dhe mirëmbajtja e faqes së IKM
Aktivitet	1. Forum shkencor - oponencë programeve të matematikës në shkollat e mesme e të larta
	2. Konferencë shkencore në matematikë

Kom. inxhinierisë.	
Aktivitet	1. Simp. ndërkombëtar Projektimi dhe kontrolli i veprave hidroteknike rezistente ndaj tërmetit
	2. Konferenca ndërkombëtare PN në skema të thjeshta dhe të integruara me energji të rinovueshme

	3. Workshop mbi integrimin e qendrueshëm të Ballkanit Perëndimor në Bashkimin European

Kom. mjekësisë	
Aktivitet	1. Forum shkencor mbi regjistrat kombëtare të sëmundjeve jo të transmetueshme
	2. Forumi mbi sëmundjet infektive të reja dhe masat për parandalimin e tyre
Botim	1. Polimorfizmi gjenetik i sistemit HLA në popullatën shqiptare dhe roli i markuesve imunologjikë dhe imunogjenetikë në realizimin e transplanteve dhe diagnozën e sëmundjeve autoimmune

Njesia int. artificiale	
Aktivitet	1. Konferencë: Sistemet e informacionit me focus në IA
	2. Forum mbi inteligjencën artificiale dhe zbatime

Njësia Energ.	
Aktivitet	1. Workshop: Edukimi inxhinierik për energjinë, tendecat dhe sfidat

III/3. Veprimtari të propozuara individualisht nga anëtarët e Asamblesë për vitin 2023

I. Anëtarë të SSHSHA

1. Akad. Anastas Angjeli:

1.1. *Sfidat dhe perspektiva e bashkëpunimit ekonomik Kosovë, Shqipëri dhe rajon, konferencë e përbashkët me ASHAK, gjatë vitit 2023;*

1.2. *Gjendja e mendimit dhe shkencave në Shqipëri, projekt dhe studim.*

2. Akad. Aurela Anastasi:

2.1. *Përgatitja për botim e librit me akte të konferencës Shteti i së drejtës në këndvështrimin e studiuesve të drejtësisë në diasporë;*

- 2.3. *Trustworthy Fairness Metric Applied to AI-Based Decisions in Food-Energy-Water*, bashkautor, in *Advanced Information Networking and Applications*. AINA 2022. *Lecture Notes in Networks and Systems*, vol 450. Springer, Cham. https://doi.org/10.1007/978-3-030-99587-4_37.
- 2.4. *Trustworthy AI Explanations as an Interface in Medical Diagnostic Systems*, bashkautor, in *Advances in Network-Based Information Systems*. NBiS 2022. *Lecture Notes in Networks and Systems*, vol 526. Springer.
- 2.5. *A. Trustability for Resilient Internet of Things Services on 5G Multiple Access Edge Cloud Computing*, bashkautor; 2022, 22.

2.6. *A geo-location and trust-based framework with community detection algorithms to filter attackers in 5G social networks*, Wireless Netw (2022), bashkautor. <https://doi.org/10.1007/s11276-022-03073-y>.

3. Akad. asoc. Besnik Baraj

3.1. *Factorial design as useful tool for the assessment of matrix interferences*
Pranuar për botim në kuadrin e konferencës NUTRICON

4. Akad. Efigjeni Kongjika

4.1. *Stabilization of an effective sterilization protocol for obtaining aseptic cultures of pomegranate (Punica granatum L) under in vitro conditions*. 4th International Conference on Applied Biotechnology (4th ICAB). Conference Centre “Karolos Papoulias”, University of Ioannina, Greece, Thursday, 20th October 2022. Book of Proceedings, pg. 157 - 163, ISBN: 978-960-233-276-4.

4.2. *On dependence of carbon source type, rapid in vitro regeneration or slow growth of pomegranate plantlets (Punica granatum L. Devedishe var.) might be induced*. 4th International Conference on Applied Biotechnology (4th ICAB). Conference Centre “Karolos Papoulias”, University of Ioannina, Greece, Thursday, 20th October 2022. Book of Proceedings, pg. 144 - 152.

4.3. *Micropropagazione e conservazione in vitro della specie endemica Forsythia europaea Degen et Bald*. IV Convegno Nazionale sulla Micropropagazione: Un incontro tra gli operatori di settore e della ricerca. 12 - 14 October, 2022, Bari, Italy. Acta Italus Hortis (in press).

4.4. *Innovazione nella micropropagazione e nella conservazione in vitro di pero selvatico (Pyrus pyraster L.)*. IV Convegno Nazionale sulla Micropropagazione: Un incontro tra gli operatori di settore e della ricerca. 12 - 14 October, 2022, Bari, Italy. Acta Italus Hortis (in press).

4.5. *Micropropagazione in vitro del mirto (Myrtus communis L.) mediante tecnica convenzionale e coltura liquida con bioreattore ElectIS*. IV Convegno Nazionale sulla Micropropagazione: Un incontro tra gli operatori di settore e della ricerca. 12 - 14 October, 2022, Italy. Acta Italus Hortis.

5. Akad. asoc. Fatbardh Sallaku

5.1. *Soil organic carbon saturation in cropland-grassland systems: Storage potential and soil quality*, Geoderma, 2022, 406.

5.2. *Smart Fertilizers as a Solution for the Biodiversity and Food Security During the War in Ukraine*, Scientific Horizons, 2022, 25(6), pp. 129-137.

5.3. *Recreational Opportunities through Agritourism Increases Relationships within Urban and Rural Communities in Western Balkan Societies*, Review of Economics and Finance, 2022, 20(1), pp. 283-287.

5.4. *The Supply Shock in Organic Fertilizers for Agriculture Caused by the Effect of Russia-Ukraine War*. Scientific Horizons, 2022, 25(2), pp. 97-103.

5.5. *Analysis of soil profile and physico-chemical parameters near the industrial area of Drenas*Journal of Hygienic Engineering and Design, 2022, 38.

6. Akad. Genc Sulçebe

6.1. *Estimating the seroprevalence of SARS-CoV-2 antibodies: Understanding population-level immunity in Albania at the end of the Alpha variant wave*, bashkautor, J. Glob Health 2022;12:03054.

6.2. *Rapid Increase of SARS-CoV-2 Seroprevalence During the Second Half of the COVID-19 Pandemic Year 2020 in the Adult Urban Albanian Population*, bashkautor, SSRN 4235056.

7. Akad. Ilia Mikerezi

7.1. *International Conference on Management of Animal and Plant Genetic resources* botuar në: Endocytobiosis and Cell Research (2021-2022), vol. 31.

8. Akad. Ilirjan Malollari

8.1. *Effect Of Extraction Solvent On Phenolic Content, Flavonoids Content, And Antioxidant Activity Of Pulicaria Vulgaris Gaertn*, bashkautor, (accepted from) Journal of Environmental Protection and Ecology 23, No 1, (2022), Printed by SciBulCom Ltd., www.scibulcom.net, ISSN 1311-5065.

9. Akad. asoc. Kozeta Sevrani

9.1. *Knowledge Transfer through Computerbased Systems in Manufacturing Networks: A Study on Albanian Plants*, bashkautor, Academic Journal of Interdisciplinary Studies, 11(1), 180. E-ISSN 2281-4612 ISSN 2281-3993, <https://doi.org/10.36941/ajis-2022-0016> (indexed by Scopus-Elsevier).

10. Akad. Mimoza Hafizi

10.1. *Using JWST to measure the time delay in single and multiple gravitational lensing systems*, sent for publication to the review *Univers*.

11. Akad. Nazim Gruda

11.1. *Effect of biofertilizers on leaf yield, nitrate amount, mineral content and antioxidants of basil (*Ocimum basilicum* L.) in a floating culture*, bashkautor, *Sci Rep* 12, 20917 (2022). <https://doi.org/10.1038/s41598-022-24799-x>.

11.2. *Growth, Biomass Partitioning, and Photosynthetic Performance of Chrysanthemum Cuttings in Response to Different Light Spectra*, bashkautor, *Plants* 2022, 11, 3337.

11.3. *Journal of medicinal and spice plants* 27(2), 67-72.

11.4. *Monochromatic blue light enhances crocin and picrocrocin content by upregulating the expression of underlying biosynthetic pathway genes in saffron (*Crocus sativus* L.)*, bashkautor, *Front. Hortic.*, 18 August 2022, Sec. Breeding and Genetics, <https://doi.org/10.3389/fhort.2022.960423>.

11.5. *Advances in Soilless Culture and Growing Media in Today's Horticulture- An Editorial*. *Agronomy* 2022, 12, 2773.

11.6. *Global vegetable supply towards sustainable food production and a healthy diet*, bashkautor, *J. Cleaner Prod.* Volume 369.

11.7. *Yield and water use relationships of potato under different timing and severity of water stress*, bashkautor, *Agricultural Water Management* 271(1), 107793. <https://doi.org/10.1016/j.agwat.2022.107793>.

11.8. *Effects of the preceding crop on soil N availability, biological nitrogen fixation, and fresh pod yield of organically grown Faba bean (*Vicia faba* L.)* bashkautor. *Horticulturae* 8(6), 496.

11.9. *Optimising Soilless Culture Systems and Alternative Growing Media to Current Used Materials*, bashkautor, *Horticulturae* 8(4), 292.

11.10. *Light Intensity: The Role Player in Cucumber Response to Cold Stress*, bashkautor, *Agronomy* 12(1), 201.

11.11. *Elevated root-zone temperature promotes the growth and alleviates the photosynthetic acclimation of cucumber plants exposed to elevated [CO₂]* bashkautor. *Environmental and Experimental Botany* 194.

12. Akad. Rrapo Ormëni

12.1. *Seismic characterization of Tirana - Durrës - Lezha region (northwestern Albania) and analysis effort through NDSHA method*, bashkautor, Earthquakes and sustainable infrastructure. Neodeterministic (NDSHA) aproch guarantes prevention rather than cure. Elsevier. Elsevier.com/book and journals, 2021.

12.2. *Some Features of Seismicity in Bulqiza-Macukull Fault Zone During This Centur*, bashkautor, European Journal of Environment and Earth Sciences. DOI: 10.24018/EJGEO) Volume-3, Issue-1, 2022.

12.3. *Performance of URM structures under earthquake shakings: Validation using a template building structure by the 2019 Albanian earthquake*, bashkautor, Journal, Research on Engineering Structures & Minerals. MIN Research Group, Impact Factor. Journal of Citation Report, Scopus.

III.2.2. Botime brenda vendit

1. Akad. Ilirjan Malollari

1.1. *Ekstrakte nga lëkura e domates*, BSHN (UT) 31/2022, p.89-96.

1.2. *Ekstraktimi i vajit të kafes me dioksid karboni superkritik, studimi eksperimental dhe modelimi i tij*, bashkautor, BSHN (UT) 31/2022, p.97-110.

III.3. Artikuj në media

1. Akad. Arben Merkoçi

1.1. *Podcast Episode from It's a Material World, Materials Science Podcast, "Nanobiosensors: Nanotechnology for Next Generation Diagnostics"*, February 14th, 2022.

IV. Pjesëmarrje dhe ndihmesa në veprimtari të tjera

1. Akad. Besnik Baraj

1.1. Konferenca TNT2022 - NanoBalkan në rolin e koordinatorit për organizimin e Kongresit. 3 - 7 tetor 2022, Tiranë.

1.2. Conference of SEE.SDEWES2022, Panelist për temën: Mbetjet urbane, menaxhimi i tyre dhe incineratorët. 24 maj 2022, Vlorë.

1.3. Moderator i takimit të Ministerialit të Ballkanit Perëndimor, organizuar nga KE me rastin e promovimit të botimit “STATUS OF ENVIRONMENT AND CLIMATE IN THE WESTERN BALKANS”. 26 qershor 2022, Tiranë.

1.4. CATRIN CZECH Advanced Technology and Research Institute, Palacky University Olomouc, prezantimi me teme: “What can offer nanotech in case of accident monitoring”, nëntor 2022.

1.5. Prezantim në kuadrin e veprimtarive të NANOALB, organizuar nga Akademia e Shkencave, prill 2022, Prishtinë.

2. Akad. Ilirjan Malollari

2.1. Tendenca te reja ne zhvillimin e shkencave inxhinierike kimike ne shekullin XXI: mundesite e pafundme qe jane perpara”, ligjerate e hapur me stafin akademik dhe studentet e Universitetit te Mitrovices “Isa Boletini”.

2.2. Speech presenting at the Conference on the Internationalisation Strategy at the University of Ioannina, June 7, 2022, Ioannina Greece. International & Public Relations Directorate (geka@uoi.gr)

2.3. Pjesëmarrje në konferencën: “Geosciences and sustainable development” 13-14 October 2022, Mitrovica.

3. Akad. Neki Frashëri

3.1. *Vështrim mbi radiofrekuencat në Republikën e Shqipërisë, në tryezën shkencore “Rishfrytëzueshmëria e brezave frekuencorë UHF, VHF dhe valëve milimetrike për rrjete të komunikimeve pa tela”.* Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës, Prishtinë, 12 shtator 2022.

3.2. *Roli i Akademisë së Shkencave për zbatimin e projektit COBISS në katalogimin dhe dixhitalizimin e informacionit shkencor në Shqipëri.* Seminari Sistemi COBISS dhe digjitalizimi i informacionit akademik, shkencor dhe kërkimor në Shqipëri. Akademia e Shkencave, Tiranë, 6 - 7 shtator 2022.

V. Bashkëpunimi me institucionet e arsimit të lartë

- 1. Akad. Arben Merkoçi, dy lëndë në doktoratë.**
- 2. Akad. asoc. Besnik Baraj, një lëndë në UT.**
- 3. Akad. Genc Sulçebe, mësimdhënie në UMT.**
- 4. Akad. Ilija Mikerezi, dy lëndë në UT.**
- 5. Akad. Ilirjan Malollari, tri lëndë universitare.**
- 6. Akad. Jorgaq Kaçani, tri lëndë universitare.**
- 7. Akad. asoc. Kozeta Sevrani, tri lëndë universitare.**
- 8. Akad. Mimoza Hafizi, tri lëndë universitare.**
- 9. Nazim Gruda, dy lëndë universitare.**
- 10. Akad. Neki Frashëri, pesë lëndë universitare.**
- 11. Akad. asoc. Rajmonda Buhaljoti, dy lëndë universitare.**
- 12. Akad. Rrapo Ormëni, një lëndë universitare.**

Drejtimit i kualifikimit (Doktorata dhe Mastera)

- 1. Akad. Arben Merkoçi, një doktoratë në udhëheqje.**
- 2. Akad. asoc. Besnik Baraj, dy mastera në drejtimit shkencor.**
- 3. Akad. Ilirjan Malollari, 11 mastera shkencorë dhe dy doktorata.**
- 4. Akad. asoc. Kozeta Sevrani, tre doktoratura dhe 10 mastera.**
- 5. Akad. asoc. Mimoza Hafizi, një master shkencor.**
- 6. Akad. Nestor Thereska, një doktoratë.**
- 7. Akad. asoc. Rajmonda Buhaljoti, një doktoratë, 8 mastera.**
- 8. Akad. asoc. Rrapo Ormëni, një master shkencor.**

N

**IV. Veprimtaria e Akademisë së Shkencave
në vlerësime institucionale gjatë vitit 2022**

Antonio Loprieno, President i ALLEA-s

Fjala e mbajtur më 10 tetor 2023, në 50-vjetorin e themelimit të Akademisë së Shkencave

Distinguished Prime Minister of the Republic of Albania,

Dear President of the Albanian Parliament,

Your excellencies,

Dear President of the Academy of Sciences Prof. Gjinushi

Dear colleagues,

Ladies and gentlemen,

It is indeed a distinct privilege to be invited to this 50th anniversary of your Academy to represent the community of European scientists and scholars gathered under the logo of ALLEA, the European Federation of Academies of Sciences and Humanities.

Today, in my short speech I would like to embed the celebration of these ties that unite us so strongly and that I have benefitted from also individually over the last two days into a short history of what Academies of Science have been for our continent since their inception and into a reading of the perspectives of our institutions for our present and future actions.

The emergence of Academies of Sciences is the result of the emergence of a new understanding of science, Latin *scientia*, not as “knowledge”, but of “empirical knowledge”. In the 16th and 17th century, the few universities that existed in our continent and that had been founded in the Middle Ages before the Reformation (Bologna, Oxford, Sorbonne, Heidelberg, Basel) entered a profound crisis, turning into confessional, i.e. Catholic or Protestant institutions. So the *new science*, the *Wissenschaft* in the German sense became the prerogative of a new institution, called academia, inspired by Plato’s academy of Athens.

These new institutions (*Lincci* in Rome, Académie Française in Paris, Royal Society in London, *Leopoldina* in Germany) entertained an elitist understanding of the new science and of *critical knowledge* as the privilege of few in the interest of many.

A new phase in the understanding of the function of Academies of Sciences took place at the end of the 18th and during 19th century. This is the time - in parallel to the industrial revolution in many parts of Europe, of what one might call the production of scientific results as an *industrial exercise*: the academies became the institutions where many scholars worked in a disciplinary (and disciplined) way at large scale projects shared within their scientific community, sometimes - as in Western Europe - within the institutional frame of a *learned society* usually linked to major research universities (Great Britain, Germany, Holland, Belgium), sometimes - as in Austria and Eastern Europe - endowed themselves as academies with research institutes that usually enjoyed a higher prestige than their universities - in these countries more understood as teaching institutions. This year's Physics Nobel Prize went to Anton Zeiliger, who until a few days ago was the President of the Austrian Academy of Sciences, last year's Prize to Giorgio Parisi, President of the *Lincei*.

Your academy, whose jubilee we celebrate today, is the last addition to this community of institutions, the last jewel on the crown of European academies. It was meant precisely as a network (as we would call it now) of research institutes in a variety of disciplines, within an academic landscape in which universities were at that time only teaching institutions.

But the great geopolitical transformation which took place in the 90^{ies} of last century, following the end of the separation of Europe in two blocks, has again changed the role of your academy and of our academies as a whole. The emergence of a European Research and Higher Education area has projected our continent, Europe, as a global player of science production at the world level, able to dialogue at eye level with the USA and the emerging, qualitatively high research in East Asia. ALLEA, the federation of European academies, is itself the product of this great transformation of the academic landscape. And particularly now, at a moment in the history of our continent when this idea of a new intertwined Europe as a scientific community has been so dramatically offended by the Russian war on Ukraine. we understand how much we cherish this transformation, how much it is vital for us, how much we all as European scientists view this integration of our scientific efforts as part of our own self-understanding as academicians and as citizens.

So what is the new role of academies in this perspective that we might facetiously define as *Europe first*? Here, your academy has proven to be as important for us as we are for each other. Back in 2019, your Academy engaged in an important legal reform in which ALLEA and some of its members, such as the *Leopoldina*, provided a hopefully useful contribution on drafting the new Law, an issue that risked to compromise the good and necessary connections with the Government.

We define this function as *capacity building*, i.e. sharing our experiences and creating a bridge to the synergies between academic institutions which are at the core of this European turn of academies.

In this perspective, European academies, and the Albanian Academy of Sciences as its member we are celebrating today, play a double role, 4 which we at ALLEA try to coordinate at the European level and voice in the appropriate forums in Brussels and elsewhere: (1) science coordination, especially as concerns global challenges. While it is very important for scientists to focus on their punctual research topic, we now understand that the major issues we are confronted with are transnational and transdisciplinary. We need to make sure that the punctual scientific efforts of the producers of science be coordinated at the societal level, Europe (not only the EU) in its variety. (2) Science advice. Since our most urgent issues are always transnational and transdisciplinary, there needs to be a more intense dialogue between empirical science and policy making at all levels, national and international, precisely to avoid what happens in many regions of our world, from the West to the East, the emergence of autocratic or populist political figures. Consulting with the academies as producers of science improves the quality of political decision making. Of course, politics is not only science, because it involves other aspects (economy, social welfare, etc.). But the opposite is certainly true: without a foundation in empirical science at the top level there can be no good, informed policy making.

But as academies, we need to realise that in order to fulfill this function, we must accept a further reform or transformation of our own institution, and here again, in order to delineate our present and future mission, I'll draw particular attention to the wonderful country that is hosting this event today and whose academy is celebrating its 50th anniversary. We need to understand that in order to reach scientific excellence in our competitive world, we cannot do everything at a top level at the same time, but we need to channel and focus our efforts on a few domains that we can describe as our institutional unique selling points: they may be different and depend on the academic ecosystem in which we operate, which in Switzerland is different from Germany or from Albania, but we need to agree on where our respective countries and economies can focus in a particularly way and build critical mass. I was very happy to hear, e.g., of the special efforts that your country is doing in areas such as biology and nanotechnology, but also humanities such as Albanology (lexicography and archaeology). These are topics where it certainly makes great sense to invest, because here, in this ecosystem, scientific results at the highest international level can make a difference and let the country as whole benefit from it.

Science is expensive, but without science we are lost. Critical mass is the key to a harmony between these two extremes. I wish the glorious Academy of Sciences of the Republic of Albania as one of our youngest, prestigious additions to our community to continue being the active sparring partner for the European academic community that it has always been, and I wish to the Republic of Albania the continue making the best use of this wonderful resource and let it live, grow and flourish for the benefit of our wonderful continent as a whole.

Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë rroftë, e begatë dhe lulëzoftë për njëqind vitet e ardhshme.

Antonio Loprieno, President i ALLEA-s

Hyrje librit 50 vjet *Akademi e Shkencave e Shqipërisë*

I. Në gjuhën shqipe (përkthim)

Si president i ALLEA-s, Federata Europiane e Akademive të Shkencave, kam nderin dhe kënaqësinë e madhe të uroj Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, anëtare e rëndësishme e familjes së ALLEA-s, me rastin e 50-vjetorit të themelimit të saj.

Përmes këtij libri dhe ALLEA përgëzojnë Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, e cila për 50 vite me radhë ka ofruar dhe vazhdon të ofrojë këshilla për sistemin dhe infrastrukturën e kërkimit shkencor, për çështje shkencore me rëndësi të lartë për politikën dhe shoqërinë, për promovimin dhe lehtësimin e dialogut ndërdisiplinor, për komunikimin e gjetjeve shkencore në shoqëri, duke i dhënë prestigj shkencës dhe kërkimit shkencor në Shqipëri, për punën e palodhur drejt përmirësimit të kushteve për shkencën dhe kërkimin shkencor, për përfshirjen dhe integrimin e kërkimit shkencor shqiptar në sistemin ndërkombëtar të shkencës, si dhe për përmbushjen me sukses të misioneve të saj themelore të përcaktuara në një reformë sistemi shkencor në Shqipëri, ku dhe ALLEA dha kontributin e saj duke ftuar në përbërjen e saj këtë Akademi, në vitin 2018.

Në historinë e saj prej 5 dekadash, Akademia e Shkencave e Shqipërisë ka bërë një rrugë të gjatë dhe mund të krenohet për arritjet shumta gjatë këtij udhëtimi. Akademia ndër vite ka zënë një pozicion thelbësor si në Shqipëri, ashtu edhe në mesin e Akademive Europiane në promovimin e vlerave themelore të shkencës: paanshmërinë, racionalitetin, ekselencën shkencore, pavarësinë, por edhe dialogun me mbarë shoqërinë. Në të njëjtën kohë, ajo arriti me mjeshtëri të modernizohet, duke bërë ndryshimet e nevojshme dhe duke iu përshtatur sfidave të reja.

Ashtu si të gjitha akademitë anëtare të ALLEA-s, edhe Akademia e Shkencave e Shqipërisë është ndërtuar mbi themelet e arritjeve të suksesshme shkencore, autonomisë dhe punës drejt përsosmërisë. Në kohët aktuale sfiduese, ku përballemi me një konflikt ushtarak të egër, që po dëmto Evropën, përballemi me një pandemi globale që merr miliona jetë dhe një katastrofë klimatike në horizont, është e një rëndësie të veçantë që ne të punojmë, prodhojmë dhe të mbështetemi në kërkime shkencore të mirëfillta

dhe që të punojnë së bashku për shkencën si një e mirë publike globale. Më shumë se kurrë, ne duhet të jemi të bashkuar për lirinë akademike dhe përsosmërinë shkencore.

Mbështetur në një traditë të gjatë të ruajtjes dhe ofrimit të trashëgimisë kulturore të Evropës, akademitë kanë rolin kryesor për të mbrojtur dhe promovuar pasurinë intelektuale dhe kulturore të Evropës, për të mbështetur kushtet themelore të shkencës së pavarur, dhe për këtë ato investojnë çdo ditë, bashkohen, ndajnë eksperiencat, njohuritë dhe promojnë kulturë të shumëfishtë. Në fund të fundit, ne përpiqemi njëkohësisht për përsosmëri shkencore dhe integritet kërkimor. Është misioni ynë të krijojmë një kuptim të Europës si një entitet kulturor dhe intelektual që ia vlen të ndiqet, ruhet dhe mbrohet.

ALLEA (Akademitë Europiane të Shkencave) përgëzon Akademinë e Shkencave të Shqipërisë për misionin e saj gjatë 50 viteve të kaluara por edhe në të ardhmen. Ftoj me dashamirësi lexuesit e këtij libri të festojnë 50-vjetorin e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë me mua dhe akademitë europiane dhe ju uroj lexim të këndshëm.

Antonio Loprieno

President i ALLEA-s

II. Në gjuhën angleze

As president of ALLEA, the European Federation of Academies of Sciences and Humanities, it is my great honour and an enormous pleasure to congratulate our highly esteemed member, the Albanian Academy of Sciences, to the 50th anniversary of its foundation.

This book and ALLEA celebrate the Albanian Academy of Sciences for 50 years of reliably providing advice on the research system and infrastructure, on scientific questions of high relevance for policy and society, for promoting and facilitating interdisciplinary dialogue, for communicating scientific findings to society, for giving prestige to the excellent science and research in Albania, for working towards improved conditions for science and research, for strengthening the involvement and integration of Albanian research in the international science system, and for successfully fulfilling its fundamental missions set out in a reform of the science system in Albania to which ALLEA contributed on the invitation of the Academy in 2018.

In its eventful history of 5 decades, the Albanian Academy of Sciences has come a long way and can be proud of its many achievements along this journey. Throughout the years, the Academy has taken an essential position in Albania as well as among the European Academies in promoting framework conditions for science: impartiality, rationality, scientific excellence, independence, but also the dialogue with our fellow citizens. At the same time, it skillfully managed to modernize, thereby making the necessary changes, and adapting to new challenges.

Like all ALLEA member academies, this academy is built on the foundations of scientific excellence, autonomy, and the ever-continuing quest for enlightenment. In challenging times like these, with a devastating military conflict ravaging in Europe, a global pandemic taking millions of lives, and a climatic catastrophe looming on the horizon, it is of utmost importance that we produce and rely on trustworthy and reliable research, that we work together for science as a global public good. More than ever, we need to stand together for academic freedom and scientific excellence, and we need to embark on peaceful cooperation across Europe and beyond.

Due to a long-standing tradition of preserving, securing, and making available the cultural heritage of Europe, the academies are in a prime position to show and promote Europe's intellectual and cultural richness, to uphold the framework conditions of independent science, which need to be promoted and protected every day, gather and share knowledge, and celebrate a culture of diversity. Ultimately, we strive for scientific excellence and research integrity together. It is our mission to establish an understanding of Europe as a cultural and intellectual entity that is worth pursuing, preserving, and defending.

The European Academies of Sciences and Humanities wish the Albanian Academy of Sciences all the best for this joint mission in the next 50 years and beyond. I kindly invite the readers of this book to celebrate 50 years of the Albanian Academy of Sciences with me and the European Academies, and wish you a pleasant read.

Antonio Loprieno

President of ALLEA

Bajram Begaj, President i Republikës

(Fjala në 50-vjetorin e Kongresit të Drejtshkrimit)

*Ndër shekuj gjuha jonë, shqipja që Fishta e quante **gjuhë hyjnore, gjuhë të perëndisë**, është shpirti e identiteti ynë kombëtar, është **amaneti i të parëve**.*

50 vjet më parë, Kongresi i Drejtshkrimit (1972), një ngjarje kulmore kjo në historinë tonë kombëtare, vendosi për platformën e gjuhës së njësuar shqipe. Ky kongres ishte pjesë e një rrugëtimi plot sfida të kombit tonë prej Kongresit të Manastirit (1908), i cili hodhi themelet për unifikimin e alfabetit, duke mënjanuar alfabetet e tjera, Kongresit të Elbasanit (1909), që shtroi rrugën e zbatimit të vendimeve të Kongresit të Manastirit me hapjen e Shkollës Normale të Elbasanit (1909) për arsimim të gjerë publik, si dhe vendimeve historike të Komisionit Letrar të Shkodrës, e cila për herë të parë hodhi hapa të rëndësishëm drejt një politike gjuhësore unifikuese në shërbim të gjuhës së njësuar, si kërkesë që përligjte dhe e bënte funksional unitetin politik të kombit.

Pas pak ditësh, ne do të kujtojmë 114-vjetorin e Kongresit të Manastirit dhe Ditën e Alfabetit Shqip. Një ngjarje madhore kjo për historinë e gjuhës dhe kombit tonë. Atdhetarë e dijetarë të ndritur, nga gjithë Shqipëria e diaspora, u ngritën mbi qasjet personale dhe punuan për atë që ata e quajtën “qëllim të shenjtë”: alfabetin e përbashkët.

Nevoja për të realizuar një gjuhë standarde ka qenë po aq organike sa edhe nevoja për ngritjen e shtetit dhe të arsimit kombëtar.

Parimi i trysisë për kompromis të natyrshëm të vetë folësve të gjuhës amtare për një funksionim ndërdialektor të njësuar, prej Rilindjes Kombëtare e këtej, ka ndikuar pozitivisht në njësimin e gjuhës shqipe, duke qenë një faktor nxitës për standardizimin e saj.

Problemi i një shqipje të njësuar letrare u zgjidh praktikisht qysh me vendimet që u morën në Prishtinë në vitin 1968. Për atë periudhë është ndoshta rasti i vetëm që një propozim me ftesë për debat nga gjuhëtarët e Tiranës të kthehet menjëherë në rregull për zbatim nga gjuhëtarët në Prishtinë.

Kongresi i Drejtshkrimit mbetet një prej atyre zhvillimeve në të cilën aspekti kombëtar fitoi mbi atë ideologjik, një zhvillim i rëndësishëm për rrugëtimin e

gjuhës shqipe moderne dhe unifikimin e saj në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni e Veriut, Mal të Zi e diasporë. Prandaj firmëtarëve të këtij kongresi u takon mirënjohje historike.

Brenda kësaj arritjeje historike jo vetëm gjuhësore, por dhe kulturore e atdhetare, është munda intelektual dhe projekti atdhetar i Naim Frashërit e Gjergj Fishtës, i shoqërive patriotike, klubeve, kongreseve e kuvendeve të Rilindjes Kombëtare, që ndërjuan shtet pa pasur ende shtet.

Gjuha e njësuar shqipe është testamenti i pesë shekujve histori shkrimi të shqipes, i zhvillimit intelektual mbarëshqiptar, i pjekurisë shkencore e atdhetare të botës sonë. Kujdesi për zhvillimin, përparimin, mbrojtjen e fisnikërimin e gjuhës letrare të njësuar është një detyrim kushtetues për ne, për studiuesit e institucioneve shkencore; është një çështje dinjiteti e përgjegjësie kombëtare për të gjithë folësit e saj, kudo që jetojnë.

Të nderuar pjesëmarrës,

Është e vërtetë se standardizimi i një gjuhës shqipe përkon gjithmonë me një histori komplekse social-politike, që nënkupton një akt autoritar në vendosjen e një varianti mbi të tjerët. E megjithatë, standardizimi ndihmon në forcimin e identitetit të përbashkët gjuhësor e kombëtar, në një hapësirë gjithnjë e më të madhe folësish.

Është e udhës të jemi realistë dhe të pranojmë se ky përvjetor vjen me sfida për shqipen dhe për bashkësinë e akademikëve dhe gjuhëtarëve në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni e Veriut, Mal të Zi e diasporë.

Nga pikëpamja demografike, ne shqiptarët nuk e kemi luksin të tregohemi të pavëmendshëm në nxitjen e varianteve, që zhvillohen në mënyrë të pavarur, a me numër më të tkurrur folësish.

Por nuk kemi arsye përse të pranojmë ngurtësimin e shqipes. Ngurtësimi nuk e ndihmon zhvillimin dhe jetëgjatësinë e saj.

Zhvillimi teknologjik, globalizimi dhe hapja ndaj kulturave dhe gjuhëve të tjera, komunikimi dhe ndërveprimi njerëzor, kanë marrë zhvillim si asnjëherë më parë, si në botën fizike dhe atë virtuale.

Konteksti historik, politiko-social, gjuhësor e letrar, në 50 vitet e fundit, ka përjetuar ndryshime të qenësishme në mbarë hapësirën shqiptare. Gjuha si organizëm i gjallë, nuk ka si të mos reflektojë zhvillimet e kohës. Ndaj, diskutimet janë shumë të mira. Ato tregojnë se kemi nevojë të kuvendojmë dhe se kjo është një punë që e kemi për zemër. Por diskutimet për rishikim e pasurim kanë nevojë për transparencë dhe frymë. Transparencë, – sepse për nga vetë natyra, gjuha është gjithëpërfshirëse dhe jo përjashtuese. Frymë, – sepse çdo debat gjuhësor që krijon përçarje është më i dëmshëm kombëtarisht,

sesa i dobishëm shkencërisht. Pa transparencën dhe frymën e duhur, ato kthehen në pengesa, që vështirësojnë përparimin drejt destinacionit të përbashkët: një shqipe që e ndajmë, që e ndjejmë dhe e kultivojmë bashkë, sot dhe për brezat që vijnë.

Në një botë, ku kulturat e mëdha po ngushtojnë gjithnjë e më shumë hapësirat për kombe e kultura të vogla, nevoja për pasurimin e gjuhës dhe mbrojtjen e saj nga huazimet e panevojshme është e madhe.

Lëndës së gjuhës dhe letërsisë shqipe duhet t'i jepet përparësi në shkolla, në mënyrë që brezi i ri, jo vetëm të marrë njohuri të thella të gjuhës amtare, por të edukohet me krenari për gjuhën dhe kulturën, së cilës i përket. Veçanërisht diaspora duhet mbështetur me politika e programe të posaçme. Edhe pse larg atdheut të të parëve, brezat e rinj duhet të rriten me vetëdijen se i përkasin të njëjtës botë shqiptare.

Puna për pasurimin e fjalorit të shqipes dhe përpilimin e fjalorëve, që pasqyrojnë ndërveprimin e saj me gjuhë të tjera, duhet të jetë parësore për akademikët dhe gjuhëtarët.

Ngjyrimet dialektore janë pasuri dhe pjesë e trungut origjinal të shqipes, të cilat i bëjnë nder gjuhës dhe e mbrojnë nga huazimet e panevojshme. Jo më pak e rëndësishme është nevoja për mbrojtjen e shqipes nga padija gjuhësore dhe mosrespektimi i rregullave të saj. Gjuhëtarët dhe shkrimtarët duhet të kthehen në pedagogë të zëshëm publikë.

Të nderuar pjesëmarrës,

Sa më të gjerë kufijtë e gjuhës, aq më të gjerë dimensionet e mendimit dhe shprehjes së një njeriu dhe të kombit.

Shqipja është bota jonë – një botë që pret ta eksplorojmë dhe pasurojmë bashkërisht, deri në kufijtë e skajshëm të saj.

“Një komb një gjuhë”

Ju uroj punë të mbarë dhe suksese!

Faleminderit!

Edi Rama, Kryeministër

**Fjala në 50-vjetorin e themelimit të Akademisë së Shkencave
10 tetor 2022**

I nderuar president i Federatës Europiane të Akademive të Shkencave dhe Arteve,

Të nderuar pjesëmarrës,

Për çdo njeri që merret me shkencë, termi “akademi” ka një domethënie të madhe. Për ne, akademia ka qenë ëndërr. Ajo materializonte dëshirën e rilindësve për më tepër dituri dhe institucione studimore të së ardhmes.

Këto janë fjalët e njërit prej themeluesve të akademisë suaj, profesorit të paharruar Aleks Buda. Si një institucion i ngritur mbi vlerat e krijuara nga akademia e re e Voskopojës, nga programet e rilindësve, nga idetë e Nolit, Lumo Skëndos, Ndre Mjedës për zhvillimin e mendimit kritik dhe atij shkencor, Akademia edhe në atë kohë aq të zymtë në aspektin e lirisë, qëndronte sidoqoftë si mënjane nga ndikimi politiko-shoqëror i vendit dhe një ndër episodet që do doja të kujtoja këtu para jush është fjalimi i lamtumirës së Aleks Budës në varrimin e gjuhëtarit Selman Riza i cili, asokohe, ishte i dëbuar nga Instituti i Histori-Gjuhësisë dhe i lënë në harresë diku në një muze periferie në Berat, derisa u nda nga jeta. Thuhet se ky akt i Aleks Budës si dhe prania në varrimin e gjuhëtarit e një sërë akademikësh të shquar të asaj kohe bëri bujë qoftë në Institut, e qoftë në mjedisin politik, por qëndrimi i profesor Budës në nderim të gjuhëtarit nuk ishte një sfidë ndaj regjimit, por ishte pikërisht një shprehje e mënjanisë së Akademisë në funksion të nderimit të dijes, të nderimit të profesionalizmit, të nderimit të rrugës së shkencës, një nderim për një punë kolosale, siç ishte puna e Selman Rizës kushtuar vendit, kushtuar kombit, kushtuar shqiptarëve dhe një nderim nga vetë kryetari i Akademisë së Shkencave.

Para viteve ‘90 ishte koha kur liria ishte e kufizuar dhe kur hapësirat dhe mundësitë e njerëzve të shkencës ishin tejte të ngushta, por krahasimi mes para dhe pas ‘90, e bënë pas ‘90 të duket jo mirë, për ta thënë me fjalë të buta, përballë gjithë atyre punëve, veprave dhe figurave.

Kaq e vërtetë është kjo, të paktën në këndvështrimin tim, saqë t’iu them të drejtën, kur vizitova Akademinë e Shkencave pas ‘90 dhe dëgjoja ato kërkëllitjet e parketit të vjetër, më dukej sikur ishte Eqerem Çabej që rrotullohej në varr nga gjendja e dëshpëruar e atij institucioni.

Një institucion që përfaqësoi dhe mbrojti me forcë interesin e lartë kombëtar të gjuhës shqipe. Nëse sot ne kemi një gjuhë të unifikuar dhe një gjuhë të shpëtuar, kjo i detyrohet në radhë të parë akademikëve të asaj kohe dhe asaj Akademie Shkencash që sot është në një proces për tu rikthyer në lartësinë dhe vendin që i takon. Debatet e mëdha që pasuan pas rënies së komunizmit në ballafaqimin me vendet e tjera të rajonit, por edhe me historinë e përbashkët të Europës, ne nuk do mundnim t'i bënim dot me argumentet shkencorë që disponojmë nëse nuk do të na i kishin lënë trashëgimi themeluesit e Akademisë së Shkencave. Nëse nuk do të kishte ekzistuar Eqrem Çabej, Aleks Buda dhe një sërë figurash të tjera, ne do të ishim krejtësisht të paarmatosur në të gjithë rrjedhën e debatit të hapur tanimë mes vendeve për prejardhjen e tyre, për gjuhën e tyre, për historinë e tyre dhe kështu me radhë.

Çfarë historie do të mund të shkruanim ne, sot që kemi marrë përsipër ta bëjmë sigurisht, me mendjet dhe duart e kësaj Akademie Shkencash dhe me mbështetjen e qeverisë nëse sot në këtë Akademi nuk do të ishin disa, për fat për të mirë, prej nxënësve të atyre kolosëve të mëdhenj si profesor Paskali apo profesor Pëllumbi? Asgjë!

Sigurisht që detyra e këtij institucioni dhe përgjegjësia e madhe kombëtare e këtij institucioni nuk është vetëm mbajtja nën kontroll e të shkuarës, në funksion të themeleve të shtëpisë sonë të përbashkët dhe të garantimit të kësaj shtëpie nga çdo tërmet dhe stuhi e natyrës politike apo e natyrës akademike në atë që siç thashë, është një debat i hapur dhe i vazhdueshëm në një shoqëri të hapur, në një proces ku ne tanimë nuk jemi të mbyllur e të izoluar dhe mund të flasim me vete, mund t'i themi vetes çfarë të duam, por çuditërisht nga monologu i të shkuarës ne kemi shumë më tepër argumente sot për tu përballur me botën si shqiptarë, sesa nga dialogu që pasoi rrëmujshtëm dhe që e shkatërroi komplet Akademinë e Shkencave, sigurisht me dorën e politikës e cila ndërhyri vandalisht për shpërbërjen e të gjitha strukturave të Akademisë së Shkencave dhe për braktisjen e të gjithë atij rezervuari burimesh njerëzore që ishin mbase pjesa më e çmuar e trashëgimisë të së shkuarës. U ngatërrua sistemi i vjetër me njerëzit që flisnin me zërin e shkencës.

Faktikisht, sot ne jemi në kushtet ku mund të themi se falë reformës së vitit 2019, e cila u organizua në një ndërveprim të udhëhequr nga vetë Akademia e Shkencave për hir të vërtetës dhe më lejoni ta them, edhe kjo është përsëri në vazhden e asaj që po përpiqem të them deri tani, në lidhshëm me Skënder Gjinushit, imagjinojeni vet tani se sa domethënëse është kjo.

Përsëri duhet dikush i asaj kohe akademike që të mund të garantojë këtë kohë kaotike me shpresën që do të kemi dhe ne kohën tonë akademike.

Faktikisht sot Akademia nga një vend i pashpresë përshpirtjes, ku mesa më kujtohet mbledhjet më të rëndësishme ishin ato për t'i dhënë lamtumirën ndonjërit që ikte në botën tjetër, është kthyer në një hapësirë ku po mbillen fidanët e të nesërme. Faktikisht sot ka një hapje të munguar për shumë vite, jo vetëm për të krijuar kushtet që akademikët e këtij vendi, pavarësisht bindjeve, simpative, rreshtimeve të tyre nën çatinë e Akademisë të ndihen pjesë e së njëjtës mënjanesi siç ndiheshin dhe siç silleshin ata të kohës së anësisë ekstreme, por edhe për akademikët shqiptarë të një gjenerate tjetër, të gjeneratës së emigracionit, akademikët shqiptarë që bëjnë sukses mbresëlënës nëpër botë edhe që deri kur reforma e 2019 mori udhë, ishin tërësisht të harruar dhe të braktisur sikur nuk ekzistonin.

Para pak ditësh u mbajt në Tiranë një kongres i dytë ndërkombëtar i nanoteknologjisë, diçka e pakconceptueshme vetëm pak vite më parë, diçka e paimagjinueshme para reformës së 2019 me pjesëmarrjen e instituteve prestigjioze të teknologjisë nga 25 shtete në një diskutim i cili bëhej në Shqipëri, por që nuk e linte jashtë shkencën dhe nuk i linte jashtë shkencëtarët shqiptar, jo thjesht si mikpritës, por edhe si pjesë e respektuar e atij komuniteti.

Sot ne jemi në kushtet kur kemi ringritur një qendër për botimet enciklopedike albanologjike e cila drejton një proces të ndërlikuar të hartimit të tre botimeve madhore me mbështetjen e qeverisë dhe në bashkëpunim edhe me qeverinë e Kosovës për gjuhën dhe për kulturën. *Enciklopedia Shqiptare, Historia e Shqiptarëve dhe Fjalori i Madh i Gjuhës Shqipe*. Janë tre sfida të mëdha në tre drejtime ku Shqipëria, ku jo vetëm shteti ynë, por kombi ynë janë të kërcënuar. Është e kërcënuar historia e shqiptarëve nga një injorancë dhe nga një arrogancë e pashembullt që për shumë vite e ka kthyer mënjanesin e Akademisë së Shkencave në një territor anësisht politike dhe në një arenë ekstremizmesh që gjejnë rrugë për shkak se bota e informacionit dhe e komunikimit është një botë që nuk ka respekt për asnjë hierarki të dijes, e për këtë arsye ne jemi akoma sot në kushtet kur është e pasigurt nëse mundet apo jo ta shkruajmë një histori të shqiptarëve që të jetë e të gjithë shqiptarëve e të cilës t'i referohen shqiptarët brez pas brezi, duke sigurisht e pasuruar, por jo duke u ndarë për ta kontestuar.

Ashtu sikundër sot gjuha shqipe është e kërcënuar si asnjëherë me parë. Gjithë ato që thuhet dhe gjithë ato që ndërmerren kundër gjuhës shqipe në rendin e pavërtete akademik, pseudo-akademikë në fakt, janë vetëm maja e një ajsbergu që po e gërryen gjuhën shqipe nga poshtë përmes shpërdorimit total të saj në një botë komunikimi ku askush më nuk e ka mendjen sa saktë shkruhen fjalët, por e ka mendjen që të bëjë “sent” sa më shpejt. *Fjalori i Madh i Gjuhës Shqipe* duhet të jetë një gur themeli për të përforcuar atë

themel të jashtëzakonshëm që vendosën etërit themelues të Akademisë së Shkencave. Unë besoj që gjuha e unifikuar shqipe është një nga pasuritë më të mëdha të shqiptarëve dhe një nga ato thesare që askush nuk duhet lejuar t'i prekë dhe t'i shpërdorjë.

Për ta mbyllur, dëshiroj të them se ne sot jemi shumë larg asaj që mund të ishim në rast se do ishte garantuar vijimësia e Akademisë së Shkencave dhe në rast se mes të djeshmes dhe të sotmes, ose më saktë të aktualitetit në të cilit flasim, nuk do të kishte hyrë në mes një e sotme ku vulgu i politikës dhe kryengritja e injorantëve nuk do të kishin bërë gjithë atë kasaphanë që bën me gjithë rrjetin e dijes dhe me gjithë infrastrukturën e atij rrjeti të dijes.

Dikur Akademia e Shkencave ishte vendi ku garantoreshin studime dhe projekte me një rëndësi madhore në të gjitha fushat e zhvillimit. Nuk është më sot, sepse nuk u lejua të jetë dhe ndërkohë që është fakt, se ne jo vetëm që nuk patëm vëmendjen dhe mirësinë në gjithë këto dekada të mendojmë realisht për vijimësinë, jo vetëm goditëm me themeli gjithë ngrehinën e shkencës dhe vatrën e saj kryesore, Akademinë e Shkencave, por mbetëm tërësisht jashtë rrugëve të ndërveprimit dhe bashkëpunimit me Europën për të cilën flasim përditë.

Bëmë një bilanc përpara pak ditësh me ministren e Arsimit. Aksesi i Shqipërisë përmes universiteteve dhe natyrisht në mungesë të Akademisë në të gjithë vitet e shkuara në programin “Horizon 2020” ishte 8 për qind . Shqipëria ka marrë 8 për qind , vetëm 8 për qind financim të asaj që mund të merrte. Sot jemi në vitin e parë të programit të ri dhe sot jemi 38 për qind në vitin e parë. Universitetet kanë marrë, bota akademike ka marrë për kërkimin shkencor falë ndërveprimit dhe falë edhe fillimit të një lëvizje në drejtimin e duhur, ku natyrisht lidershipi i Akademisë së Shkencave ka rolin e vet, 2.1 milionë euro, që sipas gjithë parashikimeve më modeste mund të jenë 20 milionë pa asnjë frikë në 7-vjeçarin e programit dhe mund të bëhen edhe më shumë. Mund të bëhen edhe më shumë nëse ne do të dimë të bashkohemi mënjansisht për shkencën dhe kërkimin shkencor dhe t'i lëmë anësitë jashtë perimetri të shkencës dhe kërkimit shkencor, ku ka shumë territor për t'u kacafytur sepse brenda këtij perimetri jo vetëm mbrohet e shkuara, jo vetëm mbrohet historia, jo vetëm mbrohet gjuha, jo vetëm mbrohet kultura, jo vetëm mbrohet etnosi ynë, por edhe garantohej e ardhmja. Një e ardhme që shkon shumë përtej të ardhmes që mund të garantojë politika, që mund të garantojnë partitë, që mund të garantojnë qeveritë në faza të caktuara të marrjes së përgjegjësisë prej tyre.

Sot ne jemi në kushtet kur mund të shtyjmë falë edhe pozicionit të ri që kemi në kontekstin evropian si vend që në komunitetin e ri politik evropian, shkenca dhe arsimit, duke filluar nga arsimit i lartë të mos presin integrimin e

plotë europian të vendit tonë apo të vendeve të tjera të rajonit, por të bëhen sot pjesë e perimetrit, ta bëjnë sot pjesë të tyre dhe perimetrin e shkencës dhe të arsimit të lartë shqiptar. Për këtë kemi nevojë, nga njëra anë të shtyjme më fort në nivelin evropian ne, qeveria, por nga ana tjetër kemi nevojë të japim shembuj dhe sot kemi një shembull domethënës. Deri dje pedagogët e përfshirë në kërkimin shkencor me fonde europiane në Universitetin e Tiranës ishin afro 50 vetë, sot ka kaluar 400, gjë që natyrisht rrit dhe të ardhurat e tyre, por mbi të gjitha krijon shembullin që ne jemi pjesë dhe tregon se ne dimë. Çështja është si ne këtë dije ta ekspozojmë për shoqërinë dhe ta kthejmë nga një dije individësh në një dije të një komuniteti akademik i cili i shërben vendit duke qendruar mënjanë nga rrjedhat e turbullta të zhvillimeve kaotike të së përditshmes së vendit. Shumë njerëz thonë: *ne kemi ujë, ne kemi diellin, ne kemi naftë, ne kemi minerale, ne kemi pyje, ne kemi male, ne duhet të jemi si Zvicra sepse jemi shumë të pasur*. Mirëpo vendet nuk dallohen nga ato që kanë, dallohen nga ajo që dinë. Zvicra nuk ka sa ne, por Zvicra di më shumë më tepër se ne dhe kështu nëse ne shohim investimet në dije, investimet në shkencë krahasuar me të ardhurat, do të shohim diçka shumë të thjeshtë. Sa më shumë është investuar në dije dhe në shkencë, aq më shumë janë rritur edhe të ardhurat.

Izraeli nuk ka ujë, por është vendi numër një në planet për ujin, ka ekselencën e furnizimit me ujë pa pasur ujë fare, sepse ka dijen. Ne kemi ujë më shumë se sa të gjithë pas Norvegjisë dhe problemin kryesor ne sot kemi ujin në të gjitha aspektet. Ende. Pse? Për shkak të një trashëgimie të egër si rezultat i padijes.

Me shumë nderim për të gjithë ju dhe me një kënaqësi të madhe që e pashë këtë sallë “të pushtuar” akademikisht dhe duke ju siguruar se do të jetë një pamje e paharruar për mua, një pamje që do ma bëjë më të rëndë seancën e radhës të Parlamentit, por do ta përballoj siç jemi mësuar të përballojmë gjëra edhe më të rënda, ju shpreh gjithë mirënjohjen për gjithçka keni bërë në këtë kohë jo fort të lehtë, për ta thënë me fjalë të buta, për shkencën, jo fort të lehtë për njerëzit e dijes, ju shpreh gjithë respektin tim për sa shumë i keni rezistuar injorantëve, dallkaukëve dhe vulgarëve që ju kanë dalë përballë dhe ju kanë treguar se si bëhet kjo punë në shumë e shumë vite dhe uroj me gjithë zemër që të mos dorëzoheni siç nuk dorëzohet “i paoksidueshmi” Skënder Gjinushi.

Edi Rama, Kryeministër

Fjala e mbajtur në 50-vjetorin e Kongresit të Drejtshkrimit, 10 nëntor 2022

Shumë të nderuar të pranishëm!

Jo shumë kohë më parë Ismail Kadareja ka shkruar se *gjuha është një pakt i vështirë, më i vështiri pakt që njerëzit kanë lidhur mes tyre* dhe kjo frazë më përkoi më së miri me këta flamujt, duke pasur parasysh se sa shumë rrugë është bërë që këta tre flamuj të qëndrojnë këtu sot së bashku si flamuj që mishërojnë ndër të tjera dhe në të njëjtën kohë, një pakt të vështirë siç është gjuha.

E dimë shumë mirë, por rreziku gjithnjë e më i madh është që ta marrim si diçka që ka qenë gjithnjë aty sesa e vështirë, sesa e stërmundimshme dhe sesa e pamundur është dukur, jo shumë shekujt më parë, por vetëm deri disa vite më parë që gjuha shqipe të flitej, të shkruhej dhe te pranohej lirisht si e drejta më themelore e shqiptarëve, jo vetëm në Shqipëri, por edhe në Kosovë, edhe në Maqedoninë e Veriut.

Nga ana tjetër, i vetmi flamur që nuk kuptova këtu pse është, është flamuri i NATO-s dhe s'munda të rri pa ia thënë dhe organizatorëve, se deri te flamuri i BE dakord, por flamuri i NATO-s çfarë do tek 50 vjetori i Kongresit të drejtshkrimit, nuk e mora vesh. Se shyqyr Zotit, Akademia ka shpëtuar nga ai ankthi i madh për të luftuar komunizmin pas vdekjes së komunizmit. Nejsë!

Tamam 3 dhjetë vjetorë pas rënies së komunizmit edhe drejtshkrimi ne na duket njësoj, na duket sikur ka qenë gjithmonë aty. Sikur e kemi një mundësi që mund edhe ta shpërdorojmë, mund edhe ta vëmë në pikëpyetje. Ndërkohë që, unë dua ta falënderoj akademinë për këtë konferencë, e cila vlen për të kujtuar të kundërtën, për të kujtuar se konsensusi gati unanim që u gjet rreth drejtshkrimit 50 vjet më parë, është mahnitës, po të kesh parasysh se në çfarë konfliktesh të përgjakshme dhe në çfarë procesesh rraskapitëse kanë ecur gjuhë të tjera për të arritur njësimin e tyre dhe për t'u bërë palca e gjithë skeletit të paqes sociale.

Mjafton të mos shkojmë larg, por tek fqinjët tanë jugorë dhe të kujtojmë ndasinë akute shekullore mes *demotikes* dhe *katharevousas* dhe historia na mëson se drejtshkrimi dhe gjuha e njësuar nuk janë gjë tjetër, veçse një proces konsolidimi i frymës dhe i germës së një kombi, i qenies së një kombi.

Nismëtarët e Kongresit të Manastirit iu futën punës me bindjen se alfabeti unik dëshmon që kombi ynë është bërë një si komb. Dhe kombi nuk mund të mbajë gjatë në këmbë vetëm prej mistikës dhe miteve, ndaj i nevojitet kjo sintezë racionale, e ka të domosdoshëm këtë kodifikim të vazhdueshëm të një semiotike përbashkuese dhe për këtë arsye drejtshkrimi dhe gjuha e njësuar i nënshtrohen në vijimësi dhe e pamundur të ndodhë ndryshe, edhe një lloj arbitrazhi publik ose shtetëror. Por edhe kur kanë qenë arbitrare, por janë ratifikuar pastaj nga koha dhe nga përdorimi i papenguar.

Praktikisht këto arbitrazhe janë përligjur dhe janë kthyer në institucione, janë kthyer në ligje që për gjithë traditën liberale kontinentale, siç e citon Rusoi (Rousseau) konsiderohen si shprehje e vullnetit të përgjithshme të kombit, sado zë të ketë pakica dhe sado të drejtë të ketë pakica që t'i kundërshtojë.

Njësimi i drejtshkrimit të gjuhës shqipe dhe standardizimi i saj është një nga ato procese historike që për fatin më të madh të shqiptareve është përvijuar ngjashmërisht me proceset e njësimit të gjuhëve europiane.

Por e para, siç e preka më lart, ka kaluar gjithsesi më butë sesa proceset e tjera njësimi gjuhësh të tjera dhe e dyta, është nga të paktët procese që në historinë tonë na njëson për nga struktura dhe për nga metoda me vende të tjera europiane. Dhe kjo, e përsëris, i detyrohet dhe një fati që ne kemi pasur si shqiptarë. Ndonëse pa një shtet tonin, që edhe kur e patëm nuk e patëm me mundësi dhe mjete të konsiderueshme, fati ynë ka qenë mendja e ndritur dhe talenti i mahnitshëm i njerëzve të dalluar të këtij kombi.

Burime njerëzore dhe karaktere të hatashme shqiptare, personalitete me një vizion shumë më të madh sesa gjeografia dhe ngushtësia e Shqipërisë dhe në tërësi e zonës ku është vendosur shqiptaria, emrat e të cilave ndjekin njeri pas tjetrit në një zinxhirë që është një zinxhir i artë, fatmirësisht i pandërprerë deri vonë.

Por duhet ta them, kur hap faqet e fundit këtu dhe kur lexon emrat në faqet e fundit dhe kur kërkon të ngjashmit e shumëkujt prej këtyre që sot nuk janë më në jetën tonë të përditshme, është e pamundur të mos ndjesh një ankth të thellë sepse me gjithë respektin, por të ngjashmit e Eqrem Çabejit, Mahir Domit, të Androkli Kostallarit, të Aleks Budës, e kështu me radhë dhe jo vetëm ata që kanë ikur, por të ngjashmit e gjeneratës së re profesor Emilit që është aty, vështirë, shumë vështirë. Nejsë!

Shoqëria e të Shtypurit të Shkronjave Shqip në 1879, duke kaluar nga Kongresi i Manastirit në 1908 tek Komisia letrare në 1916-1917-ën, tek Konsulta gjuhësore e Prishtinës në 1968-ën dhe për të përfunduar tek Kongresi që ne sot kujtojmë, janë mishërim mendjesh shqiptare të ndritura, talentesh te

jashtëzakonshme, karakteresh të hatashme që shekulli i ri nuk do t'i mblidhte dot bashkë, pavarësisht gjithë ndryshimeve që kanë ndodhur dhe kjo është mendoj unë, një nga pikëpyetjet më të mëdha në rrugën tonë drejt së ardhmes. Dhe ky është edhe një nga boshllëqet më të mëdha që e kërcënon kulturën, që e kërcënon integritetin tonë si popull e si komb sepse siç e keni parë kërcënon drejtpërdrejtë gjuhën tonë shqipe. Dhe kushdo që ka sy dhe gjykim të kthjellët të gjitha këto momente, që nga 1879 tek 1972-shi, mund t'i shohë që janë një zinxhir në koherencë të plotë me një amanet të brendshëm, të cilin e kanë mishëruar njerëz specifikë në kohëra të ndryshme dhe secili prej këtyre njerëzve, në secilin prej këtyre momenteve ka përmbushur një objektiv të kohës, dhe ka shfrytëzuar deri në fund hapësirën që lejonte kufiri i përparimit të përgjithshëm.

Në asnjë nga këto momente nuk ka pasur nxitim dhe në asnjë fazë midis këtyre momenteve nuk është parë nxitimi racional i kësaj faze të fundit, të këtyre 3 dekadave për të shkuar me çdo kusht në qorrsokak duke guxuar të tentohen shtrembërime të frikshme të një arritje që mbase, mbas pavarësisë në 1912 e mbas ndonjë ngjarje tjetër, është arritja më e madhe e shqiptarëve, gjuha e njehsuar shqipe. Dhe edhe në Kongresin e Drejtshkrimit nuk është se s'ka pasur debate, të paktën nga sa mund t'i thonë një njeriu si unë që s'jam as i zanatit, as i përkas tamam asaj kohe, leximet sporadike me thënë të drejtën, jo shumë sistematike, por një gjë është sot e gjithë ditën një pikë referimi për këdo që do të logjikojë e do të shohë me arsye në të gjitha dilemat natyrale që shfaqen mbi gjuhën në rezolutën e kongresit.

Kongresi porositi që duke marrë parasysh ndryshimet që pëson gjuha letrare gjatë zhvillimit të saj si dhe çështjet e reja që nxjerr praktika gjuhësore, rregullave të drejtshkrimit t'u bëhen në të ardhmen që kur të jetë e nevojshme përmirësime dhe plotësimet e duhura. Dhe vazhdon, pikërisht këtu qëndron rëndësia themelore e drejtshkrimit, si në aspektin thjesht gjuhësor, ashtu edhe në aspektin kulturor dhe shoqëror. Kjo kërkon që drejtshkrimi i gjuhës shqipe të ketë parasysh, jo vetëm gjendjen e gjuhës sotme letrare, por edhe prirjet kryesore të zhvillimit të saj të mëtejshëm dhe faktikisht mua më vjen të qesh si "dashnor" i paepur i gjuhës shqipe, në këtë status kryesor po flas sot këtu dhe prandaj erdha me kaq dëshirë sot këtu, se as mund dhe as dua dhe as kam pse të qaj kur ndjek këtë debatin fantastik ku Kongresi i Drejtshkrimit i qortohet si një mëkat i pashlyeshëm që vë në diskutim dhe vetë kongresin, fakti që u zhvillua nën patronazhin e një pushteti absolut.

Po çfarë shoh unë të paktën, i interesuar thashë, si një "dashnor" i paepur i gjuhës shqipe Në 1879 shoqëria e të shtypurit të shkronjave shqip, u autorizua të veprojë nën patronazhin e një monarku absolut, Sulltan Abdyl

Hamiti i II, të cilit iu dhurua ekzemplari i parë i abetares që përpunohej shoqëria.

Shoh që Kongresi i Manastirit në 1908 u zhvillua me lejen dhe nën patronazhin e valiut xhonturk të Manastirit, i cili mori pjesë në çeljen solemne të Manastirit, vlerësoi lëvdatat që kongresistët i adresuan atij, domethënë Valiut, dhe sovranit të madhërisëm të osmanëve. Por kongresi bëri punën e vet, as për Valiun, as për Sovranin e Madhërisëm, por për gjuhën shqipe. Komisia letrare e Shkodrës më pas u mbledh nën autoritetin e një fuqie pushtuese, asaj austro-hungareze të bab krajlit që i thoshin dhe në kundërshtim me të gjitha mbledhjet e tjera kombëtare, ajo u patronazhua nga gjuhëtarë të huaj, austriakë të vlerësuar e të nderuar sot e gjithë ditën, por nuk ishin vendas.

Në 1923 në mungesë të një dakordësie shkencore përfundimtare mbi gjuhën, standarde u desh që dialekti i Elbasanit të shërbente për disa kohë si gjuhë administrative dhe ky dialekt me dekret të njëanshëm, u caktua përsëri nga një pushtet jo demokratik. Dhe çfarë shohim po të shkojmë dhe përtej Shqipërisë në Evropë, gjuhën e njehsuar teologjike të botës së krishterë e bën “koncile ekumenike” të mbajtura në prezencë dhe nën arbitrazhin e perandorëve romako-bizantin; gjuhën frënge të kodifikuar në bazë të të folurës së Parisit, ishullit të Francës etj etj, e bënë shkencëtarët, por në bekimin e Risheljesë dhe nën patronazhin e burbonëve dhe çfarë ka të qortueshme në këtë aspekt Kongresi i drejtshkrimit në vitin 1972 nëse mund ta thotë kush. Përkundrazi Kongresi i Drejtshkrimit ka të veçantë dhe madje edhe të paarrtshme, provoni ta bëni sot një kongres, provoni ta bëni se është e vetmja shpresë që Eqrem Çabej të ngrihet nga varri bashkë me gjithë këta nënshkruesit që kanë ikur në botën e përtejme, mbasi i kanë lënë kësaj bote një thesar që është një pasuri kombëtare me të cilën nuk mund të lejojmë dot të luhet hajgare që është gjuha e njehsuar. E para, një punë përgatitore shkencore gjithëpërfshirëse 20 vjet, për Kongresin e Drejtshkrimit.

Imagjinoni sot një punë përgatitore shkencore 20 vjet. Gjë që e bëri Kongresi i Drejtshkrimit dhe nuk e kanë bërë ato të tjerët që përmenda. Një nismë e ardhur nga shqiptarët e Kosovës, në një atmosferë entuziazmi që më mirë se kushdo tjetër e ka përshkruar, gjejeni, Rexhep Ismajli, një gjuhëtar që nuk mund të thuash se është tërësisht në sintoni me Kongresin e Drejtshkrimit. Një gjithëpërfshirje nga trevat shqipfolëse deri në viset arbëreshe. Dhe vijmë tek delegatët, e thashë dhe po e përsëris, emrat e të cilëve janë marramendës, kur kujton kontributet e tyre, punën e tyre shkencore. Kontributet dhe puna shkencore e bërë në vitet e jetës së delegatëve të kongresit të drejtshkrimit, më falni, nuk më takon ta them mbase formalisht sepse jam dhe kryeministër i këtij vendi. Është një volum që sikur të mblidhen sot të gjithë doktorët dhe

profesorët e të gjitha llojeve të shkencave të pas rënies së komunizmit, nuk e bëjnë dot jo në gjithë volumet e veta, po as në 1 të 100 e volumeve të veta. Ky është fakt. Kështu që, përtej të gjitha këtyre mbi kryet e Kongresit vazhdon rëndon gjithë kohës si mëkat fakti që u mbajt dhe përfundoi punimet në Tiranën që ishte kryeqyteti i Shqipërisë komuniste. Po pastaj?!

E thotë rezoluta e Kongresit, drejtshkrimi nuk është vetëm një çështje shkencore, por është dhe një problem i rëndësishëm shoqëror sepse shprehjet drejtpërdrejt e njësimi të gjuhës letrare kombëtare, e cila luan një rol të dorës së parë në forcimin e vetëdijes kombëtare dhe zhvillimin e jetës mendore. E padiskutim që jeta jonë mendore do kishte qenë edhe më problem sot.

Imagjinoni sot, imagjinoni sikur tranzicionit shqiptar t'i shtoheshin dhe dialektet dhe ne mos kishim një gjuhë të njësuar. Çfarë do të kishte ndodhur këtu?! Nëse kongresit do t'i çlegjitimej puna vetëm e vetëm se u zhvillua në një regjim absolut, atëherë duhet të çlegjitimej puna e gjitha atyre më parë që nga Kongresi i Manastirit apo nga Komisia letrare, sepse nën pushtet tërësisht absolute janë zhvilluar të gjitha dhe kundërshtarët e rrezikshëm të Kongresit të Drejtshkrimit janë shumë të rrezikshëm se janë dhe injorantë të mëdhenj që fokusohen në këtë pikë. Në fakt, janë ksenomanë që kanë fiksime të tyre më shumë sesa meraqet e mirëfillta gjuhësore që për hir të së vërtetës nuk kanë kulturën që t'i kenë, që të jemi shumë të qartë.

Me siguri Valiu i Manastirit, për shembull, me atë mjekrën e bardhën, me dekoratat, u duket shik edhe e pranojmë pa problem në krahasim me anëtarët e byrosë proletare të partisë shtet ose M. Lamerci i duket më i qytetëruar se gjuhëtarët e komisionit të Kongresit. Mund të jetë edhe kështu, patjetër. Edhe unë figurativisht mes Valiut dhe anëtarit të byrosë politike zgjedh Valiun, direkt. Por vetëm figurativisht, se në përmbajtje janë i njëjti mall.

Në fund të ditës pyetja është e thjeshtë e më falni se po zgjatem pak se nuk e kam dhe zakon të zgjatem siç e dini, po në këtë rast zgjatem se mezi e kam prituri këtë ditë që t'i them disa gjëra duke shfrytëzuar dhe abuzuar dhe postin në këtë rast, se ndryshe nuk do më binte radha se unë vetëm anëtar Akademie s'bëhem dot kurrë se s'kam asnjë gradë shkencore dhe nuk e kërkoj një të tillë, sot që kush nuk ka gradë shkencore i bie të jetë akademiku i vërtetë, nga këta të demokracisë flas.

Të gjitha këto dakord mund të jenë kështu, po a mund të hidhet poshtë puna kolosale që i dha gjuhës shqipe faktikisht aq shumë sa po të mendojmë të kundërtën ne sot nuk do kishim dot një Abetare. Sot edhe Abetaret do t'i kishim si ato tekstet alternative që solli demokracia që në fillim të rrugës ku është njëra shkollë, data e çlirimit është 28 Nëntor, në fund të rrugës ku është

shkolla tjetër, data e çlirimit është 29 Nëntor. Do kishim Abetare që Zoti e di se me çfarë sharrash “do sharronte Shabani”. Po një gjë është e sigurt, do ishin sharra që do sharronin gjatë gjithë kohës trungun e përbashkët që na lidh të gjithëve që është trungu që mbolli Kongresi i Drejtshkrimit.

Imagjinoni pastaj procesin e integritimit, dokumentet. Me çfarë dokumentesh do t'i shkonim. Si do merreshim vesh për të përkthyer në gjuhën e Brukselit 7 palë gjuhët tona se ndërkohë është e sigurtë që demokracia dhe tranzicioni do kishin pjellë dhe gjuhë të tjera se s'do ishin vetëm ato që u diskutuan në '72-shin. Se do kishte dalë gegnishtja e Shkodrës dhe pastaj ajo e Pukës. Do kishte dalë toskërishtja e Vlorës, po do dilte dhe Tepelena. Se këtu duan të bëhen bashki të gjithë, keni parë reforma territoriale.

Ndërkohë që kemi shumë, duhet të jenë më pak. Në '72-shin ka dhe një gjë tjetër pse procesi, mendoj unë, u përsos krahasimisht me 908-tën dhe 15-tën sepse komuniste, komuniste po Shqipëria ishte një vend me institucione kërkimore shkencore. Ku është Instituti i Gjuhës Shqipe sot? Është me siguri është, po fakti që unë nuk e di ku është për shembull, nuk më dënon mua, apo jo. me gjithë respektin që mund të jetë në krye të atij instituti, nuk besoj që kushdo qoftë ai i garanton Eqerem Çabejt dhe atyre të tjerëve një gjumë të qetë në varrezën në dalje të Tiranës, në raport me standardin. E vërteta është që në kohën kur është bërë Kongresi i Drejtshkrimit këto institucione kërkimore dhe kjo botë akademike, jo vetëm që nuk ishte e shpërfillshme, po ishte e standardeve europiane, meqë kemi mësuar këtë togfjalëshin në këtë fazën e re dhe faktikisht në atë kohë dhe me ato kushte, ishte monarkia, ishte diktatura apo do të ishte një republikë liberale, rezultati do të kishte qenë ky për shkak të atyre njerëzve, për shkak të atyre institucioneve dhe për shkak të asaj pune të madhe 20 vjeçare për ta arritur deri në atë pikë.

Që mos zgjatem edhe më shumë dua ta mbyll duke dalë te vetja sepse të gjitha këto janë shumë të rëndësishme, por ajo që sot është, e shikoni sa faqe kam shkruar për këtë punë, ajo që sot është akoma më e rëndësishme, është rreziku që i kërcënohet gjuhës shqipe dhe po e shpreh me fjalët e të ndierit Robert Elsie kur thotë: “Unë vuaj shumë për fjalor se kur lexoj letërsi shqiptare dhe kur has një fjalë që nuk e kuptoj nuk e gjej në fjalorin e akademisë dhe kjo më mërzit shumë”. Fjalori i shqipes zyrtare është vetëm gjysma e gjuhës së vërtetë. Vetëm gjysma e gjuhës së vërtetë ndërkohë që fjalori i shqipes së folur përditë, është një e njëmijta e gjuhës së vërtetë. “klm, pqf, tdsh” e këto. Kështu që, fjalori i gjuhës shqipe, që është një nga nënproduktet e Kongresit të Drejtshkrimit dhe pasuria e tij leksikologjike, frazeologjike, sot janë në pikëpyetje të madhe dhe jam shumë i lumtur që ta shfrytëzoj këtë moment për të thënë që Akademia e Shkencave e ka çelur siparin e drejtshkrimit të fjalorit. E u desh një komunist të krye të

Akademisë së Shkencave që ta rifillonte punën me themel, të themi të vërtetën e mos u shqetësoni fare se çfarë do të thonë mbas këtij fjalimit tim në ditët në vijim anti komunistët që janë trashëgimia më e tmerrshme që na lanë komunistët në fakt. Unë nuk i vë faj Skënderit se ka qenë komunist, unë Skënderit i vë faj se na la Saliun, ne jse se mos ta politizojmë.

Duke folur për fjalorin dua të shpreh urimin, shpresën, dëshirën quajeni si të doni që ne t'ia dalim që ne të kemi një fjalor të ri ashtu sikundër t'ia dalim ta kemi një histori të shqiptarëve çka ka filluar kjo si punë dhe pastaj një enciklopedi, çka ka filluar dhe kjo si punë.

Janë tre libra shumë themelorë që kanë munguar për shumë e shumë vite. Për fat të keq në këto shumë e shumë vite kemi humbur shumë nga ato burime njerëzore që do ishin garanci për cilësinë këtyre tre librave themelorë, por ka ende shprese, ka ende njerëz që mund ta bëjnë këtë, ashtu sikundër barra më e madhe, sfida më e madhe dhe përgjegjësia më e madhe për qeverinë tonë dhe për çdo qeveri shqiptare në vijim, është ajo që preka gjatë gjuhë kohës, jo për të pasur edhe një herë Eqerem Çabej edhe gjithë ata tjerët se kjo është si ambicie, por së paku për të pasur “gardianë” seriozë dhe korrektë, dhe të zotë që ta mbrojnë thesarin që na lanë të gjithë ata që e firmosën rezolutën e Kongresit të Drejtshkrimit që Zoti i pastë në sy në mënyrë shumë të veçantë dhe të gjithë përjetësinë dhe përtej tokësinë e tyre. Faleminderit!

10 nëntor 2022

Lindita Nikolla, Kryetare e Kuvendit

Fjala në 50-vjetorin e Kongresit të Drejtshkrimit,

10 tetor 2022

I nderuar Kryeministër Rama,

I nderuar akademik Skënder Gjinushi, Kryetar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë;

I nderuar akademik Antonio Loprieno, President i ALLEA-s;

I nderuar akademik Mehmet Kraja, Kryetar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës;

Të nderuar kryetarë e përfaqësues të tjerë të akademive simotra, anëtare të ALLEA-s, pjesëmarrëse në këtë konferencë nga vendet e rajonit dhe ato të Europës;

Të nderuar përfaqësues të qeverisë dhe të institucioneve të tjera qendrore, akademikë e profesorë;

Zonja e zotërinj;

Mirë se erdhët në këtë sallë historike, ku gjysmë shekulli më parë u mblodhën themeluesit e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Asambleja e parë e saj, për të përruar një rrugë të gjatë suksesi në shërbim të dijes.

Themelimi i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë shenjon një ndër ngjarjet më të rëndësishme të vendit përgjatë shekullit të 20-të në zhvillimin e tij intelektual dhe shpirtëror.

Pavarësisht se vendimi për themelimin e saj u mor prej instancash politike, 50 vjet të veprimtarisë së Akademisë së Shkencave provuan se ëndrra e dy shekujve të mendimit kombëtar gjeti shprehje tek kjo Akademi dhe kërkimi shkencor elitar u pavarësua prej veprimtarive të tjera, duke përfshirë dhe atë universitare.

Akademia Shkencave e Shqipërisë lindi para së gjithash si një institucion që duhej të përqëndrohej tek çështjet themelore të historisë së popullit shqiptar, të origjinës, etnogjenezës e vazhdimësisë së tij.

Të themeluara prej dijetarësh të huaj qysh në fillim të shekullit XIX: austro-gjermanë, francezë, italianë e britanikë, shkencat shqiptare me objekt botën shqiptare kishin ardhur me vonësë në mjedisin shkencor të vendit.

Akademia e Shkencave ka meritën historike që i ktheu këto dije në shkenca të mirëfillta e serioze, me objekt e qëllim të disiplinuar, me teza të formuluar e konfirmuar me përgjegjësi, me ndërveprim të suksesshëm e të harmonizuar të gjuhësisë, arkeologjisë, historisë, studimeve antropologjike dhe kulturologjike, studimeve për letërsinë dhe arteve.

Për herë të parë albanologjia shqiptare u bë shkollë studimesh e denjë dhe konkurroi me qendrat dhe shkollat e tjera në Perëndim e në Lindje.

Ngjarjet kryesore shkencore të periudhës së parë të jetës së Akademisë së Shkencave, si konferenca kushtuar 110-vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, konferenca ndërkombëtare kushtuar etnogjenezës së popullit shqiptar, konferenca ndërkombëtare kushtuar epikës heroike legjendare, kuvendi i dytë i studimeve ilire, konfirmuan këtë realitet të ri të gjendjes dhe zhvillimit të studimeve shqiptare.

Nëse dhjetëvjetëshi i parë i jetës së Akademisë së Shkencave qe prova e konfirmimit të albanologjisë, dhjetëvjetëshi i dytë u dominua nga fuqizimi i shkencave teknike e natyrore, për të cilat në mënyrë dyshuese thuhej se Shqipëria nuk mund të merrej me shkencë të madhe.

Rrjeti i institucioneve të ngritura pranë Akademisë së Shkencave në shërbim të ekonomisë dha prova suksesi me ndikimin e vet të shumanshëm, prej shkencave të zbatuara në bujqësi e blegtori deri tek ndërtimi i veprave hidrike, që mbajnë sot në eficiencë rrjetin energjetik të vendit.

Rritja e kontributit të Akademisë në zhvillimin e vendit po ecën paralel me ripërtëritjen e saj; me krijimin e strukturave të reja si komisionet e përhershme dhe njësitë kërkimore; rrjetëzimin e kërkimit shkencor dhe rritjen e komunikimit e ndërveprimit me universitetet, studjuesit shqiptarë jashtë vendit dhe albanologët e huaj në qendrat më të rëndësishme për studimet shqiptare; identifikimin e cilësisë shkencore dhe vlerësimin e saj përmes konkurseve, çmimeve e mirënjohjeve; organizimit të veprimtarive shkencore e botuese të cilësisë europiane, si kongreset ndërkombëtare të nanoteknologjisë e bioshkencave; forumeve periodike për probleme jetike si pandemia dhe sizmologjia; kongreset e kuvendet në fushën e albanologjisë etj.

Nismat themelore në botimet albanologjike, të koordinuara edhe me Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës si *Fjalori i madh i gjuhës shqipe*, *Enciklopedia shqiptare* dhe *Historia e shqiptarëve*, janë tashmë një model i bashkëpunimit midis botës akademike dhe qeverisjes.

Sot, pas gjysëm shekulli jete të Akademisë së Shkencave, ne nderojmë e u shprehim mirënjohjen brezave të akademikëve shqiptarë; që e themeluan, rritën, zhvilluan dhe kontribuan e kontribuojnë që Shqipëria të ketë

Akademisë e saj të Shkencave; që Akademia e Shkencave, si një qendër e mendimit shkencor elitar, t'u përgjigjet e paraprijë nevojave të zhvillimit të Shqipërisë e të kombit shqiptar;

Në sinergji e partneritet me akademitë simotra në Evropë e më gjerë të integrojë kontributet shkencore shqiptare në zhvillimet shkencore në botën e sotme dhe t'u hapë rrugë transferimit e zbatimit të arritjeve të shkencës e teknologjisë bashkëkohore në Shqipëri.

Në këtë 50-vjetor ju dhe të gjithë ne jemi kryelartë për të festuar, sepse Akademia e Shkencave ka një vizion e perspektivë të qartë zhvillimi, për sot e për ngamot. Është koha për të menduar e mirëpritur që ju, akademikët dhe elitat intelektuale e universitare shqiptare, të kontribuoni e të ndikoni më shumë në jetën politike e shoqërore të vendit.

Gjysmë shekulli që ka kaluar nga themelimi i Akademisë së Shkencave janë një përvojë e pasur, e cila do të shërbejë edhe si një mbështetje e fuqishme për vijimësinë e kontributeve të Akademisë dhe akademikëve shqiptarë për zhvillimin e vendit, avancimin e thellimin e reformave jo vetëm në fushën e arsimit e të kërkimit shkencor, por edhe reformave demokratizuese dhe integruese të Shqipërisë.

Ju garantoj se mbështetja e Kuvendit të Shqipërisë do të vazhdojë.

Gëzuar 50-vjetorin e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë!

Lindita Nikolla, Kryetare e Kuvendit

Fjala në 110-vjetorin e Shpalljes së Pavarësisë

I nderuar z. Gjinushi, kryetar i Akademisë së Shkencave;

I nderuar z. Mehmet Kraja, kryetar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës;

Shkëlqesi ambasadorë dhe përfaqësues të tjerë të trupit diplomatik;

Akademikë, profesorë, historianë e etnologë; të nderuar të pranishëm;

Shpallja e Pavarësisë është ngjarja më e madhe në historinë shtetërore të popullit shqiptar.

Shtetformimi, që ishte dukuria më progresive në shekujt e humanizmit europian edhe në botën e Arbërit mesjetar, u ndërpre prej sundimit teokratik të një perandorie të superfuqishme, por me një sistem politik e shoqëror të tejkaluar.

Elita politike që ishte vetëdijësuar se edhe në Shqipëri duhej të ndodhte shkëputja e pavarësimi njësoj si në Greqi e në vendet e tjera fqinje u masakrua në Manastir dhe mëvetësia e shqiptarëve u vonua edhe gati një shekull.

Ideologjia shqiptare lindi për herë të parë tek arbëreshët e arvanitët, që ishin më të lirë dhe i paraprinë Rilindjes kombëtare.

Me shpalljen e Pavarësisë Shqipëria nuk u bë siç e donin atdhetarët, por pa atë Shqipëri të vogël shtetërore, që shpesh e quajnë *Shqipëri londineze*, statusi i shqiptarëve sot, në shekullin e fatit e të mbarësisë së tyre, nuk mund të përfytyrohej.

Në 110 vjet Shqipëria e ka provuar të gjitha: ksenokracinë në formën e principatës së trashëgueshme; regjencën e parë në formën e këshillit të shtetit; lulëzimin e parlamentarizmit në vitet 1920-1924; republikën e parë formale; monarkinë e vetëshpallur; qeverisjen e dalë nga lufta antifashiste; republikën e dytë gjithaq formale; deri tek demokracia e luhatur pluraliste.

E provuar me të gjitha këto alternime, që nuk ndjekin kronologjinë logjike të sistemeve politike, Shqipëria ia doli të ruajë vetveten përmbi paqendrueshmërinë; ia doli të fitojë subjektivitetin e denjë ndërkombëtar dhe sot të nxitojë drejt federatës europiane të popujve.

Në këtë rrugë do të na duhet të lemë diçka peng nga pavarësia tradicionale, sepse është epoka e interdipendencës, por ne do të fitojmë dinjitet me identitetin tonë të papërsëritshëm, që është pasuri europiane.

Ne përshëndesim nismat e Akademisë së Shkencave për hartimin e disa veprave themelore në albanologji, sidomos hartimin e një historie kombëtare të gjithëmbarshme të shqiptarëve, që do të ndriçojë qartazi edhe disa nyja të rëndësishme të historisë shtetërore. Kjo histori duhet të ketë karakter integrues dhe duhet të përurojë vlerat më të përveçme të identitetit shqiptar.

Le të na nxisin këto vlera për progres më të shpejtë në rrugën tonë europiane; po aq edhe për integrim brenda nesh, për ato çështje bazike që kanë nevojë për konventa kombëtare.

Faleminderit për vëmendjen.

Tiranë, 23 nëntor 2022

Albin Kurti, Kryeministër i Kosovës

Fjala në 50-vjetorin e Kongresit të Drejtshkrimit

10 nëntor 2022

Ndihem me fat dhe jam fort i nderuar që mund t’iu drejtohem në këtë konferencë jubilarë të 50-vjetorit të Kongresit të Drejtshkrimit të gjuhës shqipe. Dhe më vjen keq që m’u desh të udhëtoj për Paris e nuk mund të jem me juve fizikisht në Tiranë.

Gjuha për ne shqiptarët është themel identitar dhe jo thjesht mjet komunikimi. Historia e standardizimit të gjuhës shqipe është e ndërlidhur ngushtë me historinë e ndërgjegjësimit tonë kombëtar, prandaj fazat e ndryshme të procesit të kristalizimit të shqipes së shkruar janë, në të njëjtën kohë, edhe faza të kristalizimit të kësaj ndërgjegjeje. Synimi drejt njësimimit të gjuhës së shkruar, për shqiptarët, u kthye në një program që do të mundësonte edhe njësimin politik kombëtar. Kjo ishte arsyeja që për të gjithë letrarët shqiptarë, e sidomos për ata që nga Rilindja e këndej, ideja e shqipes së përbashkët u bë projekti kryesor atdhetar. Por, rruga drejt sendërtimit të këtij synimi nuk ishte e lehtë. U desh shumë mund, punë, përkushtim dhe jo rrallë edhe flijim, në mënyrë që shqipja të mbijetonte: të shkruhej, të mësohej e të kultivohej.

Dihet që standardizimi i një gjuhe nënkupton punën në reduktimin e varianteve gjuhësore në një varietet standard. Dhe historia e standardizimeve në botë tregon jo vetëm një larmi të madhe në mënyrën e përzgjedhjes së normës e të kodifikimit, por edhe implikime të pashmangshme politike në këtë proces. Një nga këto implikime është se përzgjedhja e një standardi gjuhësor ndikon thellë në kohezionin politik kombëtar.

Pikërisht në kohën kur nisi debati për krijimin e një gjuhe të përbashkët letrare shqipe, – siç quhej atëherë, – në fund të shek. 19, rrethanat shoqërore e politike u rënduan shumë. Shqiptarët vërtet ishin nën sundimin e një pushteti monocentrik administrativ e politik, nën Perandorinë Otomane, por kishin një gjendje policentrike gjuhësore. Shqipja jo vetëm që nuk ishte gjuhë zyrtare në këtë kohë, por ishte edhe e ndaluar. Dhe, kur Shqipëria shpalli pavarësinë, më 1912, shqiptarët kaluan në një policentrizëm administrativ e politik, – ngaqë gjysma e tyre ra nën sundimin e disa shteteve fqinje, ku

shqipja mbeti prapë e ndaluar – në një mundësi planifikimi drejt një monocentrizmi gjuhësor.

Hapi i parë i rëndësishëm ndodhi me organizimin e Kongresit të Manastirit, më 1908, ku u miratua alfabeti i shqipes. Por, puna e mirëfilltë e planifikimit të një gjuhe standarde shqipe nisi me themelimin e Komisionit Letraro Shqipe, në Shkodër e cila punoi gjatë viteve 1916-18, e udhëhequr nga Gjergj Pekmezi dhe Luigj Gurakuqi.

Është e vërtetë që brenda gjuhës shqipe, për shekuj me radhë, ishin zhvilluar tri gjuhë letrare, gegërishtja letrare, toskërishtja letrare dhe arbërishtja letrare, por rrethanat politike për shqiptarët ishin aq të ndera, aq të pafavorshme, sa dukej e pamundur që shqiptarët të përballonin edhe policentrizmin e pafavorshëm politik, edhe policentrizmin përçarës gjuhësor.

Kur Komisioni Letraro Shqipe vendosi për bazë të gjuhës standarde të folmen e elbasanishtes, më e rëndësishme se cila e folme u mor për bazë, ishte krijimi i një ndjenje përbashkuese dhe ambientimi i shqiptarëve me idenë se si do të dukej në praktikë një gjuhë e vetme standarde për të gjithë, duke qenë se kjo nuk ishte provuar asnjëherë më parë. Në këtë pikë projekti i *Komisionit Letraro Shqipe* doli i suksesshëm. Edhe kur pas Luftës së Dytë Botërore u ndërrua baza e gjuhës standarde, shumë nga vendimet e kësaj «Komisioni» mbetën të ngulitura në themelet e kësaj gjuhe standarde, sepse, prapëseprapë, bëhej fjalë për rregullat e gjuhës shqipe.

Në këtë proces destandardizimi e standardizimi, që në shikim të parë mund të duket si ndërhyrje e ashpër e autoritetit shtetëror, po të shikohet nga këndvështrimi i sotëm, do të kuptohet se pati efekte të pamohueshme pozitive, sepse shkaktoi trazimin, përzierjen e dy gjuhëve kryesore letrare, të gegërishtes e të toskërishtes, në mënyrë shumë më të fuqishme sesa që do të mund të ndodhte kjo në çfarëdo mënyre tjetër. Por kjo ishte ajo që ndodhte në planin e brendshëm, në Shqipëri.

Në planin e jashtëm periudha pas Luftës së Dytë Botërore paraqiti një nga fazat tejet të rënda e shumë sfiduese në fushën e planifikimit të gjuhës së përbashkët shqipe. Ndarja e ashpër politike në disa shtete, pamundësia e komunikimit normal ndërshqiptar për disa dekada dhe funksionimi i shqipes si një gjuhë standarde në Shqipëri me një bazë, e si gjuhë standarde me një bazë tjetër në trojet shqiptare në ish-Jugosllavi, do të mund të çonte drejt një ndarjeje kombëtare të pakthyeshme edhe politike, edhe kulturore.

Për fat të mirë, gjuha shqipe ia doli të tejkalojë edhe këtë ndarje të mundshme të thellë politike dhe të arrijë synimin që pati nisur që nga rilindësit: vendosjen e një gjuhe standarde shqipe. Kjo u kurorëzua me nënshkrimin e 87 delegatëve të Rezolutës së Kongresit të Drejtshkrimit të

Gjuhës Shqipe në vitin 1972, që kishte qenë një ëndërr e të gjithë veprimtarëve tanë për shekuj me radhë.

Duke u nisur nga këto fakte, Kongresi i Drejtshkrimit i vitit 1972, 50-vjetorin e të cilit po e kremtojmë tani, nuk pati vetëm rëndësinë gjuhësore, por po aq, – në mos edhe më shumë, – rëndësinë politike. Sepse, ashtu si shumë herë në historinë tonë, veprimet dhe vendimet rreth gjuhës shqipe i paraprinë veprimeve dhe vendimeve politike.

Ky Kongres ishte jo vetëm vazhdim i përkushtimit të rilindësve, i punës së Komisionit Letraro Shqipe, por edhe një kurorëzim i gjithë atyre përpjekjeve shekullore për një shqipe të përbashkët.

Gjuha letrare apo shqipja standarde nuk duhet konceptuar si e ngurtë, ajo ka nevojë të reformohet për t'i ardhur më pranë mënyrës së si flitet e shkruhet shqipja sot, por edhe reformimi ka si parakusht përvetësimin masiv të gjuhës letrare përmes arsimit publik dhe mediave. Përndryshe, në kushtet kur edhe ata që mbarojnë arsimin universitar bëjnë gabime gjatë shkrimit të shqipes letrare, çdo reformim i kësaj të fundit më shumë do të prishte punë se sa do të ndreqte.

Shqipja letrare por edhe shqipja e folur në larminë e saj ndodhen para sfidave të komunikimeve onlajn e të rrjeteve sociale. Institucionet shkencore dhe mediatike të studiojnë rreziqet dhe mundësitë që teknologjia e informacionit paraqesin për shqipen dhe të hartohen projekte, edhe me pjesëmarrjen e sipërmarrjes private për aplikacione që nevojiten (p.sh. fjalorë onlajn për gjuhën letrare, apo për lëmi të ndryshme, korrektues letrar etj.).

Pavarësisht përdorimit të teknologjisë së informacionit, librit mbetet formati më i mirë për formimin, ruajtjen dhe përcjelljen e dijes në gjuhën shqipe. Kosova dhe Shqipëria në kuadër të njësisimit të politikave dhe institucioneve të trajtojnë me përparësi çështjen e shpërndarjes së librit shqip, pasurimit dhe themelimit të bibliotekave, digjitalizimit të librave etj. Sidomos manualët për përdorimin e saktë të shqipes letrare apo aplikacione për këtë qëllim të ofrohen falas përmes platformave elektronike të bibliotekave apo të institucioneve të tjera.

Duke qenë se jeta e gjuhës shqipe është kaq shumë e ndërthurur me fatet politike të kombit tonë, puna për kristalizimin e mëtutjeshëm të saj duhet të vazhdojë me të njëjtin zell e me të njëjtin përkushtim edhe nga brezat e rinj. Vetëm kështu gjuha shqipe do të mund t'u bëjë ballë sfidave që e presin në të ardhmen. Në këtë punë, doemos, mjafton të ndiqet këshilla e Profesorit mendjendritur, Eqrem Çabej, i cili kumtesën e tij në Kongresin e Drejtshkrimit e përfundoi me këto fjalë:

[Gjuhëtarët] do të udhëhiqen nga një ndjenjë e lartë përgjegjësie. Në formulim të çdo rregulle do të jetë e pranishme vetëdija që është puna për një drejtshkrim të caktuar jo për disa mijë veta, po për katër milionë njerëz që e kanë shqipen gjuhë amtare.

Katër milionë shqiptarët e asaj kohe ishin shqiptarët e të gjitha trojeve. Sot, këta shqiptarë, janë shtuar edhe për disa milionë të tjerë, kështu që përgjegjësia jonë duhet të jetë edhe më e madhe, përkushtimi ynë edhe më i thellë.

Faleminderit!

Tiranë, 10 nëntor 2022

Artan Grubi, Zëvendëskryeministër i parë në Qeverinë e Maqedonisë së Veriut

Fjala në 50-vjetorin e Kongresit të Drejtshkrimit

10 nëntor 2022

Kënaqësi e veçantë të marr pjesë në një konferencë të tillë jubilarë mbi unifikimin e gjuhës tonë.

Unifikimi i gjuhës shqipe ishte i rëndësishëm jetike edhe për shqiptarët e Maqedonisë së Veriut, sepse u vendos si standard i përgjithshëm i përdorimit që vllente edhe për ne.

Në këtë fushë sigurisht që do të flasim më shumë ekspertët e nderuar që janë këtu me ne.

Unë dua të them disa fjalë nga aspekti i përdorimit zyrtar të gjuhës sonë amtare në Maqedoninë e Veriut.

Tek ne, gjuha shqipe ka rëndësi do të thosha dydimensionale: i pari është dimension i kulturor e shpirtëror pasi që kjo gjuhë flitet nga mbi 30 për qind e popullsisë në mënyrë aktive; dimension i dytë është ai shoqëroro-politik, pasi që gjuha shqipe është zyrtare në nivel lokal e qendror.

Në institucionet publike fillohet nga çerdhet, shkollat fillore dhe ato të mesme, duke vazhduar me tre universitete, dy nga të cilët janë shtetërore dhe njëri publiko privat dhe natyrisht edhe në disa nga universitetet private të cilat ofrojnë mësim edhe në gjuhën shqipe.

Me ndryshimet e fundit të ligjit të gjuhëve, gjuha shqipe vihet në përdorim të plotë zyrtar në të gjitha nivelet, përfshirë Presidencën, Kuvendin dhe Qeverinë.

Televizioni dhe radio shtetërore emetojnë program 24 orë në ditë vetëm në gjuhën shqipe, ndërsa gjuha jonë përdoret edhe në dokumentet e identifikimit, proceset zgjedhore, pushtetin gjyqësor e kështu me radhë.

Kemi formuar edhe institucione që kujdesen për zbatimin e gjuhës shqipe, siç është Agjencia për Zbatimin e Gjuhëve, Inspektorati shtetëror i Gjuhës si dhe Instituti për Trashëgimi Shpirtërore dhe Kulturor të Shqiptarëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Jemi me fat sepse kemi një veçanti nga të gjitha trojet tjera shqiptare, nga Lidhja e Prizrenit, tek Kongresi i Manastirit dhe deri te pavarësia e Vlorës. Në këtë mënyrë Maqedonia e Veriut vendoset në hartën e tre ngjarjeve më të rëndësishme historike kombëtare.

Dua të theksoj që në Manastir kemi ngritur një institucion kombëtar, Muzeun e Shtëpisë e Alfabetit që financohet nga buxheti i shtetit. Tek ne, 22 nëntori është ditë feste shtetërore si dhe ndajmë çmim shtetëror Kongresi i Manastirit.

Në fund, dua të falënderoj Presidentin Begaj e Akademinë për organizimin e këtij eventit shumë të rëndësishëm dhe ju uroj punë të mbarë.

Tiranë, 10 nëntor 2022

Evis Kushi, Ministër i Arsimit dhe Sportit

Fjala në 50-vjetorin e Kongresit të Drejtshkrimit

10 nëntor 2022

Akademia e Shkencave ka qenë një ëndërr shekullore e mendjeve të ndritura të popullit shqiptar.

Për herë të parë në Shqipëri fjala “Akademi” u përmend kur u krijua në Voskopojë e ashtuquajtura “Akademia e Re” më vitin 1750, e cila ishte një shkollë e mesme, por që shërbente edhe si një qendër kulturore e mirënjohur brenda dhe jashtë vendit.

Më vonë, rilindësi ynë i madh Sami Frashëri në veprën e tij fliste për akademinë dhe universitetin si një ëndërr e vështirë për t’u realizuar, por që doemos duhej të kthehej në realitet. Dhe vërtetë, në 10 tetor 1972, themelimi i Akademisë së Shkencave u bë realitet nga rrjeti i institucioneve kërkimore shkencore në vend.

Konkretisht 10 institute shkencore dhe 5 qendra studimore kërkimore.

Disa nga fjalët e para të shqiptuara në mbledhjen e parë të Asamblesë më 25 janar 1973 nga kryetari i parë i saj Aleks Buda ishin këto:

Në jetën e popujve ka ngjarje të cilat si gur caku shënojnë rrugën e zhvillimit historik të tyre. Të tillë domethënie ka edhe krijimi i ASH. Ç’rrugë të gjatë dhe të mundimshme duhet të kalonte, ç’luftë të madhe e këmbëngulëse u desh që të bënte ky popull i lashtë, për të krijuar e zhvilluar në tokën e vet kulturën e tij kombëtare.

E përgjatë viteve, të gjithë jemi dëshmitarë të faktit se, pavarësisht vështirësive të tranzicionit, e përtej dilemave për pozicionin e saj të ri në shoqëri, Akademia e Shkencave arriti të reformohej dhe sot po përshtatet me trendet e zhvillimit të shoqërisë.

Prandaj, në këtë përvjetor, e jo vetëm sot por çdo ditë, u jemi thellësisht mirënjohës akademikëve shqiptarë ndër vite, e veçanërisht kontributit të kryetarëve të kësaj Akademie ndër vite, akademikët Aleks Buda, Shaban Demiraj, Ylli Popa, Teki Biçoku, Gudar Beqiraj, Muzafer Korkuti dhe sigurisht kryetari aktual Skënder Gjinushi.

Sot Akademia e Shkencave është institucioni më i rëndësishëm për shkencën dhe dijen në vend.

Ku vlen të përmendim disa kongrese e konferenca, të cilat janë dëshmi e konsolidimit të këtij institucioni në fushën e albanologjisë, Nanoteknologjisë, Bioshkencës, Sizmologjisë madje dhe të pandeminë.

Në mënyrë të veçantë, sot dua të theksoj që kjo Akademi nuk e harroi për asnjë moment qendrën tjetër të shqiptarisë në rajon, Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, me të cilën ka pasur një bashkëpunim të ngushtë, jo vetëm në organizimin e kuvendeve dhe kongreseve për çështje të cilat janë gurë themeli në historinë e akademizmit shqiptar, por edhe projektet e mëdha të përbashkëta, siç është *Historia e shqiptarëve*, *Enciklopedia shqiptare* dhe *Fjalori i madh i shqipes*.

E ndërkohë, Akademia e Shkencave ka nxitur dhe intensifikuar bashkëpunimin me organizata të ndryshme ndërkombëtare duke patur marrëveshje bashkëpunimi me mbi 50 akademi simotra në janë anëtare në federatën më të madhe akademike europiane ALLEA.

Madje tani po lexoja librin e botuar me rastin e 50-vjetorit të themelimit të Akademisë së Shkencave, ku presidenti i Federatës Europiane të Akademive të Shkencave dhe Shkencave Humane z. Antonio Loprieno, thekson punën dhe kontributin e kësaj Akademie. Konkretisht z. Loprieno thekson: Akademia e Shkencave duhet të jetë krenare për arritjet e saj, në promovimin e vlerave themelore të shkencës, paanshmërinë, racionalitetin, ekselencën shkencore, pavarësinë por edhe dialogun me mbarë shoqërinë.

Në cilësinë e Ministres se Arsimit, unë dua të vlerësojë bashkëpunimin aktual me Akademinë e Shkencave. Aktualisht ne po punojmë fort për Ligjin i ri për shkencën, i cili do të luajë një rol të rëndësishëm në transformimin rrënjësor të sistemit të dijes në vend, nisur nga nevoja për t'ju përshtatur sa më mirë sfidave bashkëkohore.

Një falënderim shumë të veçantë për prof. dr. Skënder Gjinushin, për kontributin e tij në reformimin dhe transformimin e këtij institucioni, gjë e cila doli në pah edhe në konferencën e fundit të Nanoteknologjisë që u mbajt këtu në Shqipëri.

Shumë faleminderit të gjithëve dhe punë të mbarë!

Mehmet Kraja, Kryetar i ASHAK

Fjala në 50-vjetorin e Kongresit të Drejtshkrimit

I. Në Tiranë, 10 nëntor 2022

Të nderuar miq, akademikë, dinjitarë të gjuhës shqipe, zoti President, Kryeministër!

Më lejoni të them që në fillim, se unë i takoj asaj gjenerate, e cila e ka njohur dhe e ka përjetuar gjuhën letrare shqipe në të gjithë përbërësit e saj: idealizmin, entuziazmin, ndonjëherë dilemat dhe skepticizmin, më pas përpjekje agresive për ta reviduar standardin, për ta përdorur paskajoren si “mea culpa” për të gjitha dështimet.

Sot, duke qenë shkrimtar që i përkulet gjuhës shqipe si më të madhes vlerë që kemi, ju them pa asnjë mëdyshje se gjuha letrare shqipe nuk më ka zhgënjyer asnjëherë, as me kuptimet e bartura të fjalëve, as me të kryerën e tejshkuar ose me paskajoren e foljeve dhe as me hijeshinë sintaksore që marrin fjalitë e bashkërenditura ose nënrenditura në një frazë shumëkuptimore.

I lexoj dhe i shijoj po me aq ëndje Mjedën dhe Fishtën, Naimin dhe Çajupin, Koliqin dhe Kutelin.

Gjuha letrare shqipe iu ka shërbyer mrekullisht të gjithë shkrimtarëve të mirë, më pak iu ka shërbyer shkrimtarëve mesatarë dhe pak ose aspak iu ka shërbyer shkrimtarëve të pazot, të cilët edhe sot vazhdojnë ta fajësojnë gjuhën letrare për dështimet eventuale në fushë të krijimtarisë dhe të dijes. Skepticizmi i tyre nuk ka të bëjë me mundësitë e gjuhës, por me mungesat e tyre në fushën e dijes dhe të njohjes.

Përtej këtyre observimeve personale, më lejoni të them se në Kosovë gjuha letrare shqipe dhe standardi, gjatë këtyre njëzet vjetëve kanë njohur zhvillime pozitive: tashmë ka ndodhur dhe po vazhdon një proces i gjatë dhe i vështirë i desallvizimit, si dhe i kthimit të gjuhës shqipe nga gjuhë e dytë në gjuhë të përdorimit të gjerë shtetëror dhe institucional.

Por në këtë drejtim ne kemi ende shumë punë për të bërë, sepse Kosova përveç shtetit politik, gjeografik, shtetin juridik, diplomatik, administrativ, ushtarak, e ka të nevojshme të bëjë edhe shtetin gjuhësor. Ky është një proces i vështirë, që duhet të fillojë nga Kushtetuta e Kosovës, e cila, e miratuar nën trysni të mëdha, bën diskriminim gjuhësor, duke vendosur në pozitë të

barabartë gjuhën e 95 për qind të folësve me gjuhën e 5 për qind të folësve të Kosovës.

Së fundi më lejoni të them se shtetet tona nuk kanë nevojë të bëjë politika të mbrojtjes së gjuhës nga folësit e saj, madje edhe nëse ata ndonjëherë ndodh të abuzojnë me gjuhën dhe nuk janë në të drejtën e Zotit për me e përdorë gjuhën me dinjitet dhe nder, por shteti ka nevojë të bëjë politika të mbrojtjes së gjuhës nga braktisja e folësve të saj.

Ju faleminderit për vëmendjen!

II. Në Prishtinë, më 17 nëntor 2022

Të nderuar miq, akademikë, dhe të tjerë të pranishëm!

Shumica që jemi këtu, i takojmë gjeneratës së idealistëve, të cilët gjuhën letrare shqipe e kanë konsideruar dhe vazhdojnë ta konsiderojnë si më të madhen vlerë, e cila krijon njësinë tonë kombëtare të unitetit dhe identitetit. Kombi ynë është komb gjuhësor, para së gjithash!

Ky idealizëm i gjeneratave tona ka qenë i pranishëm gjerësisht në Kosovë dhe të paktë kanë qenë ata që gjuhën letrare shqipe nuk e kanë konsideruar si parashenjë jo aq e largët e një kombi të bashkuar.

Ishte ky një idealitet, që kushtëzoi për një kohë të gjatë entuziazmin e zbatimit të standardit në rrethana të vështira gjuhësore për Kosovën, kur gjuha shqipe ishte gjuhë e dytë, në një shtet që i diskriminonte gjerësisht folësit e saj.

Natyrisht, vështirësitë me të cilat është përballur Kosova në zbatimin e standardit, vështirësi shtesë, kanë qenë të mëdha dhe kjo, herë pas here, e ka dvarë entuziazmin e orëve të para, prandaj ka qenë e natyrshme që të shfaqeshin dilema dhe skepticizma: po vihej në përdorim një gjuhë letrare, me të cilën Kosova nuk ishte familjarizuar ende.

Ky lloj skepticizmi ndonjëherë shpërqendroi vëmendjen e folësve dhe të shkruesve të gjuhës, por edhe të gjuhëtarëve herë pas here, të cilët sikur i shpërndërruan kauzat: e konsideruan më të rëndësishëm revidimin e standardit se vetë standardin; më të rëndësishme mbështetjen e “skizmës gjuhësore” sesa vetë kodit që i referoheshin.

Pra, dua të them se mund të ketë pasur dhe mund të ketë akoma përpjekje agresive për ta reviduar standardin, për ta përdorur faktin që toskërishtja

është vendosur në bazë të standardit dhe për ta përdorur paskajoren si “mea culpa” për të gjitha dështimet.

Në Kosovë ka pasur dhe ka akoma shkrimtarë që nuk e kanë njohur në masën e mjaftueshme gjuhën letrare shqipe, siç ka në Shqipëri shkrimtarë, folës dhe shkruer publikë që e kanë skematizuar gjuhën letrare, duke e privuar atë nga abstraksioni dhe depërtimet meditative. Por kjo nuk ka qenë dhe nuk është as sot arsye që letërsia jonë shqipe të mos e çojë njësinë e gjuhës së unifikuar përtej skemës recidiviste të mohimit dhe refuzimit të ndërsjellë. Jemi popull i vogël dhe nuk bëjmë dot dy letërsi, dy gjuhë, pavarësisht se kemi arritur të bëjmë dy shtete. Nuk kemi pse ta bëjmë gjuhën dhe letërsinë po aq të vështirës, siç e bëjmë politikën dhe historinë e saj.

Luigj Gurakuqi, në një çast të vështirë të jetës së tij, e kishte shqiptuar një mesazh me këto fjalë: Me kenë me pasë me mujt me shku me i thanë me ardhë me m’pa!

Mbase sot mund të themi (me mënyrën e tij) diçka ngjashëm: Me kjenë me pasë mujt me iu thanë do miqve tonë a kishit mujt me na lanë me folë e me shkruer gjuhën tonë ashtu si na vjen ma mirë dhe ma mbarë, pa i fut gverret dhe inatet e veta gjithsecili!

Ju faleminderit për vëmendjen!

Joseph Brian, albanolog

Fjala në ditën e dorëzimit të diplomës së anëtarit të nderit, 4 nëntor 2022

Të nderuarve kolegë të mi të rinj,

Jam thellësisht i nderuar që jam emëruar anëtar nderi i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, duke njohur kërkimet e mia në historinë dhe strukturën e gjuhës shqipe përgjatë disa dhjetëvjeçarëve të fundit.

Për mua, t'i bashkohem radhës së shkencëtarëve të shkëlqyer që përfaqësojnë Akademinë, e ndër ta albanologëve më të shquar, është një njohje që as do të mund ta kisha ëndërruar para më se dyzetë vjetësh, kur iu futa studimit të shqipes si një mënyrë për të zgjeruar kuptimin tim për gjuhët ballkanike dhe për konvergencën gjuhësore që ato shfaqin.

Meqenëse në studimin e Ballkanit arrita më së shumti nga një perspektivë greke, për shkak të përgatitjes sime si helenist, kur u ndërjegjësova për veçoritë mahnitëse që mund të shihen në gjuhën shqipe, vetëm atëherë fillova të çmoj plotësisht kompleksitetin e kontaktit gjuhësor në këtë pjesë të globit.

Në shumë mënyra, Ballkani dhe pozita e shqipes japin një mësim për hulumtimin shkencor të gjuhës dhe të historisë së saj. Kontaktet intensive mes popujsh të ndryshëm në këtë rajon kanë çuar në përdorimin e përbashkët të strukturëve dhe fjalëve, duke treguar se, edhe nëse Ballkani është një vatër tensionesh etnike, jo gjithmonë kontaktet kanë çuar në konflikte midis grupeve të përfshira. Në të vërtetë, përfundimi i kontakteve në Ballkan, nga këndvështrimi gjuhësor, është më shumë çështje bashkëjetese paqësore, sesa konflikti dhe grindjeje.

Më lejoni të përmend këtu disa nga karakteristikat e shumta të shqipes që janë dëshmi e këtij kontakti dhe rezultojnë nga ai, p.sh., përdorimi pleonastik i një përemri së bashku me një objekt (si në “E pashë Gjonin” ose “I dha Gjonit” një libër), përdorimi i një forme të foljes të “dua” në kohën e ardhme (si në Do të vij nesër), frazat jopersonale si “Më hahet” ose “Më pihet”, përdorimi i shënjesit mohues mos si thënie ndaluese me një fjalë, pozicionimi i artikullit të caktuar (pozicioni i dytë në togfjalëshin emëror, si në libri interesant/ interesant-i libër, ndër shumë të tjera.

Megjithatë, disa veçori në shqipen janë pjesë e trashëgimisë së saj nga proto-indo-evropianishtja, dhe janë në shqip, sepse gjuha është anëtare e familjes së gjuhëve indo-evropiane, për shembull, dallimi në mohim midis “s” për indikativ dhe “mos” për joindikativ, trajta e paskajores gegërisht (që përfshin pjesoren me “-në”, si p.sh. thënë), dhe numri i madh i foljeve me

dallime në formë dhe në rrënjë midis së tashmes dhe së shkuarës, p.sh. jep / dhashë, sheh / pa, etj.

Dhe janë disa veçori të pazakonta dhe të papritura nga këndvështrimi i gjuhës njerëzore në përgjithësi, si p.sh. parafjalët që kërkojnë emëroren për formën rasore (do me thënë “tek” dhe “nga”), ose dukje e një elementi të veçantë që lidh emrat me mbiemrat ose emrat me pronorët (si në “libri i madh i Gjonit”, “librin e Gjonit”).

Këto veçori tregojnë se shqipja kontribuon në njohuritë gjuhësore në tri mënyra:

- si gjuhë indo-evropiane, shqipja shton njohuritë tona për mënyrën sesi u zhvillua familja gjuhësore dhe cila ishte forma e gjuhës mëmë
- si gjuhë ballkanike, ajo shton njohuritë tona se sa kontakti gjuhësor mund të ndikojë në një gjuhë dhe llojet e ndryshimeve që mund të ndodhin në situata me kontakte intensiv midis folësve të gjuhëve të ndryshme
- si gjuhë njerëzore, ofron material, nga i cili përcaktojmë gamën e strukturave të mundshme dhe gamën e kombinimeve të veçorive që mund të gjenden në gjuhët njerëzore.

Në të njëjtën mënyrë, shqipja na tregon ndërveprimin midis vazhdimësisë historike dhe ndryshimit në kohë.

Në këtë drejtim, më lejoni të përmend dy raste nga puna ime që përfshijnë semantikën leksikore, ku shqipja tregon vazhdimësi nga njëra anë dhe ndryshim nga ana tjetër.

Së pari, shqipja vazhdon një metaforë të vjetër në mohim në parashtesën negative “as-”, si në “asgjë” ose “askush”, sepse rrjedh nga fraza negative proto-indo-evropiane *ne H2oyu kwid, ku *H2oyu është fjala për ‘jetën e gjatë’, si anglishtja bisedore “Not on your life!” si një mohim i theksuar.

Lidhja e ‘jetës së gjatë’ me mohimin vazhdon në shqipe tani përmes paralelizmit strukturor të dy shprehjeve: shprehja e parë është “kurrën e kurrës”, d.m.th. “kurrë fare”; “jo në një milion vjet”, si një frazë e theksuar negative e bazuar në kurrë, e cila fjalë për fjalë është ndajfolja kurrë, trajtuar si emër dhe shfaqet si kallëzore dhe më pas përsëritet si gjinore, d.m.th. kurrë.kallëzor e një kurrë.gjinor, dhe shprehja e dytë është për (në) jetë të jetëve ‘për përjetësi’, d.m.th. fjalë për fjalë “për (një) jetë(gjatësi) jetese”, me leksemën jetë të përsëritur në raste të ndryshme, fillimisht kallëzore (njëjës) e më pas gjinore (shumësi).

Është e rëndësishme që fjala shqipe “jetë” është argumentuar (nga Eric Hamp) se është zhvilluar nën ndikimin e latinishtes aetas “moshë”; domethënë, nëpërmjet këtyre efekteve të kontaktit, jeta i përket familjes

leksikore të *H2oyu, përderisa aetas lidhet me aevus ‘periudha kohore’, një derivat i fjalës për ‘jetë e gjatë’. Metafora vazhdon dhe kemi paralelizma strukturore në këto fraza që theksojnë lidhjen.

Së dyti, në përdorimin e foljes “bie” në shprehjet e motit, “bie shi” / “bie (dë)borë”, vështrojmë një kuptim krejt të natyrshëm, pasi ‘shiu’ dhe ‘bora’ bien nga qielli. Por nga pikëpamja etimologjike, situata është më e komplikuar, pasi bie rrjedh nga rrënja *bher-, që do të thotë ‘mbart’. Pra, ka pasur këtu një ndryshim semantik nga “mbart” në “rënie” që duhet shpjeguar.

Unë sugjeroj se ishin pikërisht këto shprehje të motit që dhanë bazën për këtë ndryshim semantik, pasi fillimisht idioma ishte se diçka - me sa duket një re - mbart shi/borë; një ndryshim në diatezën verbale do të kishte dhënë ‘bartë shiu/bora’ (d.m.th. ‘mbartet’, nga një re), dhe interpretimi natyror do të ishte se shiu ose bora bën atë që bën shiu ose bora, domethënë bien nga reja. Pra, konteksti i shprehjes së motit ofron një bazë për të kuptuar se si “bartja” mund të ndryshojë në “rënie”.

Të gjithë këta shembuj ofrojnë dëshminë për mënyrat sesi shqipja pasuron të kuptuarit tonë për aspekte të ndryshme të gjuhës njerëzore – në raport me gjuhët e tjera dhe në vetvete – dhe tregojnë se gjuha ka ardhur në vazhdimësi me të kaluarën, por edhe me risi, duke shfaqur drejtime të reja. Në këtë mënyrë, ne nxjerrim një mësim të rëndësishëm nga gjuha shqipe, mësim që vlen për të gjitha institucionet njerëzore.

Siç e përmenda, karrierën time e nisa duke u fokusuar në greqishten dhe ndërsa studimi i greqishtes më ka çuar natyrshëm në studimin e shqipes. Meqenëse të dyja janë gjuhë ballkanike, gjithnjë e gjej veten vetvetiu të tërhequr veçanërisht në botën magjepsëse të historisë dhe të analizës strukturore të shqipes.

Në përgjithësi, për mua, ka qenë një kënaqësi që kam qenë në gjendje të ofrojë njëfarë ndriçimi mbi gjuhën shqipe dhe të tregojë se si ajo ofron një pasqyrë në fenomene më të përgjithshme të gjuhës njerëzore.

Dhe të njihem nga Akademia për kontributet e mia është përtej asaj që mund të kisha shpresuar ndonjëherë.

Ndërsa nga njëra anë ky është një nderim personal, nga një anë tjetër më e rëndësishme, ai ka domethënie të madhe për studimet shqiptare në përgjithësi në Shtetet e Bashkuara. Shqipja, si gjuhë nuk ka tërhequr asnjëherë vëmendjen e plotë të gjuhëtarëve amerikanë, pavarësisht shumë veçorive të saj interesante. Megjithatë, ka një traditë të vogël, por të fortë të studimeve shqiptare dhe unë jam i lumtur që kam luajtur një rol sado të vogël, duke ndihmuar për ta mbajtur gjallë dhe madje për ta lulëzuar atë.

Tash në dhjetëvjeçarin e fundit kam udhëhequr disa diploma studentësh të programit master dhe atij doktoral, të cilët kanë punuar me mua në çështje që lidhen me gjuhësinë shqiptare. Me njohjen më të madhe që më jep anëtarësimi në Akademi, mund të shpresoj që të rritet numri i studentëve në vitet e ardhshme. Në këtë kuptim, të qenët tim Akademik Nderi do të kontribuojë në çuarjen përpara të çështjes së gjuhësisë shqiptare, që është me siguri një çështje e rëndësishme.

Skënder Gjinushi, Kryetar i ASHSH

Fjala në 50-vjetorin e themelimit të Akademisë së Shkencave

10 tetor 2022

I nderuar President i Akademive Europiane profesor Loprieno;

I nderuar zoti Kryeministër;

Të nderuar kryetarë e përfaqësues të akademive mike; të Akademisë Bullgare, Çeke, Gjermane, të Kosovës, Maslit të Zi, Maqedonisë e Rumanisë;

E nderuar zonja Ministre e Arsimit dhe Shkencës;

Të nderuar përfaqësues të institucioneve arsimore e shkencore;

Të dashur anëtarë të Akademisë, të komisioneve të përhershme, profesorë e kërkues shkencorë, familjarë të kolegëve tanë që s'janë më, miq e të ftuar.

Kam nderin e kënaqësinë t'ju falënderoj për pjesëmarrjen tuaj në këtë takim ceremonial për kremtimin e përvjetorit të 50-të të krijimit të Akademisë së Shkencave, e cila mbledhjen e saj të parë e zhvilloi pikërisht në këtë sallë. Me këtë rast falënderoj Kryetaren e Kuvendit që na e afroi këtë mundësi për t'u rimbledhur përsëri këtu, ku kryetari historik i Akademisë sonë profesor Aleks Buda njoftonte publikisht fillimin e rrugëtimit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Një gjysmë shekull jetë për një institucion kombëtar, që synonte të bëhej pjesë e familjes së akademive europiane me tradita shekullore, është pak për të lënë gjurmë në histori, për të djeshmen e për të ardhmen. Kjo ishte e mbetet sfida për Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, e cila u themelua, më 10 tetor 1972.

Por, vështruar nga lartësia e këtij jubileu, mund të pohojmë me plot të drejtë se Akademia jonë e Shkencave, e krijuar si kurorëzim i procesit të ngritjes e zgjerimit të rrjetit të instituteve kërkimore në Shqipëri, e përligji vendimin historik që u mor në plotësim të ëndrrës disashekullore të mendjeve më të ndritura të popullit shqiptar; vit pas viti e dekadë pas dekadë, ajo erdhi e u rendit me dinjitet ndër akademitë e dijes europiane.

Në këtë 50-vjetor të themelimit të Akademisë sonë të Shkencave ne nderojmë më së pari gjithë historinë e gjatë shekullore të akademizmit shqiptar në tërësinë e vet, që nis të shpërfaqet qysh në shekujt e ndritshëm të humanizmit europian, nderimi ynë iu drejtohet veçanërisht njerëzve të dijes që shenjua rrugën e mundimshme drejt lartësisimit intelektual të shqiptarëve: Marin Barletit dhe autorëve më të hershëm të shqipes së shkruar si Gjon Buzuku e

Lekë Matranga, që bënë zgjedhjen historike, duke e orientuar shkrimin e saj drejt latinitetit; doktorëve të filozofisë e teologjisë, Pjetër Bogdanit e themeluesve të Akademisë së Re të Voskopojës që përruan shkencën shqiptare në një mjedis ndërkombëtar, rajonal e europian; figurave të ndritura të shkencës që lanë emër dhe gjurmë në zhvillimin europian e botëror, në Perëndim e në Lindje, si Karl Gega e Sami Frashëri; atyre që bashkuan dëshirën dhe zotësinë për të ndërmarrë nisma serioze që edhe Shqipëria të kishte një akademi të vërtetë, si Ndre Mjeda; të gjithë atyre që paraprinë atë çast historik kur akademizmi u kthye nga dëshirë e utopi në institucion funksionues, duke formësuar çfarë kishin shprehur një shekull më herët protagonistë të mendimit shqiptar si Dora d'Istria e Jeronim de Rada.

Gjatë kësaj periudhe paraprirëse shërbyen si shenja referenciale institucionale kolegjet dhe seminarët arbëreshe; katedrat e para të shqipes; akademia e ipeshkvinjve, e njohur edhe si akademia e alfabetit (1901); Akademia Saveriane (1938) dhe Instituti i Studimeve Shqiptare (1942), i cili veprroi gjatë luftës antifashiste në përbërje të Accademia Reale të Italisë, për të mbërritur tek themelimi i Institutit të Shkencave menjëherë pas çlirimit të vendit.

Instituti i Shkencave, i themeluar në vitin 1947, u shndërrua shumë shpejt në vatrën e krijimit të rrjetit të ardhshëm të institucioneve kërkimore shkencore, fuqizimi e zgjerimi i veprimtarisë së këtij rrjeti çoi natyrshëm në formimin e Akademisë së Shkencave, më 10 tetor 1972.

Kjo qendër e re e kërkimit shkencor, shumë shpejt u kthye në institucionin më të rëndësishëm të shkencës dhe dijes në vend, në të cilin u konsoliduan shkencat albanologjike, Akademia e Shkencave u bë promovuese e themeluese e disiplinave kryesore tekniko-natyrore në vend; ideuese e projektuese e veprave madhore në ekonomi e energjetikë.

Merita për këtë i takon më së pari Asamblesë së parë të Akademisë së Shkencave, atyre që vunë gurët e parë të themelit; ikonave të shkencës shqiptare si Aleks Buda e Eqrem Çabej, të cilët, së bashku me Shuteriqin, Kostallarin, Domin e Pollon, u dhanë prestigjin dhe vendin e merituar shkencave albanologjike; kryeshenjave të shkencave të inxhinierisë, bujqësisë dhe mjekësisë, si Petrit Radovicka, Selaudin Bekteshi, e Mentor Përmeti, të cilët, së bashku me Hoxhën, Prezën, Kumbaron, Dajën, Biçokun, Këlliçin e Kakariqin, vendosën themelet e këtyre shkencave e i vunë ato në shërbim të ekonomisë e shoqërisë; etërve të krijimit të shkollës shqiptare në shkencat e natyrës, si Popa, Pilika, Papparisto, Kuneshka; si dhe të atyre shoqërore, si Omari, Xholi, Mara e Dedja.

Në një gjysmë shekulli jetë Akademia jonë e Shkencave e drejtuar nga Asambleja e kryetarët e saj ndër vite Aleks Buda, Shaban Demiraj, Ylli Popa,

Teki Biçoku, Gudar Beqiraj e Muzafer Korkuti, u kthye në një qendër më vete të zhvillimit të kërkimit elitar të mirëfilltë, krahas veprimtarisë kërkimore universitare. U krijua kështu rrjeti publik i institucioneve të destinuara e profilizuara për kërkim shkencor, i ngjashëm me sistemet homologe në Lindje e në Perëndim, i shtrirë në tërë fushat kryesore të dijës.

Bashkëpunimi me mbi 50 akademi simotra anëtare të federatës më të madhe akademike evropiane ALLEA, me organizata prestigjioze ndërkombëtare si UNESCO, AIESEE, ALE, IAP, SCI, me qendra e institucione akademike e universitare jashtë e brenda vendit, rritën në vazhdimësi vetë veprimtarinë e instituteve pranë Akademisë, si dhe autoritetin dhe emrin e saj në mjedisin ndërkombëtar.

Akademia u kthye në promovuesen e organizuesen e aktiviteteve kryesore shkencore në vend; organizmi i kuvendeve dhe kongreseve për origjinën e popullit shqiptar dhe të gjuhës së tij, në bashkëpunim më tej edhe me Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës; nderimi i ngjarjeve e figurave me rëndësi të veçantë në historinë e shqiptarëve; zgjidhja e çështjes së njësimimit të shqipes së shkruar; botimi ndër vite i korpuseve themelore të trashëgimisë shpirtërore të popullit shqiptar në gjuhë e kulturë; krijimi i arkivave qendrore e vendore të kësaj trashëgimie origjinale; funksionimi i një hapësire kulturore kombëtare unike pavarësisht ndarjes ekzistuese me kufij; finalizuar me konsolidimin e një paradigme afatgjatë të albanologjisë, përbëjnë nyja themelore nderi në historinë e akademizmit institucional shqiptar, duke kristalizuar e konkretizuar atë çka deklaronte akad. Çabej që në themelim se albanologjia u kthye në vendin e vet, mision i mbartur me përgjegjësi nga anëtarët ndër vite: Demirajt, Gjergjit, Frashërit, Bulo, Uçi, Priftiu, Topalli, Beqja.

Akademia rriti rolin e saj parësor në ecurinë e mëtejshme të kërkimit e studimit në fushat më jetike të zhvillimit ekonomik e shoqëror, si shëndetësia dhe shkencat e jetës, të shkencave inxhinierike, veçanërisht në energjetikë dhe gjeoshkencë, me figura të tilla si Farudin Hoxha, Petrit Gaçe, Ylliu Popa, Josif Adhami, Teki Tartari, Eduard Sulstarova, Hysen Laçe, Salvator Bushati, duke krijuar kështu ekuilibrin e domosdoshëm midis shkencave shoqërore dhe atyre natyrore-teknike jo vetëm brenda për brenda Akademisë, por edhe në tërë sistemin kërkimor të vendit.

Trupa akademike ka bashkëpunuar në mënyrë të vazhdueshme me shkollat e larta, si institucion apo nëpërmjet angazhimit të drejtpërdrejtë të anëtarëve të saj, si mësimdhënës, drejtues shkencor, dekan e rektor. Ajo ka kontribuar me përparësi e pandërprerë për formimin e specialistëve të lartë e të kërkuesve të rinj, sipas niveleve universitare të kohës, duke përçuar tek ata disiplina të përparuara/avangarde, programe e tekste me të rejtat shkencore,

ku do veçonim punën e anëtarëve tanë pedagogë Veveçka, Petro, Borici, Misja. Akademia e Shkencave në mënyrë të natyrshme, pavarësisht nga emërtimi i saj, nuk e shkëputi interesin e vlerësimin për kulturën, artin e letrat shqiptare, duke zgjeruar Asamblenë e saj me personalitete të artit e krijimtarisë, si: Odhise Paskali, Dritëro Agolli e Tish Daija.

Gjatë rrugëtimit të saj Akademia e Shkencave është ndeshur edhe me probleme madhore jashtë atyre shkencore siç ishte ideologjizimi i njëanshëm i tejskajshëm gjatë periudhës së sistemit komunist dhe reformat sporadike të ndërmarra në emër të ç'ideologjizimit, por që synonin ndryshime në formë e jo në përmbajtje, gjatë tranzicionit. Ajo ka ditur të çlirohet gradualisht prej ideologjisë moniste pa u ndrojtur e ndikuar nga përbaltja e presionet pluraliste, duke ditur të ndajë të vërtetat shkencore e ato historike nga keqinterpretimi e keqpërdorimi politik i tyre, duke dalluar vlerat e ndikimet e ngjarjeve të mëdha historike nga vlerat, cilësitë apo preferencat individuale të protagonistëve të tyre, duke mos ngatërruar shkakun me pasojat, duke vlerësuar e rivlerësuar njerëzit e shquar të shkencës, letrave e dijës për kontributin e tyre në shkencë, kulturë e arsim pa e ngatërruar atë me veprimtarinë apo zgjedhjen e tyre politike.

Me të njëjtin objektivitet Asambleja e Akademisë ka trajtuar edhe pasojat e reformave të nxituara e të imponuara, të ndërmarra ndaj saj, për t'u përfshirë në një proces reformimi e ristrukturimi, jashtë ndikimeve e përfitimeve politike, bazuar në Ligjin e ri nr. 53/2019 Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë, me synim ripozicionimin e saj si qendër kryesore e ideimit, promovimit dhe zhvillimit të kërkimit shkencor, vendosjen në epiqendër të sistemit të kërkimit shkencor.

Kjo periudhë reformimi e riktheu Asamblenë në funksionet e veta, e ripërtëriti atë me 14 anëtarë të rinj të zgjedhur nga radhët e profesoratit të IAL e të kërkimit shkencor, pranë saj funksionojnë 9 komisione të përhershme ku krahas akademikëve kontribuojnë si anëtarë të rregullt mbi 90 - përfaqësues të universiteteve e qendrave studimore, 7 njësi e qendra kërkimore shkencore dhe 2 institute virtuale, hapja e saj ndaj botës akademike, po fuqizohet më tej edhe me pranimin si anëtarë të jashtëm të studiuesve më të njohur shqiptarë nga diaspora e me dhënien e titullit anëtar nderi studiuesve joshqiptarë, që shquhen në shkencat albanologjike apo kontribuojnë në zhvillimin e shkencës në Shqipëri. Mund të thuhet se nuk ka bashkësi shkencore e profesionale, universitare ose jo, që të mos jetë e lidhur me veprimtarinë e Akademisë së Shkencave.

Përmes nismave të reja është shtuar me përparësi interesimi për shkencat bashkëkohore, si nanoteknologjia, bioteknologjia, inteligjenca artificiale dhe energjitë e ripërtëritshme pa harruar ato të traditës, ngritja e nivelit të

kërkimit për to, nëpërmjet hapjes së strukturave të reja e ristrukturimit të atyre ekzistuese, me mbështetjen e në bashkëpunim me qeverinë, mbetet një prej sfidave të së ardhmes, krahas realizimit me sukses të iniciativave shkencore madhore. Hartimi i veprave themelore: Historia e shqiptarëve, Enciklopedia shqiptare dhe Fjalor i madh i shqipes, që i mungojnë ende traditës shqiptare në këtë format e madhësi.

Zhvillimi me sukses i Kuvendit ndërkombëtar të studimeve albanologjike (2021), dy kongreset ndërkombëtare të nanoteknologjisë (2021, 2022), konferencat ndërkombëtare e kombëtare për bioshkencën, sizmologjinë dhe pandeminë, e asaj botërore e studimit të baladave (2022), forcojnë bindjen për mundësinë e nevojën e thellimit të reformimit të sistemit tonë shkencor, ku një nga aspektet më thelbësore është ngritja pranë Akademisë së Shkencave të një rrjeti elitare institutesh shkencore, nëpërmjet transformimit të njësisë të saj në qendra të mirëfillta kërkimore e ribashkimit pranë saj të instituteve me impakt kombëtar.

Të nderuar pjesëmarrës

Në mbyllje të kësaj fjale më lejoni të shpreh nderimin e mirënjohjen më të thellë për të gjithë kolegët tanë të nderuar, që nuk jetojnë më, që kontribuuan me punën, personalitetin e dijen e tyre në këtë rrugëtim të Akademisë së Shkencave, të falënderoj të gjithë anëtarët e Asamblesë e të Akademisë në rrjedhë të 50 viteve e sidomos Asamblesë e sotme, që ka nderin të ketë në radhët e saj ndër figurat më të ndritura të letrave e shkencës shqiptare, si Ismail Kadare, që jo vetëm i përjetoi me dinjitet sfidat me të cilat u përball, por dëshmoi zotësinë e vet për të dalë në krye të proceseve reformuese, për t'i dhënë institucionit tonë vendin e misionin për të cilin u ngrit 50 vjet më parë.

Faleminderit të gjithëve ju për nderimin dhe vlerësimin që na bëni me prezencën Tuaj e në veçanti kryetarët e akademive si motra e presidentin e ALLEA, që me pjesëmarrjen e tij dëshmoi përkujdesjen, përkrahjen e plotë që i ka dhënë reformimit të Akademisë së Shkencave, ky institucion i rëndësishëm; Kryeministrin dhe Ministren e Arsimit për mbështetjen e bashkëpunimin e deritanishëm, e për angazhimin për të çuar deri në fund reformimin e Akademisë së Shkencave e të vetë sistemit të kërkimit shkencor te ne.

Tiranë, 10 tetor 2022

Skënder Gjinushi, Kryetar i ASHSH

Fjala në 50-vjetorin e Kongresit të Drejtshkrimit

I. Në Tiranë, më 10 nëntor 2022

I nderuar z. Bajram Begaj, President i Republikës së Shqipërisë;

I nderuar z. Edi Rama, Kryeministër i Republikës së Shqipërisë;

I nderuar z. Albin Kurti, Kryeministër i Republikës së Kosovës;

I nderuar z. Artan Grubi, Zëvendëskryeministër i parë në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut;

I nderuar akademik Mehmet Kraja, Kryetar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës;

Të nderuar nënshkrues të Rezolutës së Kongresit të Drejtshkrimit;

Të nderuar pjesëmarrës në këtë konferencë jubilarë: akademikë e profesorë; gjuhëtarë, shkrimtarë e përkthyes; studiues të shqipes;

Kjo konferencë i kushtohet një ngjarjeje kyçe në historinë e kulturës kombëtare shqiptare: 50-vjetorit të Kongresit të Drejtshkrimit.

Për vetë rëndësinë historike-gjuhësore që pati dhe ka ky kongres për tërë shqiptarët, vështruar më së pari si faktor kryesor njësues në identitetin e tyre kombëtar, së bashku me Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës kemi punuar për t'i dhënë kësaj ngjarjeje gjithë vëmendjen shkencore dhe publike.

Është detyra dhe kënaqësia jonë t'u shprehim nderim e mirënjohje të gjithëve atyre që përgatitën Kongresin e Drejtshkrimit dhe nënshkruan Rezolutën e tij: atyre që nuk janë më në jetë dhe atyre që janë mes nesh, në mënyrë të veçantë gjuhëtarëve dhe shkrimtarëve.

Rregullat e zgjidhjet që u miratuan në Kongresin e Drejtshkrimit, të parapririra me vendimet e njëzëshme të miratuara vite më herët nga gjuhëtarët shqiptarë në Konsultën Gjuhësore të Prishtinës, ishin akt njësimi e bashkimi jo vetëm gjuhësor.

Kjo ngjarje e madhe historike është produkt i një përgatitjeje disavjeçare, me pjesëmarrjen dhe kontributin e gjithë intelektualëve shqiptarë, veçanërisht të gjuhëtarëve, të cilët, të prirë nga personalitete të tilla të paharruara si Idriz Ajeti, Besim Bokshi e Ali Hadri në Prishtinë dhe Eqrem Çabej, Androkli

Kostallari, Shaban Demiraj e Mahir Domi në Tiranë, u dëshmuar qartazi shkencërisht e atdhetarisht në lartësinë e momentit historik.

Njësimi i gjuhës letrare është një ligjësi e brendshme objektive, prirja zhvillimore e çdo gjuhe, vështruar së pari si një kërkesë e natyrshme për homogjenizim e ndërkomunikim kombëtar; ndërkohë kjo shihet edhe si një prej faktorëve ndikues në forcimin e identitetit kombëtar.

Fatet dhe rrethanat historike kanë bërë që për shqiptarët gjuha të jetë faktori kryesor përcaktues për identitetin e tyre kombëtar. Ky vizion ka qenë në bazë të programit të Rilindjes. Është kjo arsyeja pse ideologjia jonë kombëtare lindi si romantizëm gjuhësor. Prandaj qëndrimi ndaj gjuhës në të gjitha kohërat është parë i lidhur me identitetin dhe aspekti shkencor gjithnjë është ndërthurur fort me atë patriotik. Përpyjekjet për t'i ndarë këto dy aspekte në emër të arsyes së pastër shkencore janë vlerësuar më së paku si naive.

Kërkesat e mendimtarëve shqiptarë qysh në shekullin e 19-të për një gjuhë të përbashkët, që prej Naum Veqilharxhit, Jeronim de Radës dhe Naim Frashërit; Kristoforidhit e Faik Konicës, Gjergj Fishtës e Luigj Gurakuqit, Mit'hat Frashërit e Fan Nolit; miti sundues i gjuhës shqipe gjatë Rilindjes dhe Pavarësisë; ishin shprehje e ëndrrës së gjithë shqiptarëve për bashkim kombëtar në një shtet, duke e parë njësimin gjuhësor si një hap kyç drejt tij.

Me këtë frymë e qëllim u zhvillua Kongresi i Manastirit, që paracaktoi rrugën e gjuhës shqipe, me orientim të qartë drejt latinitetit, për të kapërcyer qerthujt dhe kurthet e alfabeve të shumëfishta. Pa njësimin e alfabetit në Kongresin e Manastirit (1908), pa Konsultën Gjuhësore të Shkodrës (1917), pa atë frymë që ndikoi në vendimet e qeverive të viteve 1920-1924 për një mënyrë të vetme të shkruarit të akteve administrative, do të ishte e vështirë të arriheshin vendimet e Kongresit të Drejtshkrimit.

Sot, 50 vjet pas mbajtjes së Kongresit të Drejtshkrimit, mund të pohohet pa hezitim se gjuha e njësuar i ka kaluar sfidat dhe sprovat e kohës.

Si për çdo krijesë e krijim, edhe për normën gjuhësore më të rëndësishëm është vetë krijimi dhe qëndrimi ndaj tij e jo marrja me krijuesit e ndikuesit. Gjuhëtarja amerikane Janet Byron (Xhanet Bajron), në studimin e saj monografik mbi historinë e formimit të shqipes së njësuar letrare, duke i shqyrtuar imtësisht rrethanat ideologjike, politike dhe gjeorajonale, përfshirë dhe rolin e sociolinguistikës dhe të planifikimit gjuhësor, konkludon se, pavarësisht rrugës së ndjekur, gjuha letrare shqipe e njësuar rezultoi zgjidhje funksionale.

Vetë fakti që norma gjuhësore filloi të zbatohet më së pari jashtë kufijve shtetërorë, ku situata politike e shtetërore ndikonte vetëm negativisht,

dëshmon qartazi për këtë dhe për faktin se atje etja për njësim-bashkim ishte më e fuqishme.

Gjatë këtij gjysmëshekulli dhe sidomos gjatë tri dekadave të fundme, gjuha shqipe është përballur me prova të mëdha për të dëshmuar aftësitë e saj shprehëse në të gjitha ligjërimet. Sfida më e madhe e saj ka qenë të dëshmojë aftësitë e veta për të shqiptuar e shqipëruar kryeveprat e letërsisë, filozofisë dhe mendimit botëror shprehur në ato që quhen gjuhë të mëdha të Njerëzimit: prej epopeve të lashta antike të popujve, Komedisë hyjnore, tragjedive të Shekspirit e traktateve të filozofisë klasike gjermane, deri te Shkrimet e Shenjta.

Shqipja jonë e njësuar, për meritë të saj e të përkthyesve dhe shkrimtarëve që iu kushtuan asaj, ka provuar katërçipërisht barazinë e vet me çdo gjuhë, të madhe a të vogël, duke përfshirë edhe ato rrafsh ligjërimi për të cilat në Kongresin e Drejtshkrimit nuk u fol, si ligjërimi liturgjik e gjuha e faltoreve.

Ky 50-vjetor përkon me atë të themelimit të Akademisë sonë të Shkencave. Ky përkim nuk është një rastësi: të dyja këto ngjarje janë produkt i procesit historik të ngritjes në një stad të ri të pjekurisë shkencore, atdhetare e kulturore mbarëshqiptare, dëshmuar në vijimësi në Shqipëri e në Kosovë, në gjithë arealin e përdorimit të shqipes.

Lindur në kushtëzim të njëra-tjetrës dhe produkt i së njëjtës klimë, Akademia e Shkencave dhe të gjitha institucionet që i janë kushtuar albanologjisë e konsiderojnë përgjegjësi promovimin, argumentimin, zhvillimin progresiv, mbrojtjen dhe përditësimin e gjuhës së njësuar, bazuar në vendimet që mori Kongresi i Drejtshkrimit për një gjuhë të njësuar në të gjitha rrafshet e stilet, në gjithë hapësirën historike shqiptare, si gjuhë e shkruar, si gjuhë e arsimimit dhe e komunikimit zyrtar publik.

Sigurisht, gjuha e njësuar nuk është thjesht një akt i arkivuar, por një organizëm i gjallë në zhvillim, pasurim e përsosje; rendi e rregullimi i saj nuk janë një proces i mbyllur përgjithnjë.

Zgjidhjet që ofroi Kongresi i Drejtshkrimit janë të drejta, por, ashtu si përdoruesi i gjuhës duhet të respektojë normën e saj, ashtu dhe norma të ndjekë zhvillimin e brendshëm të gjuhës si organizëm i gjallë që vazhdimisht pasurohet e përsoset, përparon e konsolidohet. Norma nuk dikton kufijtë e fjalës, por drejtshkrimin e saj. Rregullat ortografike krijojnë normë në drejtshkrim dhe nuk janë kufizim për drejtshqiptimin, që kërkon më shumë kohë e kulturë.

Disiplinimi i folësve të shqipes për të përdorur normën e saj kudo e kurdoherë, edhe në familje apo në trashëgiminë e të parëve, nuk ka lidhje me respektimin e gjuhës së njësuar. “Rregullimi” retrospektiv i letërsisë dhe i

çdo trashëgimie është dukuri po aq e dëmshme sa dhe kufizimet në përdorimin e dialekteve në emër të standardit, në gjuhën e folur, në jetën e përditshme apo krijimtari.

Dialektet janë trashëgimi themelore kombëtare, janë rezervati i pasurimit të shumanshëm të shqipes së njësuar, janë burimi i fuqisë leksikore e gramatikore të saj. Janë shkrimtarët e përkthyesit, dijetarët e publicistët, ata që, duke i ftuar në qarkullim në përputhje me rendin gjuhësor këto resurse, u japin status të ligjshëm shkencërisht në shqipen e njësuar letrare.

Me këtë qëndrim ndaj raporteve gjuhë letrare - dialekte garantohet vazhdimësia e letërsisë nga njëra periudhë në tjetrën, respektimi i vullneteve autoriale në mënyrë tërësore, përfshirja e njohurive dialektore në të gjitha nivelet e sistemit arsimor të vendit.

Në funksion e në pajtim me këto parime është ngritur Kartoteka Kombëtare e Leksikut të Shqipes, ku ruhen rekordet e pasurisë së gjuhës shqipe në leksik e në ligjërim, me rreth 15 milionë njësi, që janë burimi i çdo fjalori a gramatike. Mbi këtë bazë, me pjesëmarrjen e tërë instituteve të fushës, po hartohet i pari fjalor i formatit të madh të gjuhës sonë, që do të shenjojë një hapje tjetër cilësore e sasiore ndaj gjithë pasurisë leksikore e frazeologjike të saj, për të kaluar te krijimi i një thesaurus-i të shqipes së shkruar e të folur në tërësinë e vet, duke shmangur çdo ndasi në ndërkomunikimin dhe pranimin e prurjeve prej dialekteve në shqipen letrare.

Hartimi i Enciklopedisë shqiptare, projekt i përbashkët i dy akademive, me lëndën enciklopedike të mbledhur e përruar nga gjithë bota shqiptare, do të jetë një tjetër hap njëkuptimësi e njësimi për promovimin e trashëgimisë shqiptare në tërësi, duke shërbyer si një dëshmi e identitetit të përbashkët në të gjitha sferat, si një provë e dallimit të qartë midis identiteteve shtetërore të imponuara prej rrethanash historike e identitetit kombëtar të ngjizur në shekuj.

Akademia e ka mision parësor mirëpërdorimin e gjuhës së njësuar. Gjuha jonë si trashëgimi e përbashkët, nuk ka nevojë për mbrojtje e avokati veçanërisht nga vetja e nga të vetët. Kur flasim për mbrojtje të shqipes si gjuhë dhe të asaj të njësuar veçmas bëhet fjalë për mbrojtje nga barbarizmat, nga shtrembërimet që vijnë nën ndikimin e gjuhëve të tjera, nga keqpërdorimi publik i saj në tekste, administratë e në ligjërimin publik zyrtar; për mbrojtjen e brezave të rinj të lindur në mërgim nga humbja e gjuhës së prindërve e të gjyshërve. Është detyra jonë që t'i përgjigjemi detyrimit kushtetues e atij të ligjit organik të Akademisë për rregullimin juridik të përdorimit të shqipes në funksionet zyrtare e administrative, duke përgatitur e propozuar aktet e nevojshme ligjore e nënligjore.

Shqiptarët, të orientuar tërësisht drejt një bashkësie të qytetëruar europiane, siç është Bashkimi European, do të bëhen pjesë e saj jo si toskë e gegë, por si shqiptarë e si një komb. Në aktet e Bashkimit European dhe në sallat e vendimmarrjes europiane për ta do të ketë një sportel gjuhësor, një kabinë të vetme përkthimi, dhe në to do të përdoret shqipja e njësuar letrare, siç po kërkohet edhe institucionalisht. Gjuha e bashkimit do të kthehet në gjuhë të integritit.

Faleminderit për vëmendjen. Punë të mbarë konferencës.

Tiranë, më 10.11.2022

II. Në Prishtinë, më 17 nëntor 2022

I nderuar akademik Mehmet Kraja, Kryetar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës;

Të nderuar akademikë e profesorë; gjuhëtarë, shkrimtarë e përkthyes; albanologë, studiues të gjuhës shqipe;

Ne sapo kemi kremtuar dy ngjarje me rëndësi: 50-vjetorin e themelimit të Akademisë së Shkencave dhe 50-vjetorin e Kongresit të Drejtshkrimit.

Dëshiroj të falënderoj Kryesinë e Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës për bashkëpunimin e ngushtë në organizimin e tyre dhe për nderimin me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të saj në këto dy aktivitete.

Sigurisht, këto nuk janë dy data rastësisht afër njëra-tjetrës, por janë përmbyllje e dy proceseve të rëndësishme në zhvillimin e një shoqërie; janë tregues të arritjes së një stadi të ri zhvillimi të vetë shkencës e inteligjencës shqiptare, veçanërisht të shkencave albanologjike. Janë po këto procese që kishin çuar në krijimin e Universitetit të Tiranës e më pas në krijimin e Universitetit të Prishtinës dhe të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës.

Me rastin e krijimit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë prof. Aleks Buda deklaronte se “ky është një cak në zhvillimin e një kombi”, ndërsa, po në vitin 1972, me rastin e organizimit të Kuvendit të Parë të Studimeve Ilire, Eqrem Çabej deklaronte se me këtë ngjarje u dëshmua se “albanologjia që kthyer në shtëpinë e saj”. Është kjo shkallë pjekurie e albanologjisë shqiptare; ishte kjo plejadë studiuesish me dijetarë të tillë me njohje ndërkombëtare, si Eqrem Çabej, Idriz Ajeti, Aleks Buda, Ali Hadri, Besim Bokshi, të cilët, ashtu siç arritën të bëjnë të pranueshme e përcaktuese

ndërkombëtarisht tezat për origjinën e popullit shqiptar, për lidhjen iliro-shqiptare, për origjinën e lashtësinë e gjuhës shqipe dhe afërsinë e dialekteve kryesore të saj, ashtu ndërmorën edhe hapin e njësimimit të gjuhës shqipe.

Natyrisht njësimimi i gjuhës nuk u bë në një ditë, ndaj, kur kremtojmë 50-vjetorin e kongresit të vitit 1972, është një rast e detyrim për të vlerësuar e shprehur mirënjohjen tonë për tërë ato ngjarje historike, që i paraprinë, përgatitën e çuan në këtë vendimmarrje, që nga akademia e ipeshkvijve, Kongresi i Manastirit, Komisia Letrare e Shkodrës, deri tek Konsulta Gjuhësore e Prishtinës e vitit 1968; për të gjithë ata që kontribuuan me mendimin e dijen e tyre, që nga mendimtarët rilindës deri te dijetarët e shekullit të kaluar.

Vetë rruga që përshkoi gjuha shqipe deri tek njësimimi flet për një bashkëpunim të ngushtë dhe pa paragjykime midis intelektualëve shqiptarë në Shqipëri e në Kosovë. Vendimet që mori Kongresi i Drejtshkrimit u ngjizën në Prishtinë. Dhe kjo nuk është rastësi. Ashtu si kërkesa për pavarësi u ngjiz në Prizren dhe u shpall në Vlorë, edhe për njësimin e gjuhës shqipe vendimi u ngjiz në Prishtinë e u shpall në Tiranë, i parë ky si hap i parë drejt bashkimit e afrimit shqiptar.

Sot, pas 50-vjetësh, ne shohim me kënaqësi se kjo vepër historike e protagonistëve dhe figurave emblematiske të dy akademive tona i rezistoi kohës. Gjuha letrare shqipe i ka dëshmuar tashmë tërë cilësitë e saj si funksione e si pasuri veçanërisht në periudhën e fundit, me hapjen që pati letërsia shqipe, sidomos në Shqipëri pas mbylljes ideologjike dhe në Kosovë pas diskriminimit e kufizimeve etnike në arsim e kulturë, kohë kur letërsia e gjuha u ballafaquan me gjithë gjuhët e mëdha, nëpërmjet veprave të shkrimtarëve tanë.

Norma letrare është përqaftuar jo vetëm nga specialistët e fushës, por nga tërë gjeneratat e reja, gjatë arsimimit të tyre në Kosovë, në Shqipëri, në Maqedoninë e Veriut, në Malin e Zi, ku shqiptarët mësojnë të shprehen e shkruajnë pa asnjë vështirësi në gjuhën e njësuar. Efekt i njësimimit gjuhësor është qartësisht lehtësimi e rritja e komunikimit midis tyre pa dallime krahinore, kjo edhe për faktin se dallimet midis dialekteve historikisht nuk kanë qenë thelbësore.

Për rëndësinë që ka gjuha letrare, për faktin që ajo tashmë është gjuhë zyrtare në Shqipëri, Kosovë e në Maqedoninë e Veriut, dy akademitë tona kanë për mision e përgjegjësi për mbarëvajtjen dhe mbrojtjen e saj.

Mbarëvajtja e normës është detyrë e Këshillit Ndërkademiq të Gjuhës Shqipe, sepse gjuha është një qenie e gjallë, që zhvillohet, pasurohet, normësohet. Është detyrë e gjuhëtarëve t'i ndjekin këto procese e t'u dalin

përpara tendencave për çmontim të gjuhës letrare, që janë të papranueshme, ndonëse e të pamundura jo vetëm shkencërisht, por edhe politikisht; ashtu sikurse dhe nga paprekshmëria, që krijon objektivisht refleksin e kundërt.

Nuk jam specialist, por më duket se gjuha letrare, produkt i një stadi të caktuar të zhvillimit të dialekteve të një gjuhe, është ashtu si fëmija që, ndërsa bart gjakun dhe ADN-në e të dy prindërve, gjyshërve e farefisit, si rregull më shumë i ngjan njërit prej të dyve. Por, pavarësisht nga kjo, nuk ka prind që do ta mohonte fëmijën për këtë shkak. Ndërkohë, fëmija, pavarësisht kujt i ngjan më shumë në pamje të jashtme, duhet të shprehë të njëjtën dashuri e kujdes ndaj prindërve e gjyshërve, duhet të jetë njëlloj i hapur në përthithjen e edukatës e zakoneve të mira. Ky duhet të jetë edhe qëndrimi ndaj gjuhës letrare e raporti i saj me dialektet.

Ne përshëndesim faktin se gjatë konferencës që u mbajt në Tiranë folësit shprehën këtë vlerësim e qëndrim ndaj gjuhës së njësuar, si gjuhëtarët, edhe politikanët në emër të institucioneve, që nga Arbëria, Maqedonia e Veriut, Kosova e Shqipëria. Ishte i rëndësishëm edhe shqiptimi i qeveritarëve, sepse gjuhëtarëve dhe akademive u takon mbrojtja shkencore e mirëmbajtja e normës gjuhësore, ndërsa qeveritë kanë për detyrë mbrojtjen administrative e mirëpërdorimin e saj.

Kur flasim për mbrojtje është fjala për kërcënimin e gjuhës nga barbarizmat, nga ndikimet e gjuhëve të huaja e i teknologjisë së informacionit, nga humbja e gjuhës prej emigrantëve, probleme të cilat duhen përballuar, ndërkohë që gjuha mbetet faktor kryesor i identitetit shqiptar.

Vetë proceset e globalizimit e të integritimit nxisin proceset njësuuese, ne kemi zgjedhur rrugën e integritimit evropian, proces i cili fillon nga integrimi i vetë shqiptarëve, nga heqja e çdo kufiri shtetëror a gjuhësor midis tyre, pasi edhe sipas kërkesave e standardit të Bashkimit Europian atje do të hyjmë me një gjuhë, me gjuhën e njësuar, gjuhën e integritimit evropian. Të gjitha këto do të trajtohen më me kompetencë nga pjesëmarrësit në këtë konferencë.

Ju uroj mbarësi, ju falënderoj për vëmendjen.

Revista *Studia Albanica* në Listën A të revistave shkencore
shpallur nga agjencia ndërkombëtare ANVUR



Elenco delle riviste scientifiche dell'Area 10
Valido ai fini del V Quadrimestre ASN 2021-2023 - pubblicato il 10/10/2022

TITOLO	ISSN	Area 10
STUDI PASOLINIANI	1972-473X	S
STUDI PERGOLESIANI	1826-8021	S
STUDI PETRARCHESCHI	1128-2045	S
STUDI PIEMONTESE	0392-7261	S
STUDI PUCCINIANI	1724-2401	S
STUDI RINASCIMENTALI	1724-6164	S
STUDI RINASCIMENTALI	1824-1948	S
STUDI ROMAGNOLI	0081-6205	S
STUDI ROMANI	0039-2995	S
STUDI SALENTINI	0039-3002	S
STUDI SARDI	2037-4232	S
STUDI SECENTESCHI	0081-6248	S
STUDI SENESI	0039-3010	S
STUDI SETTECENTESCHI	0392-7326	S
STUDI SLAVISTICI	1824-761X	S
STUDI SLAVISTICI	1824-7601	S
STUDI STORICI	0039-3037	S
STUDI SUL BOCCACCIO	0585-4997	S
STUDI SUL SETTECENTO E L'OTTOCENTO. RIVISTA INTERNAZIONALE DI ITALIANISTICA	1828-2156	S
STUDI SUL SETTECENTO E L'OTTOCENTO. RIVISTA INTERNAZIONALE DI ITALIANISTICA	1970-2213	S
STUDI SUL SETTECENTO ROMANO	1124-3910	S
STUDI SULLA FORMAZIONE	1127-1124	S
STUDI SULLA FORMAZIONE	2036-6981	S
STUDI SULL'INTEGRAZIONE EUROPEA	1970-0903	S
STUDI SULL'ORIENTE CRISTIANO	1127-2171	S
STUDI TANATOLOGICI	1971-5684	S
STUDI TASSIANI	0081-6256	S
STUDI TASSIANI SORRENTINI	1593-2451	S
STUDI TIZIANESCHI	2036-8526	S
STUDI TARENTINI DI SCIENZE NATURALI. ACTA GEOLOGICA	0392-0534	S
STUDI TARENTINI DI SCIENZE STORICHE. SEZIONE PRIMA	0392-0690	S
STUDI TARENTINI DI SCIENZE STORICHE. SEZIONE SECONDA	0392-0704	S
STUDI TARENTINI. ARTE	2239-9712	S
STUDI TARENTINI. STORIA	2240-0338	S
STUDI UMANISTICI	1126-7259	S
STUDI UMANISTICI PICENI	1126-4764	S
STUDI URBINATI B, SCIENZE UMANE E SOCIALI	1125-2057	S
STUDI VENEZIANI	0392-0437	S
STUDI VERDIANI	0393-2532	S
STUDIA ALBANICA	0585-5047	S
STUDIA AMBROSIANA	2281-3748	S
STUDIA ANGLICA POSNANIENSIS	2082-5102	S
STUDIA ASIATICA	1582-9111	S
STUDIA AUREA	1988-1088	S
STUDIA AUSTRIACA	2385-2925	S
STUDIA AUSTRIACA	1593-2508	S
STUDIA BORROMAICA	1128-7039	S
STUDIA EBLAITICA	2364-7124	S(2016)
STUDIA ET DOCUMENTA HISTORIAE ET IURIS	1026-9169	S
STUDIA ETYMOLOGICA CRACOVENSIS	1427-8219	S

S: Scientifica

†(anno): Scientifica fino al 31.12.anno - Le pubblicazioni successive a tale data non saranno ritenute scientifiche

§(anno): Scientifica a partire dal 01.01.anno - Solo le pubblicazioni successive a tale data sono ritenute scientifiche

Elenchi di riviste scientifiche e di classe A

Si riportano di seguito gli elenchi aggiornati validi ai fini della valutazione dei candidati che presenteranno domanda di Abilitazione nel V quadrimestre dell'ASN 2021-2023:

A. Elenco delle riviste scientifiche

- **Area 08 – Riviste Scientifiche** (pubblicato il 10/10/2022)
- **Area 10 – Riviste Scientifiche** (pubblicato il 10/10/2022)
- **Area 11 – Riviste Scientifiche** (pubblicato il 10/10/2022)
- **Area 12 – Riviste Scientifiche** (pubblicato il 10/10/2022)
- **Area 13 – Riviste Scientifiche** (pubblicato il 10/10/2022)
- **Area 14 – Riviste Scientifiche** (pubblicato il 10/10/2022)

B. Elenco delle riviste di Classe A

- **Area 08 – Riviste di classe A** (pubblicato il 10/10/2022)
 - **Area 10 – Riviste di classe A** (pubblicato il 10/10/2022)
 - **Area 11 – Riviste di classe A** (pubblicato il 10/10/2022)
 - **Area 12 – Riviste di classe A** (pubblicato il 10/10/2022)
 - **Area 13 – Riviste di classe A** (pubblicato il 10/10/2022)
-